

Sashe Dimovski
Dr. Jovan Ilievski
Zoran Dimitrievski



PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

UDHËZUES PËR GAZETARË GJATË TËRË
PROCEDURËS PENALE

Sashe Dimovski
D-r Jovan Ilievski
Zoran Dimitrievski

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

Janar, 2014

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

Autorë:

Sashe Dimovski - Gazetar

D-r Jovan Ilievski - Prokuror Publik në Prokurorinë Themelore për Ndjekjen e korrupsionit dhe krimet të organizuar

Zoran Dimitrievski - Gjykatës në Gjykatën e Apelit në Shkup

Redaktor:

Ana Novakova-Zhikova, Zyrtar kombëtar për sundimin e të drejtës pranë Misionit të OSBE-së në Shkup

Tirazhi: 200 kopje

Botoi: Skenpoint, Shkup

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

343.727:343.13(497.7)(036)

DIMOVSKI, Sashe

Publiku në procedurën penale : udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale / Sashe Dimovski, Jovan Ilievski, Zoran Dimitrievski. - Shkup : OBSE, 2014. - 70 стр. ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojca 1-6

ISBN 978-608-4630-69-2

1. Ilievski, Jovan [автор] 2. Dimitrievski, Zoran [автор]

а) Слобода на изразување - Новинари - Кривична постапка -

Македонија - Водичи

COBISS.MK-ID 95828490



Mbështetur nga



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Skopje

Përbajtja e këtij botimi nuk domethënë se i pasqyron pikëpamjet dhe qëndrimet e Misionit të OSBE-së

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

PËRMBAJTJA:

HYRJA.....	5
1. STANDARDET NDËRKOMBËTARE.....	7
2. KORNIZA LIGJORE VENDASE	10
2.1 DISPOZITA RELEVANTE PËR GAZETARËT	10
2.2 KOMPETENCAT E GJYKATAVE	13
3. SHQYRTIMI I LIGJIT PËR PROCEDURË PENALE	16
3.1 RREGULLAT E PËRGJITHSHME MBI TË CILAT MBËSHTETET LIGJI I RI PËR PROCEDURË PENALE.....	17
3.2 SISTEMATIZIMI I LIGJIT PËR PROCEDURË PENALE	23
4. “PUBLIKU” GJATË PROCEDURËS PARAHETIMORE DHE HETIMORE	27
4.1 NJOFTIM PËR PUNËN E INSTITUCIONEVE GJYQËSORE	27
4.2 REKOMANDIME DHE PROPOZIME PËR MËNYRAT E INFORMIMIT NGA PROKURORIA PUBLIKE	28
5. HAP PAS HAPI PËRMES SHQYRTIMIT KRYESOR GJYQËSOR	37
5.1 KONTROLLI I AKUZËS	37
5.2 PUBLIKU	37
5.3 SEANCA KRYESORE GJYQËSORE	44
6. PROCEDURAT E PËRSHPEJTUARA	49
6.1 PROCEDURA E SHKURTUAR	49
6.2 SJELLJA E AKTGJYKIMIT NË BAZË TË MARRËVESHJES SË ARRITUR NDËRMJET PROKURORIT PUBLIK DHE TË AKUZUARIT	53
6.3 PROCEDURA E NDËRMJETËSIMIT (MEDIACIONI).....	56
6.4 PROCEDURA PËR LËSHIMIN E URDHËR DËNIMIT.....	58
7. ZBATIMI I SANKSIONEVE	59
8. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE	73
<i>SHTOJCA 1: NOCIONET E LIGJIT PËR PROCEDURË PENALE</i>	<i>75</i>
<i>SHTOJCA 2: RREGULLAT E SJELLJES BREnda GJYKATËS THEMELORE SHKUPI I, SHKUP</i>	<i>77</i>
<i>SHTOJCA 3: KODI ETIK I SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË</i>	<i>79</i>
<i>SHTOJCA 4: NENE TË RREGULLORE GJYQËSORE QË KANË TË BËJNË ME MARRËDHËNIET ME OPINIONIN PUBLIK</i>	<i>82</i>
<i>SHTOJCA 5: UDHËZUESI I MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR MËNYRËN E SHPALLJES DHE KËRKIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FAQEN E INTERNETIT TË GJYKATËS</i>	<i>87</i>
<i>SHTOJCA 6: KËSHILLI I EVROPËS KOMITETI I MINISTRAVE.....</i>	<i>91</i>

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

Hyrja: Pse ky udhëzues

Me Ligjin e ri për procedurë penale (LPP), i cili zbatohet nga 01.12.2013, u braktis sistemi i deritanishëm i administrimit të procedurës penale me futjen e zgjidhjeve të reja, të cilat kanë të bëjnë, mes tjerash, edhe me administrimin e hetimit nga ana e prokurorit publik, rolin e gjykatësit në procedurën e mëparshme, mundësinë për realizimin e procedurave të shkurtuara dhe parimin e arritjes së marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit për llojin dhe peshën e sanksionit.

Koncepti i ri i procedurës penale, në masë të madhe, e ndryshon perceptimin të cilën e kishte deri më tani publiku rreth mbarëvajtjes së hetimeve, rreth realizimit të seancës kryesore dëgjimore gjatë procedurës penale, rreth prezantimit të provave, rreth caktimit të fajësisë.

Kështu, u imponua nevoja e domosdoshme për përpilimin e këtij Udhëzuesi për gazetarë, për transparencë gjatë procedurave penale, e cila do ta lehtësojë shumë punën e gazetarëve, të cilët raportojnë për procedurat penale, të cilët shkruajnë për punën e gjyqësorit, raportojnë nga terreni për raste ku ka ndodhur vepër penale dhe gjatë të cilave bëhet këqyrje, raportojnë për masa juridike të rregullta ose të jashtëzakonshme ose e mbikëqyrin realizimin e sanksioneve penale pas përfundimit fuqiplotë të procedurës penale.

Në këtë Udhëzues për gazetarë, i cili do të jetë i dobishëm edhe për opinionin më të gjerë publik si studentët, praktikuesit, por edhe qytetarët të cilët, në mënyrë më të thjeshtë, mund të njihen me mbarëvajtjen e procedurave, janë përfshira fazat kryesore të procedurës penale, nga hetimi të cilën tani do ta realizojë prokurori, nëpërmjet rolit të gjykatësit të procedurës së mëparshme (më parë njihet me emrin gjykatës hetues) e deri në mënyrën e mbajtjes së seancës kryesore, prezantimin e provave, caktimin e fajësisë, shpalljen e vendimeve dhe procedurën ankimore (apelit).

Një pjesë e madhe i kushtohet transparencës gjatë procedurës penale, që paraqet edhe motiv kryesorë për përpilimin e këtij Udhëzuesi. Transparenca si korigjues i të gjitha proceseve, e cila përmes gazetarëve do ta njoftoj publikun saktësisht dhe në kohë për procedurat gjyqësore që realizohen nëpër gjykatat e Maqedonisë, për të cilat ka interesim më të gjerë.

Ky Udhëzues, i njofton gazetarët, hap pas hapi, me procedurën penale, i sqaron fazat, kompetencat e prokurorit, gjykatësit në procedurën e mëparshme ose gjykatësit për realizimin e sanksioneve. I ofron edhe të gjitha solucionet në të cilat mund të përfshihet edhe opinionin publik, për procedura që kanë të bëjnë me të mitur ose kur mbrohet integriteti personal ose moral i pjesëmarrësve në procedurën penale ose nëse shpalosen prova ose informacione të besueshme me nivel të caktuar të fshehtësisë. Sipas dispozitave të LPP (Ligji për Procedurë Penale), gazetarët tani do të kenë më shumë përgjegjësi gjatë raportimit të rasteve në të cilat prokurori dhe i akuzuari nuk do të arrijnë marrëveshje, ndërsa lënda do të përfundojë tek gjykatësi kompetent. Njëkohësisht, gazetarët gjatë raportimit të tyre do të duhet të kenë kujdes që të mos e dëmtojnë të akuzarin i cili ka hyrë ose nuk ka çdo gjykim është publik, vetëm nëse nuk bëhet fjalë për përjashtimet e sipërpërmendura, por

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

edhe atëherë gazetarët dhe opinioni publik mund të përjashtohen nga seanca vetëm nëse Trupi Gjykes do të merr vendim të tillë, të cilin do ta shpall para të pranishmëve në sallën e gjykit dhe në atë mënyrë të gjithë do të njoftohen për arsyet që kanë shpjer deri tek mbyllja zyrtare e sallës së gjykit për opinionin publik.

Në këtë mënyrë, do të evitohen të gjitha dyshimet e mundshme për atë nëse publiku duhet përjashtuar ose në ndonjë procedurë të caktuar, gjë që do të evitojë raportimet dhe komentet negative gjoja se ndonjë gjykim i caktuar është bërë i fshehtë pa mos u shpallur arsyet për të.

Natyrisht, këtë Udhëzues duhet ta kenë në dispozicion raportuesit e proceseve gjyqësore, të cilët lehtë dhe shpejtë do të mund të reagojnë në qoftë se dikush do të tentonte t'i privoj ata nga e drejta e mbikëqyrjes së seancës, që do të ishte në kundërshtim me ligjin ose rregulloren gjyqësore.

Gjyqësori është një ndër fushat më specifike, i cili kërkon njohjen e terminologjisë juridike, kuptimin e tyre, kompetencat e institucioneve dhe trajtimin e tyre në raste konkrete, që të mund t'i jepet publikut informacione të sakta, pa asnjë gabim, të cilat do të mund të krijonin huti tek lexuesit/shkuesit/dëgjuesit.

Opinionin publik gjatë procedurave gjyqësore është kusht i domosdoshëm për transparencën dhe llogaridhënien e gjyqësorit, e cila gjë shpie drejt rritjes së besimit, ndërsa gazetarët janë ata që e krijojnë opinionin publik dhe prandaj gjykatësit dhe gazetarët janë të varur nga njëri tjetri për të realizuar vlerat dhe qëllimet demokratike.

E drejta e lirisë së shprehjes është një ndër të drejtat themelore të njeriut dhe prandaj gazetarët duke e realizuar misionin e tyre, nëpërmjet raportimit, e promovojnë këtë parim.

Gjatë disa segmenteve të procedurave gjyqësore, gazetarët janë të kufizuar, kur bëhet fjalë për informacione të besueshme, mbrojtjen e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të miturve, dhe ata duhet të veprojnë me kujdes që të mos gjenden në situatë të akuzohen ose t'u nënshtrohen padive penale për shpifje ose fyerje para gjykatës civile.

Prandaj, ky Udhëzues ka për qëllim të informojë, të edukojë dhe të demonstrojë për të gjithë gjerat e dobishme në punën e gazetarëve, kur bëhet fjalë për procedurat gjyqësore dhe çfarë mund e çfarë nuk mund të shpaloset para publikut. Ndryshimet e shpeshta të ligjeve do të lënë hapësirë për avancimin e më tutjeshëm të këtij doracaku, mirëpo ekipi që e përpiloi këtë Udhëzues u përpoq t'i përfshijë të gjitha pikëpamjet e procedurës, të paraqes disa ligje, kodin profesional dhe rregulla tjera, të cilat kanë vetëm një qëllim: informim të saktë dhe në kohë.

1. STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Standardet dhe parimet ndërkombëtare për publikun në procedurat gjyqësore dhe lirinë e shprehjes janë të përfshira plotësisht në legjislacionin vendas. Me firmosjen dhe ratifikimin e disa konventave dhe protokoleve të caktuara ndërkombëtare dhe dokumenteve të tjera, parimet dhe udhëzimet themelore bëhen pjesë përbërëse e rendit juridik kombëtar.

❖ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Secili ka të drejtë lirie të mendimit dhe shprehjes. Kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë për të përfaqësuar ndonjë mendim të caktuar pa asnjë involvim dhe të kërkohen, të pranohen dhe të jepen informacione dhe ide nëpërmjet cilitdo medium, pa dallim kufijsh.¹

Gjatë zbatimit të të drejtave dhe lirive, secili njeri do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të caktuara me ligj, me qëllimin e vetëm për njohjen dhe respektimin e duhur të të drejtave dhe lirive të tjerëve dhe me qëllim të kënaqjes së kërkesave të drejta për rend publik, moral dhe mirëqenie të përgjithshme në një shoqëri demokratike.²

❖ Konventa Evropiane për të Drejtat e njeriut

Çdokush ka të drejtë që publikisht dhe me korrektësi, në afat të arsyeshëm kohor, të paraqitet para një gjykate të caktuar me ligj që t'i shqyrtohen dhe vërtetohen të drejtat dhe obligimet e tij/saj qytetare ose bazën e çfarëdo padie penale kundër tij/saj. Aktgjykimi shqiptohet publikisht, ndërsa gazetarët dhe publiku mund të përjashtohen gjatë tërë ose një pjese të procedurës në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur këtë e kërkojnë interesat e një të mituri ose mbrojtja e jetës private të palëve të kontestuara; ose kur gjykata e sheh të arsyeshme sepse në rrethana të caktuara, publiciteti do të mund t'u shkaktoj dëm interesave të drejtësisë.³

Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut i jep rëndësi të posaçme karakterit publik të procedurës duke konsideruar se elementi publik paraqet një veçori thelbësore të gjyqësisë korrekte. Kështu, pohon se: *"(...) Karakteri publik i procedurës e cila mbahet para organeve gjyqësore të theksuara në Nenin 6(1) i mbron palët nga realizimi eventual i fshehur i drejtësisë, pa kritikë dhe kontroll publike. Kjo, gjithashtu është një ndër mënyrat e mundshme që të garantohet besimi tek gjykata, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për gjykatë të shkallës së parë ose të ndonjë shkalle më të lartë. Me sigurimin e transparencës gjatë procesit të realizimit të drejtësisë, publiku në këtë procedurë kontribon në përmbushjen*

¹ neni 19, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, <http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml#a19>

² neni 29, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, <http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml#a19>

³ neni 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

e qëllimit të paraparë me nenin 6(1), e kjo d.m.th. proces korrekt i cili paraqet garancë të një ndër parimeve themelore të çdo shoqërie demokratike (...).⁴

Çdokush ka të drejtë të lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë e përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë e pranimit dhe përcjelljes së informacioneve ose ideve pa përfshirjen e pushtetit publik dhe pa dallim të kufijve.⁵

Liria e mediave nuk është absolute sepse abuzimi nuk nënkupton liri. Përcjellja e informacioneve për raportim medial patjetër duhet të jetë në pajtim edhe me të drejtat e personave të përfshirë, të garantuara me Konventën evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut, me Kushtetutë dhe me ligje. Realizimi i këtyre lirive, duke konsideruar se përmbajnë në veti edhe obligime, mund t'u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose dënimeve, siç është parashikuar me ligj dhe është e domosdoshme për një shoqëri demokratike, mes tjerash, në interes të mbrojtjes nga krimi, mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të tjerëve, për parandalimin e publikimit të informacioneve të besueshme ose për ruajtjen e autoritetit dhe pavarësisë së gjyqësorit.⁶

➤ *Kufizimet e Nenit 10 me qëllim të mbrojtjes së autoritetit të gjyqësisë*

Detyrimi i lojalitetit dhe diskrecionit, të cilët patjetër duhet të kenë nëpunësit shtetërorë, veçanërisht gjyqësori, kërkon që publikimi madje edhe i informacioneve të sakta të bëhet me maturi dhe mirësjellje.⁷

➤ *Kufizimet e Nenit 10 lidhur me nenin 6:*

Shteti nuk guxon të jep informacione që do të shkelnin prezumimin e pafajësisë. Mediat gjatë raportimit të tyre duhet të jenë të kujdesshëm dhe t'i përdorin përshtatshëm shprehjet juridike siç janë i dyshuar, i akuzuar, i dënuar sepse secili që është ngarkuar me kryerje të veprës penale konsiderohet i pafajshëm derisa faji i tij/saj të provohet juridikisht.⁸

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pohon se *“(...) liria e shprehjes është e garantuar me Nenin 10 të Konventës, e cila përfshin edhe informacionet. Neni 6(2) nuk mund të pengojë pushtetin që të informojë opinionin publik rreth hetimeve aktuale penale, mirëpo kërkon që kjo të bëhet me diskrecion dhe kujdes të duhur nëse duhet të respektohet prezumimi i pafajësisë(...).”⁹*

⁴parag. 21, Preto dhe të tjerë kundër Italisë, [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{"fulltext":\["pretto"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-57561"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{)

⁵neni 10(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

⁶Neni 10(2), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

⁷Faqja 93 Kudeshkina kundër Ruisë, KEDNJ, 26 shkurt 2009

⁸Neni 6(2), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

⁹Këtë të drejtë KEDNJ e ka përsëritur në lëndën *Allenet de Ribemont kundër Francës*, 10 shkurt 1995. (aplikimi nr. 15175/89), fq. 38 e aktgjykimit.

❖ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Baza e përgjithshme për transparencë në procedurat gjyqësore e paraparë në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut përpunohet edhe më tej në Nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i cili mbështetet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parasheh që "(...) të gjithë janë të barabartë para gjykatave dhe tribunaleve. Çdokush ka të drejtë që lënda e tij/saj të shqyrtohet publikisht dhe me korrektësi nga ana e një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, e themeluar me ligj (...). Shtypi dhe opinioni publik mund të përjashtohen gjatë tërë ose një pjese të seancës gjyqësore në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike ose kur atë e kërkojnë interesat e jetës private të palëve ose sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta në rast se opinioni publik do të ndikonte mbi interesat e drejtësisë(...)"¹⁰

❖ Rekomandimi REC (2003)13¹¹ i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për dhënien e informacioneve përmes mediave rreth procedurave penale

Qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrihet unitet më i madh ndërmjet vendeve anëtare sa i përket mbrojtjes dhe realizimit të parimeve, të cilat janë trashëgimi e tyre e përbashkët. Duke u mbështetur mbi të drejtat dhe liritë fundamentale të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, njëkohësisht duke e përfillur edhe laramaninë e sistemeve juridike kombëtare rreth procedurave penale, në Rekomandimin e tij REC (2003)13 përcakton 18 parime, të cilat kanë të bëjnë me dhënien e informacioneve përmes mediave lidhur me procedurën penale.

Parimet¹² kanë të bëjnë me:

1. Informimin e publikut përmes mediave
2. Prezumimin e pafajësisë
3. Saktësinë e informacioneve
4. Qasjen në informacione
5. Mënyrën e dhënies së informacioneve
6. Informimin e rregullt gjatë procedurës penale
7. Ndalesën për keqpërdorimin e informacioneve
8. Mbrojtjen e privatësisë në kontekstin e procedurës aktuale penale

¹⁰ Neni 14 (1), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

¹¹ <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=51365>, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 10 korrik 2003.

¹² Për informacione më të hollësishme shih shtojcën 6 të këtij Udhëzuesi

9. Të drejtën për korrigjim ose të drejtën e përgjigjes
10. Mbrojtjen nga ndikimi i paragjykimeve
11. Publicitetin e dëmshëm para fillimit të procedurës gjyqësore
12. Lejen për hyrjen e gazetarëve
13. Qasjen e gazetarëve në sallën e gjykatës
14. Raportimin e drejtpërdrejtë dhe xhirimin brenda sallës së gjyqit
15. Mbështetjen për raportimin medial
16. Mbrojtjen e dëshmitarëve
17. Raportimin medial rreth realizimit të dënimit gjyqësor
18. Raportimit medial pas realizimit të dënimit gjyqësor

2. KORNIZA LIGJORE VENDASE

2.1. Dispozita relevante për gazetarët

Puna e gazetarëve dhe mediave është e rregulluar me më shumë akte, duke filluar nga Kushtetuta, e cila e garanton lirinë e shprehjes, përcjelljen dhe qasjen në informacione dhe e cila e ndalon censurën. Neni 16 i Kushtetutës e garanton lirinë e shprehjes, themelimin e mediave, por edhe të drejtën e korrigjimit ose mohimit, në qoftë se përmes mediave është publikuar ndonjë informacion i pasaktë dhe i pavërtetë. Puna e mediave elektronike është rregulluar me *Ligjin për themelimin e sipërmarrjes publike –radiodifuzioni i Maqedonisë*.¹³ Punën e mediave elektronike e mbikëqyr dhe sanksionon Agjencia për Media¹⁴, e cila nuk ka kompetenca të tilla mbi mediat e shtypura. Për ata vlejnjë dispozitat ndëshkimore të parashikuara në një numër ligjesh tjera.

Përgjegjësia personale e gazetarëve, prap se prap, sanksionohet në bazë të *Ligjit për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje*¹⁵, ku për veprën fyerje dhe shpifje, janë parashikuar gjopa për gazetarin dhe shtëpinë mediale – deri më 2000 euro për gazetarin/autorin e informacionit, kurse deri më 10 mijë euro për kryeredaktorin dhe 15 mijë euro për pronarin e shtëpisë mediale.

¹³ Fletorja zyrtare e RM nr..6/1998, 98/2000, 48/2009

¹⁴ Këshilli i mëparshëm radiodifuziv

¹⁵ Fletorja zyrtare e RM nr.143/2012

Prandaj:

- ❖ Gazetarët duhet të publikojnë informacione të sakta dhe të verifikuara, me të cilat nuk do të fshehin të dhëna thelbësore dhe të falsifikojnë dokumente dhe do të respektojnë privatësinë e personit, përveç atëherë kur interesi publik është më i fuqishëm se sa ai privat.
- ❖ Informimi në rast të aksidenteve, fatkeqësive natyrore, luftërave, tragjediive familjare, sëmundjeve, procedurave gjyqësore patjetër duhet të jetë i liruar nga senzacionalizmi.
- ❖ Gjatë procedurave gjyqësore, gazetarët duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, të raportojnë për të gjitha palët e përfshira në kontest dhe të mos sugjerojnë aktgjykim.
- ❖ Gazetarët nuk guxojnë të intervistojnë ose fotografojnë fëmijë – viktimë ose dëshmitarë nën moshën 16 vjeçare pa pajtimin e prindërve ose kujdestarëve, përveç nëse ajo nuk është në pajtim me të drejtat e fëmijëve. E njëjta vlen edhe për personat me aftësi të kufizuar, të cilët nuk janë në gjendje të gjykojnë me vetëdije.
- ❖ Gazetarët nuk do të përdorin gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisin dhunë dhe diskriminim në asnjë bazë (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientim seksual ose përcaktim politik).

Në legjislacionin kombëtar, mbrojtja e dëshmitarëve është e rregulluar me *Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve*¹⁶. Për atë që do të zbulojë identitetin e dëshmitarit të mbrojtur është paraparë dënim me burg së paku 4 vite, nëse ndodhin pasoja të rënda mbi shëndetin e dëshmitarit ose pasoja vdekjeprurëse, ai i cili e ka zbuluar identitetin e dëshmitarit të mbrojtur do të dënohet me burg së paku 8 vite, 15 vite ose burgim të përjetshëm. Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave është e rregulluar edhe me Ligjin për procedurë penale.¹⁷

*Ligji për informacione të besueshme (klasifikuara)*¹⁸ është mjaft i rëndësishëm, ndërsa gazetarët duhet ta njohin atë sepse mund të hasin në dokumente të besueshme dhe të cilat mund t'u shkaktojnë telashe nëse publikohen si të tilla. Informacionet mund të klasifikohen si: të brendshme, të besueshme, rreptësisht të besueshme dhe sekret shtetëror. Rëndësia e informacioneve të besueshme iu krijon problem gazetarëve sepse qasja e tyre në disa dokumente të caktuara është e vështirësuar për shkak të nivelit të besueshmërisë, kështu që poseduesit e këtyre

¹⁶ Fletora zyrtare e RM nr.38/2005, 58/2005

¹⁷ Nenet 226-232, Ligji për procedurë penale, Fletorja zyrtare e RM nr.150/2010, 100/2012

¹⁸ Fletorja zyrtare e RM nr.9/2004, 16/2005, 113/2007, 145/2010, 80/2012

informacioneve, duke iu referuar këtij ligji, refuzojnë t'i japin informacionet, duke mos e bërë gjithmonë tekstin komparativ se ku qëndron më shumë interesi publik, që nga ana tjetër është edhe intenca e *Ligjit për qasje të lirë në informacione të karakterit publik*.¹⁹ Ky ligj e siguron aspektin publik dhe transparencën në punën e poseduesve të informacioneve të karakterit publik, tek të cilat qasje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik.

Edhe rregullorja gjyqësore²⁰ parasheh që nëse ndonjë person e vështron lëndën gjyqësore, atëherë së pari duhet të largohen të gjitha informacionet e besueshme, e pastaj të lejohet vështrimi. Ndërsa, zyrtarët të cilët kanë ardhur në kontakt me informacione të besueshme, janë të obliguar të ruajnë sekretin, ashtu siç përcakton ligji.

Shpallja e informacioneve të besueshme të nivelit më të lartë, rreptësisht të besueshme ose sekret shtetëror paraqet bazë për përgjegjësi penale ndaj gazetarëve.

Krahas këtyre ligjeve, ajo çfarë është me rëndësi për gazetarët, të cilët raportojnë rreth procedurave gjyqësore janë edhe dispozitat e *Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale*.²¹ Gazetarët patjetër duhet të jenë të kujdesshëm kur bëhet fjalë për përdorimin e fotografive ose xhirimeve nga seancat gjyqësore që të mos shkelet privatësia e të akuzuarve. Përjashtim përbëjnë vetëm personat publik ose lëndët e interesit publik. Interesi publik patjetër duhet të vlerësohet me kujdes dhe të shihet se cilat të dhëna do të jenë në interes publik, pa marrë parasysh se bëhet fjalë për të dhëna personale.

Kur flitet për persona të mitur, të dhënat personale nuk guxon të publikohen pa mbrojtje të duhur ose me përdorimin e inicialeve; nëse publikohet fotografia e personit të mitur, atëherë fytyra duhet të jetë e hijësuar, zëri duhet maskuar, si dhe të hijësohet fytyra gjatë intervistimit ose një pjesë të prezantimit audio-vizuel, etj. Personat e mitur nuk mund vetvetiu të japin pëlqim nëse ndonjë informacion i caktuar lidhur me ta do të jetë publike ose jo. Pëlqim për publikimin e të dhënave personale, gazetarët duhet të kërkojnë nga prindërit ose kujdestarët e tyre. Madje edhe kur merret pëlqimi, mediat duhet të jenë të kujdesshëm për pasojat që mund të ndodhin me publikimin e të dhënave personale të personit të mitur.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale përcakton se xhirimi dhe publikimi i të dhënave për personat e përfshirë në procedurë gjyqësore ose administrative është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji sepse në atë mënyrë shkelet parimi i prezumimit të pafajësisë. Rekomandohet që në të gjitha rastet, në të cilat interesi publik është i madh dhe i arsyeshëm, mediat të sigurojnë anonimitet të duhur për personat e përfshirë drejtpërdrejtë në proces gjyqësor, ashtu siç bëhet edhe me publikimin e vendimeve anonime²² derisa të njëjtat bëhen të plotëfuqishme.

¹⁹ Fletorja zyrtare e RM nr.13/2006, 86/2008, 6/2010

²⁰ Fletorja zyrtare e RM nr.66/2013

²¹ Fletorja zyrtare e RM nr.7/2005, 124/2010, 135/2011


²² Shih Udhëzuesin e Ministrisë së Drejtësisë për mënyrën e publikimit dhe kërkimit të vendimeve gjyqësore në faqen e internetit të gjykatës, Fletorja zyrtare e RM nr.44/2011, Shtojca 5 e këtij Udhëzuesi

Gjatë proceseve gjyqësore, gazetarët do të hasin në situata që të shkruajnë dhe raportojnë për persona, pjesëmarrës në proces gjyqësor, të cilët nuk do të marrin pjesë në seancë për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore ose gjatë seancës kryesore do të zbulohen të dhëna për gjendjen e tyre shëndetësore. Të dhënat rreth gjendjes shëndetësore të personave bëjnë pjesë në kategorinë e të dhënave sensitive personale, prandaj është e ndaluar përpunimi i tyre. Të dhënat për shëndetin e qytetarëve, por edhe për shëndetin e personave publik nuk guxon të shpallen publikisht. Gjatë raportimit të proceseve gjyqësore, mediat duhet të përmbahen nga shpallja e hollësive rreth sëmundjeve dhe raportimet e tyre duhet t'i formulojnë ashtu që personi i caktuar, pjesëmarrës në procesin gjyqësor, nuk merr pjesë në gjykatë për shkak të arsyeve shëndetësore.

2.2. Kompetencat e gjykatave

a) Gjykatat themelore

Në shkallën e parë, gjykatat gjykojnë në këshilla të përbërë nga dy gjykatës dhe tre gjykatës-porotë për vepra penale për të cilat është parashikuar dënim me burgim prej 15 viteve deri në burgim të përjetshëm, ndërsa në këshilla të përbërë nga një gjykatës dhe dy gjykatës-porotë për vepra penale për të cilat është parashikuar dënim më i butë. Për vepra penale për të cilat si dënim është përcaktuar gjobë me para ose dënim me burgim deri në 5 vite, në shkallën e parë vendos gjykatësi individ. Grafiqet më poshtë i demonstrojnë kompetencat reale të gjykatave themelore rreth lëndëve penale:



GJYKATAT
THEMELORE
me kompetenca
të shtuara

Krahas kompetencave si gjykata themelore me kompetenca themelore për zonat e caktuara, vendosin edhe për vepra penale:

- Për të cilat me ligj është përcaktuar dënim me burgim mbi 5 vite dhe për vepra penale dhe kundërvajtje të kryer nga persona të mitur
- Të kryejnë hetime dhe veprimtari hetuese për vepra penale të fushëveprimit të vet,
- Të trajtojnë lëndë të ekstradimit,
- Për ankesa dhe parashtresa rreth çështjeve të fushëveprimit të vet, dhe
- Të vendosin rreth çështjeve për asistencë juridike ndërkombëtare të përcaktuar me ligj.

Gjykata themelore Shkupi I është gjykatë penale me kompetenca themelore dhe të shtuara për rajonin e komunave Qendër, Karposh, Gjorçe Petrov, Saraj, Kisela Vodë, Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Çair, Shuto Orizare, Çuçer Sandevë, Sopsisht, Studeniçan, Zelenikovë, Petrovec, Ilinden dhe Araçinë. Në kuadër të kësaj gjykate është themeluar edhe një drejtori e specializuar gjyqësore me kompetenca për gjykimin e veprave nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit për tërë territorin e Maqedonisë


“(…) Drejtorja e specializuar gjyqësore është kompetente për trajtimin e:

- veprave penale të kryera nga një grup i përbërë prej tre ose më shumë persona, i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore me qëllim të kryerjes së një ose më shumë veprave penale për të cilat është parashikuar dënim me burgim së paku katër vite, të cilët drejtpërdrejtë ose tërthorazi kanë synim të kenë dobi financiare ose ndonjë dobi tjetër,
- vepra penale të kryera nga një grup i strukturuar ose organizatë kriminale në territorin e Republikës së Maqedonisë ose shtete tjera ose kur vepra penale është përgatitur ose planifikuar në Republikën e Maqedonisë ose në ndonjë shtet tjetër,
- vepra penale si keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimeve sipas nenit 353 p. 5, marrjen e ryshfetit në shumë të konsiderueshme sipas nenit 357 dhe ndërmjetësim joligjor sipas nenit 359, të gjitha nga Kodi Penal, të kryera nga ndonjë funksionar i zgjedhur apo i emëruar, zyrtar ose person përgjegjës në cilësinë e personit juridik dhe
- vepra penale si prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim substanca narkotike, substanca psikotropike dhe prekursorë sipas nenit 215 p. 2, larje parashë dhe të ardhurave të tjera në shumë të konsiderueshme sipas nenit 273, kërcënim

terrorist të rendit kushtetues dhe sigurisë sipas nenit 313, dhënie rryshfet në shumë më të madhe sipas nenit 358, ndikim joligjor mbi dëshmitarë sipas nenit 368-a, shoqërim kriminal sipas nenit 394, organizatë terroriste sipas nenit 394-a, terrorizëm sipas nenit 394-b, vepra penale si tregti me njerëz sipas nenit 418-a, vepra penale si kontrabandim me migrantë sipas nenit 418-b, tregti me persona të mitur sipas nenit 418-g dhe për vepra të tjera penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga Kodi Penal, pa dallim nga numri i autorëve të veprave. (...)”²³

b) Gjykatat e Apelit

Punën sipas fushëveprimit të tyre, Gjykatat e apelit e realizojnë në këshilla të përbërë prej pesë gjykatësve (për vepra penale për të cilat parashihet dënim me burgim prej 15 vite deri në burgim të përjetshëm) ose prej tre gjykatësve (për vepra penale për të cilat parashihet dënim më i butë). Kur bëhet gjykim i shkallës së dytë, trupi gjykues përbëhet prej dy gjykatësve dhe tre gjykatësve-porotë. Seancat e trupit gjykues, me përjashtim të seancave publike, mbahen pa praninë e publikut. Fotografimi i seancave publike mund të bëhet vetëm me leje paraprake nga Kryetari i gjykatës.



b) Gjykata Supreme

Gjykata supreme seancat e vet i mban në trupa gjykues të përbërë prej pesë gjykatësve. Nëse është dorëzuar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Gjykatës supreme, atëherë për këtë kërkesë Gjykata supreme vendos në seancë të përgjithshme. Gjykata supreme në seancë të përgjithshme është kompetente të përcaktojë dhe shqyrtojë çështje të ndryshme rreth punës së gjykatave dhe gjykatësve, zbatimin e ligjeve dhe praktikën gjyqësore.²⁴

²³ Neni 32, Ligji mbi gjykatat, Fletorja zyrtare e RM nr.58/2006, 35/2008, 150/2010.

²⁴ Neni 37, Ligji mbi Gjykatat, Fletorja zyrtare e RM nr.58/2006, 35/2008, 150/2010.

GJYKATAT
SUPREME

Është kompetente:

- Të vendosë në shkallën e dytë kundër vendimeve të këshillave të vet kur kjo parashihet me ligj,
- Të vendosë në shkallën e tretë dhe të fundit rreth ankesave kundër vendimeve të gjykatave të apelit,
- Të vendosë rreth mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotëfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të vet kur kjo parashihet me ligj,
- Të vendosë për konflikt kompetencash ndërmjet gjykatave themelore të zonave të gjykatave të ndryshme të apelit, konflikt kompetencash ndërmjet gjykatave të apelit, konflikt kompetencash ndërmjet Gjykatës administrative dhe ndonjë gjykate tjetër si dhe të vendosë për bartjen e juridiksionit tek këto gjykata,
- Të vendosë me kërkesë të palëve dhe personave të tjerë në proces për shkeljen e të drejtës së gjykimit në afat të caktuar, në proces të caktuar me ligj para gjykatave vendase dhe në pajtim me dispozitat dhe parimet e KEDNJ dhe praktikën e GJEDNJ
- Të vendosë rreth detyrave të tjera që kërkon ligji

3. SHQYRTIMI I LIGJIT PËR PROCEDURË PENALE

Objekti themelor i Ligjit është të mundësohet realizimi i drejtë i procedurës penale, ahstu që asnjë i pafajshëm të mos dënohet, ndërsa autorit të veprës penale t'i shqiptohet dënim penal sipas kushteve të përcaktuara në Kodin Penal dhe në bazë të një procedure të realizuar sipas ligjit.

Në një periudhë të shkurtër kohore, ligji i procedurës penale pësoi ndryshime të mëdha, jo vetëm për shkak të ndryshimeve strukturore në pushtetin qendror dhe qëndrimin e tij ndaj qytetarit si subjekt i procesit penal, sidomos në rastet e formave të rënda të veprave penale, por edhe për shkak të rendit të përgjithshëm të shkencës dhe teknologjisë. Ky progres sjell mundësi të reja për verifikimin e fakteve gjatë procedurave penale, por ekzistojnë çështje të hapura juridike rreth pranueshmërisë së përdorimit të tyre. Nga ana tjetër, edhe globalizimi si proces i formimit të themeleve të kulturave të reja të njerëzimit në shek. 21, sidomos pas ndryshimeve politike të shkaktuara me shkatërrimin e të ashtuq. socializmit real në disa shtete dhe ndryshimet në kodet e tyre penale në kuptimin më të gjerë të fjalës, ka shpie deri tek ndryshimi i të kuptuarit për të drejtën penale si çështje ekskluzivisht e brendshme e shteteve kombëtare. Kjo situatë i hapi kufinj të ndikimeve të jashtme, të cilat deri atëherë ishin pothuajse të panjohur. Ato ndikime mund të vijnë nga struktura juridike të

shteteve të tjera ose çfarë ka më shumë rëndësi, nga e drejta penale ndërkombëtare si degë juridike, e cila ka fituar rëndësi gjatë 50 viteve të fundit dhe e cila sot e rregullon çështjen e kompetencave dhe procedurën e shumë gjykatave penale ndërkombëtare.

Çdo shtet reagon ndryshe ndaj dukurive të tilla. Gjykatat penale, por edhe mekanizmat ndëshkimore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale (p.sh.: gjykatat kushtetuese kombëtare, kontrolli i llojllojshëm mbishtetëror nga trupat për zbatimin e marrëveshjeve të shumta ndërkombëtare, siç janë gjykatat ndërkombëtare, trupat për mbikëqyrje (monitorim), organizatat joqeveritare, etj.) në mënyrë të ndryshme i gjejnë përgjigjet për pyetjen kryesore rreth objektivitetit dhe kuptimit të së drejtës moderne të procedurës penale. Pyetja është: „në çfarë mënyrë e drejta e procedurës penale duhet t’i përcaktojë supozimet për ndërhyrje dhe formën e veprimeve në procedurën penale?“, pastaj duke e kuptuar procedurën penale si një sërë veprimesh të cilat i ndërmarrin subjekte të caktuara në rast të probabilitetit të kryerjes së një vepre penale, e gjithë kjo me qëllim të gjetjes dhe eventualisht të ndëshkimit të fajtorit, e cili duhet të dallojë nga struktura e normave juridike të së drejtës së procedurës penale, përkatësisht procedurën që e rregullon këtë.

Këto norma janë tradicionale në disa sisteme juridike, siç është sistemi francez dhe anglez, të cilët këtë procedurë e quajnë procedurë penale sipas së cilës është e domosdoshme të caktohen subjektet që i ndërmarrin veprimet, kurse me qëllim të përcaktimit të aranzhimeve më të mira procesore për të siguruar cilësi të mirë dhe ruajtje të veprimeve individuale gjatë mbarëvajtjes së mëturjes të procedurës, si dhe garancat për respektimin e të drejtave personale dhe të pronës së qytetarëve për të cilët vlen procedura. Vetëm në këtë mënyrë procedura penale e rregulluar juridikisht mund të parandalojë që „asnjë i pafajshëm të mos dënohet“, gjegjësisht njëkohësisht të mundësojë që „autorit të veprës penale t’i shqiptohet dënim ose ndonjë masë tjetër sipas kushteve të paraparë me ligj dhe në bazë të procedurave juridikisht të realizuara para gjykatës kompetente“.²⁵

Ligji i ri për procedurë penale nënkupton të drejtën e re moderne, të reformuar sipas ligjeve evropiane, i cili duhet të sigurojë procedurë penale moderne në të cilën në mënyrë maksimale do të respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut, pra njëkohësisht do të jetë edhe jashtëzakonisht efikas.

3.1. Rregullat e përgjithshme mbi të cilat mbështetet Ligji i ri për procedurë penale

Një ndër parimet themelore mbi të cilat mbështetet Ligji i ri për procedurë penale është **parimi i një gjykimi të drejtë** në pajtim me të drejtën dhe praktikën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Personi që ngarkohet me vepër penale ka të drejtë që me korrektësi dhe në gjykim publik, në një procedurë adversare të mund t’i kontestojë akuzat kundër tij dhe të propozojë dhe paraqet prova në mbrojtjen e tij/saj para gjykatës së pavarur dhe të paanshme.

²⁵Shih fq. 59, 60 – *Historia e prokurorisë publike në Maqedoni – pozita, roli, perspektivat*, Jovan Ilievski, teza e doktoraturës.

Kohëve të fundit, parimi i procedurës së drejtë në disa vende të kontinentit evropian shfaqet si gurthemel themelorë dhe parim interpretues për interpretimin e disa nocioneve juridike të pacaktuara, të cilat nganjëherë i përdor ligjvënësi, si edhe për plotësimin e boshllëqeve juridike. Për shembull: çështja nëse dëshmitari ka të drejtë për asistent në proces; si të vendoset rreth pranueshmërisë së përdorimit të disa dëshmimeve të të ashtuq. hetues të fshehur dhe zyrtarëve të tjerë të policisë, të cilët kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në veprën penale të grupit kundër pjesëtarëve të së cilit zhvillohet procedurë penale; si duhet të reagojë gjykata ndaj parashtresës së mbrojtjes se procedura po zhagitet pa asnjë arsye, ndërsa i pandehuri gjatë tërë kohës gjendet në paraburgim, si edhe shumë pyetje të tjera.²⁶

E drejta për një gjykim të drejtë²⁷ është e drejtë fundamentale e njeriut, e cila në përmbajtjen e saj më të gjerë përfshin²⁸:

- të drejta në procedurën para gjykimit, ku bëjnë pjesë e drejta e lirisë, e drejta për njoftimin e personit që privohet nga liria, e drejta për avokat, e drejta për të komunikuar me botën e jashtme, e drejta për t'u paraqitur para një gjykatësi, e drejta për hetimin e arsyeshmërisë së privimit nga liria, si edhe të drejtat gjatë privimit nga liria,
- të drejta për paraqitje para një gjykate të themeluar me ligj dhe të paanshme, gjykim publik dhe korrekt në afat të arsyeshëm kohor, sipas ligjit dhe me procedurë të rregullt,
- të drejta gjatë seancës së gjykimit, gjatë procedurës, në të cilën bëjnë pjesë e drejta për mbrojtje materiale dhe zyrtare, e drejta për praninë personale gjatë seancës së gjykimit, e drejta për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të palës së akuzës dhe palës së mbrojtjes, e drejta për ankesë, e drejta për të pasur kohë të përshtatshme për përgatitjen e lëndës së mbrojtjes, më shumë të drejta gjatë marrjes në pyetje, prezumimi i pafajësisë, ndalesa për zbatimin retroaktiv të kodit penal, *ne bis in idem*, si edhe e drejta për barazi para gjykatës.²⁹

Parimi i prezumimit të pafajësisë paraqet garancë se personi i ngarkuar me vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa faji i tij nuk përcaktohet me aktgjykim të plotëfuqishëm gjyqësor. Organet shtetërore, mjetet për informim publik dhe subjektet tjera janë të obliguara që t'i përmbahen këtij parimi, kurse me deklaratat e veta publike për procedurën që është në rrjedhë nuk guxojnë t'i shkulin të drejtat e të akuzuarit dhe të dëmtuarit, si dhe pavarësinë dhe paanësinë gjyqësore.

²⁶ Arloth, F., Strafrecht, München, 1995, 8

²⁷ the right to a fair trial/hearing - neni 6 i Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut

²⁸ Pavišić, Kazneno pravo Vijeća Europe, Zagreb, 2006, 82 – 101

²⁹ Amnesty International On-line Fair Trials Manual

Për prokurorinë publike janë mjaft të rëndësishme parimi i akuzës, formalitetit dhe ligjshmërisë.

Parimi akuzator³⁰ (e ashtuq. parimi akuzues) përbëhet nga ajo se procedura penale mund të ngritet dhe mund të vazhdojë më tutje vetëm nëse ekziston kërkesë nga paditësi i autorizuar dhe ai në thelb është dominus i procedurës penale. Duke shikuar kuptimin më të ngushtë, pranimi i këtij parimi mundëson ndarjen e tre funksioneve themelore gjatë procedurës penale: ndjekja penale, mbrojtja dhe aktgjykimi dhe besimi i tyre tek subjekte të ndryshëm si bartës të atyre funksioneve. Subjektit të cilit i besohet funksioni i ndjekjes penale quhet paditës (*accusatory*), prandaj edhe parimi quhet akuzator (paditës, prokuror). Procedura është e lidhur edhe me kërkesën e paditësit të ngrit padi penale pa të cilën kjo procedurë nuk mund të fillojë, prandaj nëse kërkesa tërhiqet, atëherë procedura ndërpritet. Veçimi i akuzës nga gjykimi është shprehur me maksimën latine *Nemo iudex sine actore* – askush nuk mund të jetë gjykatës pas mos ekzistuar akuza, ndërsa procedura mund të zhvillohet vetëm kundër personit i cili ngarkohet me padinë penale dhe vetëm për veprën e përshkruar në akuzë. Ky parim është krijuar kundrejt parimit të inkuizicionit dhe procedurës së mesjetës, sipas së cilës përcaktimi i provave për akuzën ka qenë në kompetenca të organit të gjyimit, ndërsa akumulimi i tillë i aktiviteteve tek vetëm një organ gjyqësor – gjykata, ka shpër që ai organ të këmbëngul që i akuzuari të shpallet fajtor, kështu duke e anashkaluar mundësinë tjetër – se i akuzuari nuk është fajtor dhe se mund të lirohet.³¹

Parimi i formalitetit nënkupton se fillimi dhe zhvillimi i procedurës është detyrë zyrtare e organeve shtetërore, e cila kryhet për interes të shoqërisë, pa dallim nga vullneti i personit që është i dëmtuar me padinë penale. Ky parim e përcakton të drejtën e prokurorit kompetent publik që të ndërmerr ndjekje penale pa dallim nga qëndrimi i të dëmtuarit, madje edhe nëse ai kundërshton në mënyrë eksplicite.

Sipas **parimit për ligjshmërinë e ndjekjes penale**³² prokurori publik është i obliguar që të ndërmarrë ndjekje penale për vepra penale që përndiqen në bazë të detyrës zyrtare, gjithmonë kur për atë janë plotësuar kushtet ligjore, pa dallim nga ajo nëse vetë është i bindur në përshtatshmërinë dhe dobinë e ndjekjes penale në raste të caktuara. Këto kushte ligjore janë si në vijim: të ekzistojnë baza të mjaftueshme të dyshimit se është kryer veprë penale, të ekzistojnë prova në bazë të së cilave mund të pritët të shqiptohet dënim me aktgjykim dhe të mos ekzistojnë pengesa për zhvillimin e procedurës penale.

Përrjashtim nga zbatimi i këtij parimi mund të ketë vetëm në rastet kur vetë Ligji e parasheh atë në mënyrë të qartë. Në disa sisteme juridike, prokurori publik me veprimin e tij nuk është i obliguar me parimin për ligjshmëri, por përkundrazi ka të drejtë oportuniteti të

³⁰ Neni 17, Ligji për procedurë penale, Fletorja zyrtare e RM nr.150/2010, 100/2012

³¹ Shih fq. 74, 75 – *Historia e prokurorisë publike në Maqedoni – pozita, roli, perspektivat*, Jovan Ilievski, teza e doktoraturës.

³² Neni 18, Ligji për procedurë penale, Fletorja zyrtare e RM nr.150/2010, 100/2012

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

ndjekjes. Ky është një rregull procesi që ka të bëjë me rregullimin me ligj të ndjekjes nga ana e prokurorit publik, ndërsa sipas së cilës për realizimin e funksionit të ndjekjes penale nuk është e nevojshme që të ekzistojnë vetëm supozimet e caktuara me ligj, por krahas tyre nevojitet që në çdo rast të dhënë, prokurori publik të vlerësojë nëse ndjekja penale është e përshtatshme, përkatësisht me oportunitet, nga pikëpamja e interesit shtetëror, duke pasur parasysh, për shembull, nëse ndjekja penale do të shkaktonte reagim të pavolitshëm tek opinioni publik, etj. Në të drejtën procesore të vendit, siç theksuam edhe më herët, nuk është miratuar parimi i oportunitetit të ndjekjes penale, mirëpo vlen parimi i ligjshmërisë.

Prap se prap, ekzistojnë disa përjashtime të caktuara nga ky parim, të cilat i mundësojnë prokurorit publik të vlerësojë oportunitetin e ndjekjes penale. Kryesisht kjo ka të bëjë me procedurën e të miturve, ndërsa kur bëhet fjalë për autorë të rritur të veprave penale parimi i oportunitetit zbatohet si në rastet në vijim:

- Kur në Kodin Penal është përcaktuar se gjykata mund të lirojë autorin e veprës penale, nëse prokurori publik vlerëson se vetë aktgjykimi pa sanksion penal nuk është i nevojshëm;
- Kur në Kodin Penal për vepër penale është përcaktuar gjobë ose dënim me burgim deri në tre vite, ndërsa i dyshuari ka penguar që të ndodhin pasojat e dëmshme ose e ka kompensuar tërë dëmin, nëse prokurori publik vlerëson se sanksioni penal është i pabazë; ose
- I dyshuari, si pjesëtar i një grupi të organizuar, bande ose shoqërim tjetër kriminal, bashkëpunon vullnetarisht para ose pas zbulimit ose gjatë procedurës penale dhe nëse ai bashkëpunim ose deklaratë e atij personi ka rëndësi thelbësore për procedurën penale.

Parimi i kontraditës nuk është formuluar në mënyrë të veçantë me ligj, por rrjedh nga e drejta për gjykim të drejtë dhe pozitën procesore të palëve në procedurë. Sipas këtij parimi, gjykata dhe organet tjera shtetërore të cilët janë të përfshirë në procedurën penale, janë të obliguar t'i dëgjojnë të dy palët ndërmjet të cilëve zhvillohet kontesti penal e juridik *audiatur et altera pars*. Kjo iu mundëson palëve të shprehin mendimin e tyre për të gjithë çështjet kontestuese faktike dhe juridike, të cilat janë lëndë e debatit para gjyqit, si edhe të paraqesin prova për të mbështetur tezat e tyre. E drejta për procedurë adversare tek lëndët penale nënkupton se prokuroria dhe pala e mbrojtjes patjetër duhet të kenë mundësi t'i dëgjojnë pohimet dhe provat e palës së kundërt.³³

Prap se prap, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo nuk është absolute sepse mund të ekzistojnë interesa të kundërta, si p.sh. mbrojtja e dëshmitarëve. Këto arsye mund

³³ Brandstetter v. Austria

të pranohen dhe të vijë deri te heqja dorë nga e drejta për procedurë adversare, por vetëm kur kjo është shumë e domosdoshme.³⁴

Parimi verbal kërkon që të gjitha provat të paraqiten në seancën publike në formë gojore dhe me mundësinë për debat kontradiktor. Verbaliteti mundëson që më lehtë dhe me sukses të zhvillohet parimi i kontraditetit gjatë seancës, rigjallërimin e aspektit të drejtëpërdrejtë dhe aspektin publik, si dhe kontribuon në përcaktimin e të vërtetës.

Parimi i aspektit të drejtëpërdrejtë është parim në procedurën penale, sipas së cilit paraqitja e të gjitha fakteve dhe provave të nevojshme për formulimin e aktvendimit patjetër të zhvillohet në seancë publike para gjykatës që do të merr aktvendimin, në një procedurë kontradiktore. Kjo nënkupton se gjykata i kupton faktet dhe provat pa ndërmjetësimin e organeve të tjera, në mënyrë origjinale dhe me shqisat e veta dhe në atë mënyrë fiton përshtypje të drejtëpërdrejtë për tërë materialin e provave, në bazë të së cilit do të përcaktohet aktvendimi i tij.

Parimi i pjesëmarrjes publike është një ndër parimet themelore mbi të cilat bazohet çdo procedurë penale demokratike e një shteti juridik, në të cilin puna e të gjitha organeve shtetërore dhe shoqërore duhet t'i nënshtrohet kontrollit të publikut, e sipas kësaj edhe puna e organeve të drejtësisë. Parimi i pjesëmarrjes së publikut në seancën kryesore dhe gjatë shqiptimit të aktgjykimit është ranguar në nivelin e parimeve kushtetuese. Kështu edhe Kushtetuta ynë e ndjek këtë tendencë dhe përcakton se seancat gjyqësore dhe shqiptimi i aktgjykimit duhet të bëhen publikisht, ndërsa publiku mund të përjashtohet në raste të përcaktuara me ligj.³⁵

E drejta për gjykim publik i përfshin të drejtat për dëgjime publike dhe verbale si dhe shqiptimin publik të aktgjykimit.³⁶ E drejta për dëgjim publik e supozon verbalitetin.³⁷ Dëgjimi publik është karakteristikë themelore e të drejtës për gjykim të drejtë.³⁸ Karakteri publik i punës së institucioneve gjyqësore i mbron palët nga zbatimi sekret i të drejtës pa mbikëqyrjen e publikut. Mënyra e tillë e punës e rrit besimin e qytetarëve tek gjyqësori e gjithashtu e përfshin edhe të drejtën për praninë e palëve para gjykatës.³⁹ Njohja e kërkesës së zbatimit të së drejtës patjetër duhet të jetë transparente dhe publiku kontribuon për arritjen e qëllimit të procedurës së drejtë.⁴⁰ Publik mund të quhet si publiku më i ngushtë, i jashtëm, si edhe publiku më i gjerë, të cilëve duhet t'u lejohej prania gjatë seancave dëgjimore.⁴¹

³⁴ Rowe and Davies v. the United Kingdom

³⁵ Neni 102, p. 1 dhe 2 të Kushtetutës

³⁶ public hearing and pronouncement of judgement

³⁷ Fischer v. Austria; Dondarini v. San Marino

³⁸ Axen v. Germany

³⁹ Ekbatani v. Sweden; Collozza v. Italy

⁴⁰ Axen v. Germany

⁴¹ Riepan v. Austria

E drejta për prani sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kryesisht është e rëndësishme në procedurën e shkallës së parë gjatë verifikimit të fakteve, mirëpo nëse gjykata më e lartë përcakton rrethana të rëndësishme për rezultatin e procedurës, atëherë kjo vlen edhe për procedurën e asaj gjykate.⁴²

Kjo dispozitë e garanton realizimin edhe të parimit të aspektit të drejtpërdrejtë.⁴³

Duke konsideruar se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjithnjë vlerëson se ekziston shkelje duke pasur parasysh procedurën e përgjithshme të mbajtur në institucionet juridike vendase, shkelje që ka të bëjë me mosmbajtjen e gjykimit publik në procedurën e shkallës së parë, atëherë kjo mund të korrigjohet duke e mbajtur gjykimin publik në procedurë para gjykatës më të lartë.⁴⁴

Nga ana tjetër, mosmbajtja e seancës dëgjimore para gjykatës ankimore, e cila ka kompetenca të plota të vendos për çështjet faktike dhe juridike dhe e cila vendos për fajin, paraqet shkelje të kërkesës për seancë dëgjimore publike. Prap se prak, nuk është e nevojshme seancë dëgjimore gjatë procedurës ankimore në qoftë se gjykata më e lartë vendos vetëm për çështje juridike.⁴⁵

Aktgjykimi gjithmonë duhet të shqiptohet publikisht, madje edhe në ato raste kur publiku është përjashtuar nga seanca dëgjimore.⁴⁶ Mirëpo, nëse bëhet fjalë për gjykatë supreme ose të kasacionit në një shtet të caktuar, do të konsiderohet se është kënaqur kërkesa për shqiptim publik të aktgjykimit në qoftë se aktgjykimi i është dorëzuar nëpunësit të gjykatës dhe në atë mënyrë është në dispozicion për të gjithë.⁴⁷

Në bazë të kësaj, nuk mjafton që aktgjykimi të jetë në dispozicion vetëm për personat me interes legjitim.⁴⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kontekstin e procedurave disiplinore thekson se as shkrimi e as fryma e Konventës nuk e pengon heqjen dorë nga e drejta për dëgjim publik.⁴⁹

Ky anulim patjetër duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe nuk guxon të jetë në kundërshtim me interesin e rëndësishëm të publikut. Kjo nënkupton se anulimi nuk mund të bëhet në mënyrë të heshtur.⁵⁰ Kufizimi i të drejtës për gjykim publik dhe shqiptimi publik i aktgjykimit është rregulluar në veçanti tek lëndët ku janë përfshirë fëmijë.⁵¹

⁴² Kremzow v. Austria

⁴³ principle of immediacy

⁴⁴ Diennet v. France

⁴⁵ Ekbatani v. Sweden

⁴⁶ Campbell and Fell v. the United Kingdom

⁴⁷ Pretto et al. v. Italy

⁴⁸ Szücs v. Austria; Sutter v. Switzerland; Werner v. Austria

⁴⁹ Albert and Le Compte v. Belgium; Le Compte, Van Leuven and De Meyere v. Belgium

⁵⁰ Hakansson and Stuesson v. Sweden

⁵¹ B. and P. v. the United Kingdom

3.2. Sistematizimi i Ligjit për procedurë penale

Ligji për procedurë penale përmban gjithsej 568 nene, të cilat janë të ndarë në tre pjesë:

- pjesa e parë – dispozita të përgjithshme;
- pjesa e dytë – rrjedha e procedurës, dhe
- pjesa e tretë – procedurat e veçanta.

Pjesa e parë i rregullon parimet themelore të procesit, domethënien e shprehjeve ligjore dhe dispozita të tjera, çështjet lidhur me subjektet (gjykatat, prokurorinë publike dhe policinë gjyqësore, viktimën, të dëmtuarin dhe paditësin privat, të akuzuarin dhe avokatin dhe ndihmën juridike), çështjet lidhur me veprimet e procesit (parashtresat dhe proçesverbalet, afatet, shpenzimet, kërkesa pronësore-juridike, marrja dhe shqiptimi i vendimeve, dorëzimi i shkrësive dhe lajmërimi i shkrimeve, realizimi i vendimeve dhe mbrojtja e të dhënave personale), masat dhe veprimet procedurale për sigurimin e personave dhe provave (masa për sigurimin e pranisë së personave, masa për gjetjen dhe sigurimin e personave dhe objekteve, prova dhe masa të veçanta hetimore).

Pjesa e dytë e propozim ligjit përmban dispozita lidhur me rrjedhën e procedurës. Kjo procedurë përbëhet prej fazave të mëposhtme:

- procedura paraprake në të cilën bëjnë pjesë procedura parahetimore⁵² dhe procedura hetimore⁵³,
- aktakuza dhe vlerësimi i aktakuzës⁵⁴,
- seanca kryesore dhe akgjykimi⁵⁵ dhe
- procedura për mjetet juridike në të cilën bëjnë pjesë mjetet juridike të rregullta⁵⁶ dhe të jashtëzakonshme.⁵⁷

Procedura e shkurtuar⁵⁸, marrja e vendimit në bazë të marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit⁵⁹, proces në të cilin i akuzuari dhe prokurori publik, për lëndën penale, marrin vendim të pranueshëm për të dy palët dhe për të cilën marrëveshje pastaj vendos gjykata⁶⁰ dhe në këtë mënyrë marrëveshja e zëvendëson seancën e rregullt gjyqësore dhe

⁵² Kreu XX

⁵³ Kreu XXI

⁵⁴ Kreu XXII

⁵⁵ Seksioni V.

⁵⁶ Kreu XXVI

⁵⁷ Kreu XXVII

⁵⁸ Kreu XXVIII

⁵⁹ Kreu XXIX

⁶⁰ Definicioni sipas fjalorit të Black's Law

⁶¹ Prikkladnost pregovaranja o krivici u medjunarodnim krivicnim predmetima u Bosni i Hercegovini – Ermelina Ahmetaj Hrelja, 2008.

kjo ndikon në kursimin e parave dhe kohës⁶¹; procedura për ndërmjetësim⁶² dhe procedura për lëshim të urdhëresës penale⁶³ janë të rregulluara në seksionin D të titulluar si Procedura të përshpejtuara.

Pjesa e tretë e Ligjit ka të bëjë me procedurat e veçanta me të cilat rregullohen procedurat e veçanta specifike, përkatësisht:

- procedura për shqiptimin e masave alternative, ⁶⁴
- procedura e personave juridik, ⁶⁵
- procedura për zbatimin e masave të sigurisë, sekuestrimin e pronës dhe përdorjes së pronës, marrjen e objekteve nga prona dhe revokimin e dënimit me kusht, ⁶⁶
- procedura për marrjen e vendimit për kohëzgjatje më të shkurtër të dënimit – ndalesë, përfundimi i pasojave juridike të dënimit dhe fshirja e dënimit, ⁶⁷
- procedura për kompensim të dëmeve, rehabilitim dhe për ushtrimin e të drejtave të tjera për persona që janë dënuar pa arsye ose janë privuar nga liria në mënyrë të paligjshme⁶⁸, dhe
- mandat arresti dhe shpallja⁶⁹

Ligji përmban nene të cilat janë të titulluara për gjetjen më të lehtë të tyre nga ana e praktikuesve, por ka domethënie edhe për interpretimet e dispozitave ligjore sepse titulli e paraqet edhe qëllimin edhe kuptimin e dispozitës.

➤ *Provat dhe procedura e provave*

Provat e parashikuara me Ligjin për procedurë penale janë:

1. Dëshmia e të akuzuarit
2. Ekzaminimi i dëshmitarëve
3. Këqyrja dhe rikonstruimi
4. Ekspertiza
5. Inçizimi dhe provat elektronike

⁶² Kreu XXX

⁶³ Kreu XXXI

⁶⁴ Kreu XXXII

⁶⁵ Kreu XXXIII

⁶⁶ Kreu XXIV

⁶⁷ Kreu XXV

⁶⁸ Kreu XXVI

⁶⁹ Kreu XXVII

Sipas procedurës së re, propozimin dhe paraqitjen e provave e bëjnë palët e përfshira. Gjatë procedurës së provave, provat paraqiten me rradhë sipas rënditjes së mëposhtme:

- provat e palës së akuzës,
- provat e palës së mbrojtjes,
- provat e palës së akuzës për të përgënjeshtuar provat e palës së mbrojtjes (replikimi),
- provat e palës së mbrojtjes si kundërpërgjigje të përgënjeshtimit (duplikimi), dhe

provat të cilat janë të rëndësishme për vlerësimin e sanksionit penal. Gjatë paraqitjes së provave të palës së akuzës, përkatësisht të palës së mbrojtjes, pala e kundër ka të mundësi të caktojë forma procedurale të përgjigjeve, ndërsa gjykata ka mundësi shumë të kufizuara gjatë paraqitjes së provave. Ligji i ri për procedurë penale parasheh një risi lidhur me mënyrën e ekzaminimit⁷⁰. Ndryshe nga praktika e deritanishme sipas së cilës gjykata luante rol aktiv dhe e bënte ekzaminimin, ndërsa palët parashtrojnë pyetje në fund të ekzaminimit edhe atë jo drejtpërdrejt, por përsëri nëpërmjet gjykatësit, tani sipas Ligjit të ri, palët e bëjnë ekzaminimin (marrjen në pyetje), ndërsa gjykatësi mbetet pasiv. Në fakt, gjatë paraqitjes së provave lejohet që palët të bëjnë ekzaminim direkt, kundërekzaminim dhe ekzaminimi plotësues. Ekzaminimin direkt e bën pala që e ka propozuar dëshmitarin, përkatësisht ekspertin si provë.⁷¹ Kur pala do të përfundojë me ekzaminimin direkt, atëherë fillon të bëjë ekzaminimin pala e kundërt dhe kjo quhet kundërekzaminim i dëshmitarit ose ekspertit⁷². Përderisa tek ekzaminimi direkt vlejnjë rregullat e njohura për të gjithë ne (ndalesa për pyetje sugjeruese, pyetje që përmbajnë përgjigje në vete, etj), tek kundërekzaminimi ato rregulla nuk vlejnjë dhe pala mund të parashtrojë pyetje, të cilat dëshmitari ose eksperti do të duhet të përgjigjet shpeshherë me „po“ ose „jo“. Dëshmitë e siguruar gjatë procedurës hetimore mund të përdoren gjatë kundërekzaminimit ose gjatë përgënjeshtimit të dëshmitëve të dhëna ose si kundërpërgjigje të përgënjeshtimit. Ekzaminimin plotësues⁷³ e kryen përsëri pala e cila e ka ftuar dëshmitarin ose ekspertin, ndërsa pyetjet që parashtrohen gjatë këtij ekzaminimi janë të kufizuara me pyetjet e parashtuara gjatë kundërekzaminimit. Gjatë kundërekzaminimit dhe ekzaminimit plotësues të palëve, gjatë marrjes në pyetje, ndihmë mund të ofrojnë edhe këshilltarët teknik.⁷⁴

Pas përfundimit të ekzaminimit të palëve, kryetari dhe anëtarët e këshillit mund të parashtrojnë pyetje për dëshmitarin, përkatësisht ekspertin.

⁷⁰ Neni 388, Ligji për procedurë penale, Fletorja zyrtare e RM nr.150/2010, 100/2012

⁷¹ examination-in-chief

⁷² cross-examination (kundërekzaminimi)

⁷³ re-examination (ekzaminimi plotësues)

⁷⁴ Neni 21, pika 19 e Ligjit për procedurë penale, Fletorja zyrtare nr.150/2010, 100/2012: “ (...) 19) Këshilltarë teknik janë personat ekspertë nga regjistri i ekspertëve, të cilët palët i angazhojnë atëherë kur gjatë procedurës kanë nevojë për ndihmën e tyre eksperte të ndonjë fushe të caktuar. (...)”

➤ *Braktisja e padisë subsidiare*

Me Ligjin e ri për procedurë penale braktiset padia subsidiare. Sipas këtij koncepti, paditësi i vetëm i autorizuar i veprave penale të cilat përndiqen sipas detyrës zyrtare, është prokurori publik. Ligji parasheh që prokurori publik me aktvendim të refuzojë kallëzimin penal nëse nga ky kallëzim del që vepra e denoncuar nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, nëse lënda është vjetërsuar ose nëse vepra është amnestuar ose falur, nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale ose nëse nuk ekzistojnë arsye dyshimi se i denoncuari e ka kryer veprën penale. Arsyet për refuzimin e kallëzimit penal janë identike me Ligjin e mëparshëm për procedurë penale, mirëpo procedura që pason pas marrjes së aktvendimit është ndryshe. Në fakt, aktvendimi për refuzimin e kallëzimit penal i dorëzohet të dëmtuarit dhe ai/ajo mund brenda tetë ditëve të parashtrijë ankesë deri te prokurori publik një nivel më lartë, ndërsa parashtruesi i kallëzimit njoftohet me arsyet e refuzimit. Në qoftë se ankesa nuk lejohet ose nuk është në kohë të duhur, prokurori më i lartë publik do të njoftojë të dëmtuarin me shkresë. Prokurori më i lartë publik në afat prej 30 ditëve pas pranimit është i obliguar të vendos sipas ankesës së të dëmtuarit. Duke e trajtuar ankesën, prokurori më i lartë publik mundet me aktvendim të vërtetojë aktvendimin për refuzim të kallëzimit penal ose të pranojë ankesën dhe të obligojë prokurorin në nivel më të ulët publik të vazhdojë me procedurën.

➤ *Marrëveshja e prokurorit publik me të dyshuarin*

Ligji i ri për procedurë penale përbën dispozita të cilat për herë të parë në legjislacionin tonë ndëshkimit e rregullojnë mundësinë për arritjen e marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshuarit rreth llojit dhe peshës së sanksionit penal, parashohin status të ndryshëm për deklaratën e pranimit të fajit në fazën e kontrollit të aktpadisë dhe të pranimit të fajit gjatë seancës kryesore në procedurën e rregullt, si edhe gjatë seancës në procedurën e shkurtuar se sa që ishte rasti deri më tani kur pranimin e fajit e dorëzonte para gjykatës.⁷⁵ I dyshuari, para fillimit të ekzaminimit të parë, do të njoftohet edhe për të drejtën e arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajit me prokurorin publik.⁷⁶

Nga dispozitat ligjore qartë del se subjektet e negociatave për pranimin e fajit janë prokurori nga njëra anë dhe i dyshuari dhe mbrojtësi i tij nga ana tjetër. Sidoqoftë, palët e përfshira në negociata janë palë dhe vetë negociatat duhet të zhvillohen, sipas rregullit, ndërmjet mbrojtësit ligjor dhe prokurorit. Gjykata nuk është e përfshirë në këtë fazë.

⁷⁵ Buzharoska, G., marrëveshja për fajin: Doracak për profesionistë (Gordana Buzharoska, Majkal G. Karnavas, Dejvid Re), Shkup, Misioni i OSBE në Shkup, 2010.

⁷⁶ Neni 206 p. 6, Ligji për procedurë penale, Fletorja zyrtare e RM nr.150/2010, 100/2012

➤ *Mbrojtja e hetimit dhe të drejtat e personave në proces*

Fjala e pamatur dhe e thënë publikisht mund të ketë pasoja të rënda, madje mund të jetë edhe me rrezik ndaj sigurisë së disa personave, pikërisht për shkak të abuzimit të lirisë së të shprehurit, gjegjësisht lirisë së informimit. Përfaqësuesit e mediave gjithnjë duhet të jenë të vetëdijshëm se në një shoqëri nuk ekzistojnë të drejta të pakufizuara për asnjërin, përkatësisht të drejtat e të gjithëve janë të kushtëzuara njëra me tjetrën.

Në këtë drejtim:

Gjatë procedurës hetimore:

- Ndalohet zbulimi i identitetit të personave të mitur.
- Ndalohet të zbulohet identiteti i dëshmitarëve të mbrojtur.
- Të gjithë të dhënat gjatë hetimit janë sekrete.

Interesi i mediave është legjitim që të informojnë për çdo fazë të procedurës penale, mirëpo mediat duhat t'i përfillin arsyet e precizuara me ligj për 'embargo' të kufizuar dhe të përkohshme të informacioneve për veprat penale dhe autorët e tyre në faza të caktuara të procedurës. Masat e këtilla patjetër duhet të jenë të arsyeshme me interesin për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe të mirave të tjera shoqërore, si edhe nevojën për të zbardhur veprat penale, kurse autorët e tyre të nxirren para drejtësisë.

Nuk është profesionale nëse mediat, në garën për informacione dhe në insistimin e tyre të jenë të parët, të 'nguten' me publikimin e informacioneve të besueshme/sekrete dhe në atë mënyrë t'i ndihmojnë autorit të veprës penale të shmang arrestimin ose ndjekjen penale.⁷⁷ Publiku mund të merr informacione rreth ndonjë lënde vetëm pas dorëzimit dhe verifikimit të aktakuzës.

4. "PUBLIKU" GJATË PROCEDURËS PARAHETIMORE DHE HETIMORE

4.1. Njoftim për punën e institucioneve gjyqësore

Publiku ka të drejtë të pranojë informacione në kohë të duhur rreth aktiviteteve të prokurorisë publike dhe gjykatave. Njoftimi për procedurat penale dhe zbatimimi i të drejtës penale dhe funksioni i prokurorisë dhe gjykatave e bëjnë punën e tyre të

⁷⁷ Fq. 8, Guidë për gazetarë për procedurën penale, Instituti për media i Malit të Zi

dukshme dhe në këtë mënyrë sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparencës në punën e sistemit të jurisprudencës. Në interes të forcimit të njoftimit profesional rreth hetimeve dhe proceseve gjyqësore ekziston nevoja për sjelljen e rekomandimeve për ata që e bëjnë njoftimin. Rekomandimet e këtilla do të duhet të pasqyrohen në Kodin etik të gazetarëve në vendin tonë.

Prokuroria publike, përkatësisht organet e gjyqësorit të involvuar në procedurën e mëparshme, gjegjësisht në fazën parahetimore ose e ashtuq. hetimi policor, si edhe në fazën e procedurës hetimore, duhet t'u mundësojnë gazetarëve informacione të duhura. Ato duhet të jenë në formë kumtesash për publikun, deklaratash, intervistash, azhurnimin e rregullt të faqes së internetit të prokurorisë publike, fotografi, xhirime audio e video. Në këtë drejtim, prokurori publike tashmë punon në mënyrë aktive në hartimin e Strategjisë për marrëdhënie me publikun⁷⁸, e cila mes tjerash parasheh edhe themelimin e një departamenti për marrëdhënie me publikun, emërimin e personave përgjegjës dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme, zhvillimin e një programi për prezantimin e informacioneve para publikut (kumtesa për publikun, deklarata dhe intervista, shkathtësi për paraqitje publike, komunikim në kriza – kontrollë të dëmit), krijimin e veglave për mbikëqyrjen e mediave, reagimet dhe përgjigjet e informacioneve të publikuara të pasakta.

Teksti më poshtë paraqet një pikëpamje shtesë për avancimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorisë publike dhe mediave dhe jep një sërë rekomandimesh, të cilat në të ardhmen do të mund të përpunohen edhe më tej dhe të gjejnë zbatim të duhur në praktikë.

4.2. Rekomandime dhe propozime për mënyrat e informimit nga prokuroria publike

Informacionet që përcillen nga prokuroria publike nëpërmjet kumtesave për publikun duhet të jenë të shkurtra dhe të kuptueshme dhe tu japin përgjigje pyetjeve themelore (cili, çfarë, kur, ku dhe si).

➤ *Pse informacione të shkurtra dhe të kuptueshme?*

- Informacionet e shkurtra mund të gjejnë vend në lajme, gazeta, stacione televizive dhe radio, si edhe nëpër artikuj gazetareske.
- Informacionet e kuptueshme të përcjellura në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme janë të nevojshme që së pari t'i kuptojë gazetari dhe redaktori e

⁷⁸Strategjia për marrëdhënie me publikun e prokurorisë publike është në hartim e sipër nga një ekip ekspertësh vendas dhe të huaj, si pjesë e projektit të përbashkët ndërmjet Departamentit për sundimin e së drejtës pranë Misionit të OSBE-s në Shkup dhe Prokurorisë publike.

pastaj të publikohen përshtatshmërisht për opinion publik, duke pasur parasysh se nuk janë të gjithë gazetarët juristë.

- Informacionet e prokurorisë publike duhet të kumtohen në kohë të duhur.

Koha më e mirë për të përcjellur informacione është në orët e mëngjesit ose në orët e hershme të pasdites sepse tek shtëpitë mediale ekziston një procedurë e caktuar për përpunimin e informacioneve. Gazetat ditore mbyllën në orët e mbrëmjes, ndërsa lajmet kryesore të televizioneve janë rreth orës 19.00 - 19.30. Që lajmi të jetë në media ditën e njëjtë, nevojitet që ai të jetë i gatshëm deri në ora 17.00, që të aprovohet nga redaktori, lekturohet ose montohet. Natyrisht vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur e tërë kjo përshtatet me situatën e dhënë. Informacionet që arrijnë në orët e mbrëmjes dhe të cilat nuk kanë rëndësi të veçantë, nuk do të gjejnë vend tek mediat. Kur bëhet fjalë për çështje jashtëzakonisht interesante, të cilat janë të rëndësishme për shoqërinë në të cilën jetojmë, prokuroria publike duhet t'i drejtohet mediave ose nëpërmjet kumtesave për publikun dhe të jep përgjigje për pyetjet e sipërpërmendura ose të organizojë konferencë për gazetarë. Konferencat për gazetarë janë mjaft të rëndësishme kur prokuroria publike dëshiron të prezantojë punën e vet.

Rekomandim: Konferencat për gazetarë të organizohen në gjashtë muaj ose në nivel vjetor, kurse në baza ditore të mbahen kur bëhet fjalë për situata interesante për publikun në atë moment.

Me qëllim që informacionet të jenë të plota nevojitet edhe dhënia e fotografive, të cilat shpeshherë nëpër media, sidomos në shtyp, flasin më shumë se sa vetë teksti, ose të ofrojnë inçizime audio-video, varësisht nga ajo se për cilën media flitet.

Rekomandim: Në situata të arrestimit të ndonjë personi për të cilin publiku padyshim do të shfaqë interesim, më mirë është që prokuroria publike të organizojë konferencë për gazetarë gjatë së cilës gazetarët do të mund t'i fotografojnë dhe xhirojnë bashkëbiseduesit.

➤ Kur të pranojnë informacione nga prokuroria publike?

Shpeshherë gazetarët merren me analiza, histori ose ngjarje të cilat kanë rëndësi të veçantë për qytetarët. Nëse ndonjë gazetar merret me ndonjë temë të caktuar të kriminalitetit siç është për shembull trafikimi me njerëz, prostitucioni ose ndonjë lloj tjetër kriminaliteti, ai/ajo zakonisht i drejtohet prokurorisë publike që të zbulojë nëse ekzistojnë hetime aktuale dhe sa aktakuza ka për ato vepra penale. Kjo do të ndodh shumë shpesh në të ardhmen duke konsideruar se Ligji i ri për procedurë penale, sipas të cilit prokuroria publike do të zhvillojë procedurën hetimore, ka hyrë në fuqi qysh më datë 1 dhjetor 2013. Duke

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

konsideruar kompetencat e reja të prokurorisë publike, gazetarët në këtë fazë të procedurës pashmangshmërisht do t'i drejtohen prokurorisë, e jo si deri më tani, gjykatës.

Rekomandim: Prokuroria publike duhet të caktojë ekspertë të përshtatshëm, të cilët do të mund t'u përgjigjen pyetjeve të gazetarëve dhe njëkohësisht të mos rrezikohen hetimet aktuale ose konfidencialiteti.

Mosdhënia e deklaratës së përshtatshme do të shkaktojë dyshime dhe spekulime të llojllojshme, ndërsa rreziku është shumë i madh nëse publiku informohet gabimisht. Ndonjëherë mjafton edhe të jepet vetëm një deklaratë se ekziston hetim për disa persona të caktuar që të parandalohen spekulimet e punës së institucioneve.

Prokuroritë publike mund t'i drejtohen publikut edhe kur nuk ka ndonjë rast konkret. Si shembull do të cekim praktikën e Tribunalit të Hagës, ku çdo javë mbahen takime me gazetarë, në të cilat gazetarët mund të marrin përgjigje që mund të jenë interesante për publikun. Në këtë mënyrë mund të shpalosen edhe probleme që kanë të bëjnë edhe me kapacitetet e kuadrove të prokurorisë ose kapacitetet teknike. Duke informuar shpesh, parandalohen spekulimet për punën, ndërsa prokuroria publike e ofron punën e vet më afër qytetarit të zakonshëm.

Rekomandim: Personat përgjegjës për këto çështje në prokurorinë publike duhet të pajtohen të japin intervista ose të marrin pjesë në emisione informative televizive, mirëpo paraprakisht duhet të jenë mirë të përgatitur. Më mirë do të ishte që parakohe t'i kërkojnë pyetjet të cilat duhet përgjigjur. Prokurorët publik do të gjendeshin në pozitë të palakmueshme nëse i shmangin mediat, kështu që gazetarët do t'i prisnin derisa ata dalin nga ndonjë takim, nga gjykata, madje edhe nga shtëpitë e tyre.

Prokurorët publik duhet të sillen në mënyrë mjaft profesionale me gazetarët. Miqësia ndërmjet gazetarit dhe prokurorit publik mund të ekzistojë vetëm kur kamera ose diktafoni janë të fikur. Gazetarët shpeshherë i shfrytëzojnë lidhjet miqësore që i kanë me prokurorët publik dhe shpeshherë i theksojnë në raportet gazetareske ose artikujt e tyre. Përveç kësaj, gazetarët kanë edhe njerëz të tyre (insajder) brenda prokurorisë të cilët iu sigurojnë informacione. Ato informacione nganjëherë mund të jenë të dobishme për gazetarin, por ai/ajo gjithnjë duhet të verifikojë vërtetësinë e informacioneve sepse motivet e këtyre personave për dhënien e ndonjë informacione janë të llojllojshme dhe shpeshherë mund të jenë edhe keqdashëse.

Kryeprokurorët publik duhet të parandalojnë dhënien e informacioneve, të cilat janë në interes të punës së atij institucioni ose kur bëhet fjalë për dokumente sekrete. Kur

gazetari do të pranojë ndonjë dokument duke i shfrytëzuar „lidhjet“ e veta tek prokuroria publike, atëherë nuk duhet fajësuar gazetari por duhet të merren në pyetje njerëzit që punojnë në atë institucion. Prap se prap, publikimi i informacionit të pranuar në atë mënyrë duhet mirë të shqyrtohet dhe gazetari duhet të vendos nëse do e publikojë ose jo. Njihet që informacionet e pranuar në mënyrë ligjore nuk mund të kontestohen në gjyq, nëse ndodh që të ketë procedurë gjyqësore, mirëpo gjendja me dokumentet e pranuar në mënyrë joligjore është ndryshe.

Është shumë e rëndësishme për raportimin objektiv që të pranohet padia (dokumentet) kur të jetë vërtetuar nga gjykata kompetente në fazën e vlerësimit të aktakuzës, si një fazë e detyrueshme sipas Ligjit të ri për procedurë penale. Padinë duhet të ketë në dispozicion gazetari që të kuptojë për çfarë akuzohet i akuzuari dhe të fitojë një pasqyrë të plotë për raste të caktuara. Asnjë raportim objektiv nuk mund të shkruhet pa mos e pasur aktakuzën ose propozim akuzën. Aktakuza e anonimizuar, kur janë hijësuar të dhënat personale, emrat e dëshmitarëve e të tjera, edhe më tutje vlen si e tillë sepse mund të shërbejë që të kuptohet se çfarë ka bërë një i akuzuar i caktuar, përkatësisht me çfarë e ngarkon prokuroria.

Rekomandim: Pas verifikimit të aktakuzës, i njëjti duhet të jetë në dispozicion të gazetarëve me kërkesën e tyre.

Prokuroria publike duhet rregullisht të azhurnojë faqen e vet të internetit, përkatësisht të fus të dhëna për punën e vet, e jo siç ndodh shpeshherë në praktikë, kjo gjë të bëhet në gjashtë muaj, një vjet ose më shumë vite.

Përveç gazetarëve, për punën e prokurorisë publike interesohen edhe punonjësit shkencor, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, madje edhe qytetarët e zakonshëm. Prokuroria publike duhet edhe me këto grupe njerëzish të veprojë duke i respektuar parimet e sipërpërmendura.

➤ *Shkathtësitë dhe metodologjia e komunikimit të prokurorisë dhe mediave*

Kjo çështje duhet të shqyrtohet nëpërmjet:

- Komunikimit intern,
- Komunikimit ekstern,
- Bashkëpunimit të përditshëm me mediat,
- Shpejtësisë së shpërndarjes së informacioneve,

- Qasshmërisë së materialeve në internet,
- Raporteve me organe dhe institucione tjera gjyqësore të lëmisë së njëjtë,
- Vështirësive dhe problemeve, dhe
- Udhëzimeve për bashkëpunim në të ardhmen

Organet për ndjekje penale dhe institucionet gjyqësore, çdo ditë, përcjellin informacione ose lajme tek mediat për progresin e lëndëve. Prandaj, nevojitet që të ekzistojë një komunikim i mirë brenda institucionit, si edhe procedura të përcaktuara për komunikimin me mediat. Mospasja e një komunikimi të rregulluar të brendshëm dhe të jashtëm mund të ndikojë negativisht në bashkëpunimin me mediat si dhe të krijojë përshtypje dhe pasqyrë negative për atë institucion tek publiku. Prandaj, këto institucione duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme procesit të komunikimit me qytetarët, përfaqësuesve të mediave si dhe institucioneve të tjera.

➤ *Çfarë duhet bërë në prokurorinë publike në të ardhmen?*

- ❖ Të themelohet funksioni nëpunës për marrëdhënie me publikun, një përkthyes, një person për përpunimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit dhe pjesëtarë të tjerë shoqërues, të cilët do të kryenin ndonjë detyrë sipas nevojave.
- ❖ Komunikimi me internet
 - Komunikimi brenda institucionit paraqet parakusht për zhvillimin e komunikimit të mirë me jashtë.
 - Kanalet e komunikimit brenda institucionit duhet të jenë të definuar, të harmonizuar dhe të jenë efikas.
 - Shprehja „lënda nuk duhet të pësojë“ është e rëndësishme, prandaj duhet të parashihen të gjitha situatat të cilat mund të shfaqen në realitet, të cilat do të mund të shpënin në komunikim të vështirësuar dhe për të njëjtat duhet të parashihen zgjidhje.
 - Në kuadër të komunikimit të brendshëm (intern), nevojitet që të përfshihen: Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënie me publikun,

- Prokurori publik, i cili merret me ndonjë lëndë të caktuar ose bashkëpunëtori i tij, dhe
- Udhëheqësi i drejtorisë në kuadër të prokurorisë publike për të cilën bën fjalë çështja.

Duhet të kihet kujdes që në këtë proces të mos përfshihen më shumë persona sq që kërkon nevoja sepse kjo gjë mund vetëm të ndërlikojë procesin dhe të ngadalësojë mënyrën e komunikimit. Ndoshta më mirë do të ishte, në praktikë, që personat përgjegjës për marrëdhënie me publikun të përpilojnë një tekst për kumtesat, informacionet ose përgjigjet për pyetjet e gazetarëve, e pastaj nëpunësit e tjerë të japin sugjerime eventuale dhe pëlqim për tekstin final. Në kuadër të arritjes së marrëveshjes për procedurën interne, rekomandohet që të parashihet edhe një person si zëvendësues në rast se personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun nuk është në dispozicion ose është në mungesë. Numrit më të madh të pyetjeve të gazetarëve, mediave ose qytetarëve mund t'u përgjigjet brenda 48 orëve, nëse pyetja nuk kërkon të dhëna statistikore me vëllim më të gjerë. Edhe përkundër faktit se afati ligjor për përcjelljen e informacioneve është shumë më i gjatë, nuk duhet të prolongohet dhënia e përgjigjes nëse nuk ka arsye për atë.

Duke pasur parasysh këtë, komunikimi intern në prokurorinë publike:

- nuk ka të bëjë vetëm me pyetjet e gazetarëve dhe qytetarëve,
- personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun duhet të përpilojë analiza të përditshme për mediat e shtypura dhe të dorëzojë shqyrtimin e shtypit ditor dhe javor të të punësuarve të këtyre mediave.
- me kërkesë të nëpunësve të tjerë, personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun grumbullon dhe dorëzon kopje të artikujve dhe programeve televizive për të cilat janë të interesuar prokurorët publik ose të punësuarit në prokurorinë publike.

❖ Komunikimi me jashtë (ekstern)

Gjatë përcjelljes së informacioneve të mediave ose dhënies së deklaratave për ndonjë shtëpi televizive ose radio stacion duhet të kihet kujdes që informacionet të jenë mirë të formuluar dhe të dobishme. Në programet televizive kohëzgjatja për një deklaratë është 30 sekonda. Situata është e ngjashme edhe me lajmet në radio. Informacione më të gjera mund të jepen në emisione të specializuara në atë temë. Do të ishte mirë që informacionet për punën e prokurorisë publike të dërgohen në adresat elektronike të më shumë mediave.

Është me rëndësi që të kihet parasysh edhe mbulimi rajonal, si edhe interesimi i mediave të huaja për tema ose informacione të caktuara.

❖ Faqja e internetit dhe adresa elektronike

Nevojitet që institucionet të kenë *web editorial*, ku do të përfshihen të punësuarit që kujdesen për krijimin dhe vendosjen e përmbajtjeve në faqen e internetit të institucionit përkatës. Në punën e web editorialit duhet të përfshihen personat e autorizuar për marrëdhënie me publikun, personat e sektorit IT (teknologji informatike), si edhe bashkëpunëtorët juridik ose personat e tjerë fushëveprimi i të cilëve ka të bëjë edhe me prezantimin e përmbajtjeve të faqes së internetit.

Komunikimi nëpërmjet faqes së internetit – Faqja e internetit të institucionit përkatës nevojitet të azhurnohet në baza ditore. Ajo duhet të përmbajë dhëna për prokurorinë publike, si edhe të dhëna për drejtoritë, lëndët, etj. Në faqen e internetit, përveç të dhënave themelore dhe informacioneve rreth institucionit, duhet të publikohen edhe:

- Informacione për aktakuzat e dorëzuara,
- Informacione për privim nga liria, seancat, si edhe propozimet për paraburgim,
- Informacione për ankesat e parashtruara dhe hapat e tjera të procesit të cilat janë në interes të publikut dhe mediave (vazhdimi i paraburgimit etj.),
- Foto galeri (galeri me fotografi të ngajrjeve të caktuara, konferencave etj.),
- Material tjetër i cili do të vlerësohet si i dobishëm që të informohen qytetarët (raporte vjetore e të ngjashme).

Ekzistimi i faqës së azhurnuar të internetit e lehtëson qasjen e publikut shkencor dhe studentëve në informacione dhe dokumente të ndryshme. Gjithashtu, e lehtëson edhe qasjen në dokumente të personave që kanë nevojë për materiale nga fusha e të drejtës penale (ligje, punime shkencore të prokurorëve publik, aktakuza, aktgjykime, etj). Nëpërmjet postës elektronike dhe kontakteve në internet, prokurori publik mund të vë kontakte me shumë dëshmitarë të rëndësishëm të shpërngulur në tërë botën ose të pranojë denoncime anonime për ndonjë vepër penale.

❖ Teknikat dhe metodat e përmirësimit të plasmanit të informacioneve

- Mediave, së bashku me informacionet, është e dobishme t'u dërgohet edhe fotografi e ndonjë ngjarjeje,

- Fotografia e mirë dhe mbresëlënëse mund të rris rejtingun e lajmeve të mediave,
- Nëse ka mundësi, mirë është të ftohen kamerat televizive për të shënuar ndonjë ngjarje të caktuar,
- Informatat „e thata“, pa xhirime televizive nuk janë interesante as për gazetarët e as për opinionin më të gjerë publik.

❖ Marrëveshja dhe bashkërendimi

Marrëveshja, mirëkuptimi i ndërsjellë, respekti dhe bashkërendimi i obligimeve janë elemente kyçe për një bashkëpunim të mirë të gazetarëve dhe organeve të ndjekjes penale, kryesisht për prokurorinë publike. Planifikimi i aktiviteteve dhe komunikimi i ndërsjellë ka rëndësi thelbësore për përmirësimin e bashkëpunimit.

❖ Marrëdhëniet me institucionet partnere

Marrëdhëniet me institucionet dhe agjencitë partnere për zbatimin e ligjit janë shumë të rëndësishme për:

- Realizimin e veprimtarive të përbashkëta,
- Bashkërendimin e aktiviteteve gjatë informimit të publikut në kuadër të veprimtarive të përbashkëta,
- Informimin efikas dhe me kohë të publikut në kuadër të punës së lëndëve aktuale, dhe
- Ofrimin e cilësisë dhe bashkërendimit të informacioneve për publikun rreth segmenteve të ndryshëm.

❖ Vështirësitë dhe problemet

Vështirësitë gjatë bashkëpunimit shpeshherë mund të ndodhin për shkak të:

- Afateve të shkurtra për realizimin e procedurës, nga njëra anë dhe për shpërndarjen e informacioneve, nga ana tjetër;
- Mospasjes së informacioneve themelore për ngjarjen;

- Pushimeve ose ditëve të fundjavës.

Që të shmangen problemet e mundshme nevojitet të definohet një metodologji e punës së shpejtë dhe mënyra për trajtimin e situatave të tilla. Elementet kyçe për një bashkëpunim të mirë ndërmjet prokurorisë dhe mediave janë:

- Njohja e natyrës së punës si një ndër elementet më të rëndësishme për një komunikim të mirë,
- Përfaqësuesit e institucioneve patjetër duhet të kenë parasysh se media shpeshherë punojnë në baza ditore, e jo si administrata klasike,
- Përfaqësuesit e mediave patjetër duhet të kenë parasysh se prokuroria publike nuk është agjenci e lajmeve, se ajo ka rregullat e veta të komunikimit si edhe hierarkinë e punës dhe vendim-marrjes.

❖ Udhëzime për bashkëpunim në të ardhmen

Për përmirësimin e bashkëpunimit të ardhshëm nevojitet:

- Përdorimi i teknologjive të reja (interneti mobil, kamera, etj.),
- Vendosja e përmbajtjeve më të pasura me informacione (foto, videoklipe),
- Bashkërendim të bashkëpunimit të përditshëm nëpërmjet mjeteve moderne të komunikimit.

➤ *Çfarë informacione lejohen dhe duhet t'u përcillen mediave?*

- Informacione për aktakuzat e dorëzuara,
- Informacione për privimet nga liria dhe bastisjet e realizuara me urdhër të gjykatës,
- Informacione për ankesat e parashtruara lidhur me aktgjykimet e shkallës së parë,
- Informacione për pjesëmarrjen e prokurorit publik dhe personave të tjerë në lëndë të rëndësishme juridike (ekshumim, këqyrje, etj),
- Informacione për pjesëmarrjen e prokurorëve publik në takime profesionale, trajnime dhe vizita të bashkësive lokale, si dhe

- Të gjitha informacionet e tjera, të cilat i demonstrojnë publikut për punën dhe angazhimin pozitiv të institucionit.

➤ *Cfarë informacione nuk lejohen dhe nuk duhet t'u përcillen mediave?*

- Nuk duhet të zbardhen informacione rreth hetimit,
- Nëse ndonjë person fizik ose juridik është në hetim e sipër nga prokuroria publike,
- Nëse ndonjë person ka statusin e personit të dyshimtë, dhe
- Kur dhe në ç'mënyrë do të ndërmerren veprime të caktuara për zbulimin e autorëve dhe veprave penale.

Nëse me publikimin e informacioneve, të cilat nuk janë të qasshme për opinionin publik, plotësohen kushtet themelore për ndonjë vepër penale, atëherë gazetari i cili do të publikojë ato informacione mund të ndiqet penalisht. Në të gjitha rastet tjera bëhet fjalë për etikën e gazetarisë, e cila sidomos gjatë trajtimit të këtyre informacioneve (pa dallim nëse janë në dëm ose dobi të akuzuarit/dëmtuarit), duhet të jetë në nivel më të lartë profesional.

5. HAP PAS HAPI PËRMES SHQYRTIMIT KRYESOR GJYQËSOR

5.1 Kontrolli i akuzës

Kjo fazë është e domosdoshme, pa dallim nëse i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë dorëzuar ose jo parashtrësë kundër aktakuzës. Kontrollin e aktakuzës së dorëzuar për vepër penale për të cilën parashihet dënim me burgim deri në 10 vite e bën gjykatësi për vlerësim të aktakuzës, ndërsa për veprat penale për të cilat parashihet dënim mbi 10 vite kontrollin e bën Këshilli për vlerësim të aktakuzës i përbërë prej tre gjykatësve. Gjykatësi ose Këshilli për vlerësim të aktakuzës nuk mund të veprojnë si gjykatës që do të gjykojnë lëndën e njëjtë.

5.2. Publiku

➤ *Informimi i publikut*

Në çdo gjykatë, në vend të hapur dhe të dukshëm, çdo ditë shpallen të dhëna për numrin e lëndës, gjykatësin, datën, orën dhe sallën e gjykatës ku do të mbahet seanca.

Çdo gjykatë, së paku një herë në vit, e informon publikun për rezultatet e punës së gjykatës dhe gjykatësve.

Palët dhe pjesëmarrësit tjerë, në procedurën aktuale, nuk guxojnë të japin informacione dhe vlerësime për rrjedhën, zhvillimin dhe rezultatin e procedurës nëse gjykata e ka ndaluar dhënien e informacioneve të tilla.

➤ *Gjykata dhe marrëdhëniet me publikun*

Në pajtim me Rregulloren gjyqësore, gjykatat duhet patjetër të kenë të themeluar një zyrë për marrëdhënie me publikun, e cila pas kërkesës së dorëzuar nga ndonjë person i interesuar dorëzon një kopje të anonimizuar të vendimit jofuqiptotë ose një kopje të vendimit fuqiptotë të shpallur në faqen e internetit të gjykatës, në pajtim me ligjin.

Kryetari, gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësor të gjykatës i sigurojnë kushtet e nevojshme për transparencën e punës së tyre dhe qasjen e përshtatshme për mediat rreth procedurave aktuale që zhvillohen në gjykatë, duke pasur parasysh interesat e procedurës, privatësinë dhe sigurinë e pjesëmarrësve në proces. Koha, vendi dhe lënda shpallen çdo ditë në vend të dukshëm para sallës ku do të mbahet seanca dhe në video buletin elektronik. Seancat që kanë më shumë interesim për publikun, udhëheqësia e gjykatës siguron sallë për pranimin e numrit më të madh të personave, ndërsa këshilli gjyqësor, me urdhër të kryetarit të gjykatës, e mban seancën në sallën e siguar.

Me qëllim të informimit transparent dhe objektiv të publikut për punën e gjykatës nëpërmjet mjeteve të informimit publik, kryetari i gjykatës ose personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun, i caktuar nga kryetari i gjykatës, jep informacione për punën e gjykatës, përkatësisht për mbarëvajtjen e procesit sipas lëndëve konkrete. Kryetari i gjykatës dhe personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun e informojnë publikun, duke pasur kujdes që të mos cenohet nami, nderi dhe dinjiteti i personit, përkatësisht pavarësia dhe autonomia e gjykatës.

Me kërkesë të kryetarit të gjykatës ose personit përgjegjës për marrëdhënie me publikun, nëpunësit e autorizuar gjyqësor, kryetari i këshillit, gjykatësi individ ose këshilli që e trajton një lëndë, i dorëzojnë me kohë të dhënat e kërkuara. Të dhënat e siguruara patjetër duhet të jenë të sakta. Nuk kumtohen informacionet e besueshme sipas gradës së klasifikimit në pajtim me ligjin.

Gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësor, të cilët me shkrësë ose gojarisht e shprehin mendimin e tyre para mediave për çështje juridike, shoqërore ose çështje të tjera rreth lëndëve të caktuara janë të obliguar të theksojnë se e shprehin mendimin e tyre personal.

➤ *Publiku në seancën kryesore gjyqësore*

Sipas rregullit, seanca kryesore është publike dhe në të mund të merr pjesë çdo person i rritur. Prania e këtillë nuk kushtëzohet me vërtetimin se ekziston ndonjë lidhje farefisnore me të akuzuarin, dëmtuarin ose pjesëmarrësit tjerë në procesin penal, ekzistimin e interesit personal ose profesional për vijimin e procesit gjyqësor. Gazetarët që raportojnë dhe qytetarët mund të marrin pjesë në seancat publike pa mos pasur leje paraprake prej gjykatës. Gjykata siguron kushte për praninë e publikut dhe punën e vet.

➤ *Mospërfshirja e publikut*

Qysh nga fillimi i seancës e deri në përfundimin e saj, Këshilli (trupi gjykues) mund në çdo kohë

- sipas detyrës zyrtare
- me kërkesë të palëve ose të dëmtuarit

të përjashtojë publikun nga një pjesë e seancës kryesore ose tërë seanca, nëse kjo nevojitet për ruajtjen e ndonjë sekreti shtetëror, ushtarak, zyrtar ose afarist, për ruajtjen e rendit publik, mbrojtjen e jetës private të akuzuarit, dëshmitarit ose të dëmtuarit, mbrojtjen e sigurisë së dëshmitarit ose viktimës dhe/ose mbrojtjen e interesave të të miturit. Për shkak të natyrës dhe peshës së veprës penale, rrethanat ku ka ndodhur ajo vepër, si edhe për shkak të ekzistimit të rrethanave të tjera specifike (mosha, statusi i posaçëm i dëshmitarit, mënyrës së sigurimit të provave, etj.), mund të ndodh që publiku të përjashtohet nga seanca kryesore, mirëpo prap se prap vendimin për atë mund ta merr vetëm trupi gjykues me aktvendim, i cila duhet të arsyetohet dhe shpallet publikisht – në fazën e hershme të seancës.

Praktikisht, kjo nënkupton se LPP nuk ofron mundësi që publiku gjatë seancës kryesore të përjashtohet *a priori* nëpërmjet kumtesës së lëshuar në publik ose me nxjerrjen e lajmërimit me përmbajtje të tillë në faqen e internetit të gjykatës, para se të vijë dita e gjykimit, përkatësisht fillimit të seancës në ditën kur është caktuar seanca kryesore gjyqësore.

➤ *Kush nuk mund të përjashtohet nga seanca*

Nga seanca nuk mund të përjashtohen palët, i dëmtuari, përfaqësuesit dhe të autorizuarit e tyre, mbrojtësi ligjor, përveç në raste të përcaktuara me ligj.

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetare gjatë tërë procedurës penale

➤ *Vendimi për përjashtimin e publikut*

Vendimin për përjashtimin e publikut e merr këshilli gjyqësor me aktvendim, i cili duhet të arsyetohet dhe shpallet publikisht.

➤ *Sanksionet kundët vendimit për përjashtim joligjor të publikut*

Përjashtimi i publikut në kundërshtim me Ligjin paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, të cilën gjë e vëren me kujdes gjykata më e lartë nëse është cekur në ankesë.

➤ *Ruajtja e rendit në sallën e gjyqimit*

Të gjithë të pranishmit janë të obliguar të respektojnë rendin në gjykatore dhe t'u përmbahen udhëzimeve të kryetarit të gjykatës, i cili i jep ato në funksion të ruajtjes së rendit. Trupi gjykues mund të urdhërojë të largohen nga seanca personat që e vijnë seancën kryesore, nëse ata edhe pas vërejtjes së tërhequr e prishin rendin e mbajtjes së seancës. Largimi i këtyre personave nga gjykatëria paraqet masë për sanksionim për shkak të mospërfilljes së rendit në gjykatore. Kjo masë iu drejtohet personave konkret, të cilët nuk iu përmbahen udhëzimeve të gjykatësit dhe ky vendim assesi nuk nënkupton përjashtimin e publikut nga seanca kryesore.

Në funksion të mbarëvajtjes së papenguar të seancës kryesore, kryetari i këshillit, me qëllim të ruajtjes së rendit, mund të

- Kufizojë numrin e personave të cilët janë të pranishëm si dëgjues të seancës për shkak të mundësive që i ofron salla dhe për shkak të vlerësimit për implikime të mundshme ndaj sigurisë. Kjo ndodh kështu me qëllim të krijimit të kushteve për mbarëvajtjen e seancës dhe të parandalohet kontakti dhe komunikimi verbal ndërmjet publikut dhe pjesëmarrësve në procedurën penale.

➤ *Xhirimet filmike dhe televizive gjatë seancës kryesore*

Me leje të kryetarit të Gjykatës Supreme, e cila duhet të sigurohet së paku 5 ditë para mbajtjes së seancës kryesore, mund të bëhen xhirime filmike dhe televizive në gjykatore. Mirëpo, edhe përkundër lejes së këtillë, trupi gjykues mund të vendos që disa pjesë të caktuara të seancës kryesore të mos xhirohen. Trupi gjykues ka të drejtë diskrecionare të ndalojë xhirimin e anëtarëve të trupit gjykues, kurse edhe të pjesëmarrësve në procedurë me kërkesën e tyre. Nga aspekti praktik, kryesisht nga aspekti teknik, mënyra se si bëhet

fotografimi, xhirimi gjatë procedurës penale, riprodhimi i xhirit dhe raportimi, është e shpjeguar më gjatë në Rregulloren gjyqësore.

Kështu, është theksuar se xhirimi i zërit (audio) dhe vizuel (video), raportimi dhe fotografimi gjatë procedurës penale dhe publikimi (riprodhimi) i xhirit bëhet me leje paraprake të kryetarit të Gjykatës Supreme, por së pari merret mendim nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësit, ashtu siç është parashikuar me ligj.

➤ *Xhirimi dhe fotografimi në ndërtesën e gjykatës*

Jashtë seancës gjyqësore, xhirimi dhe fotografimi brenda gjykatës mund të bëhet vetëm me leje të kryetarit të gjykatës, i cili e menaxhon ndërtesën.

➤ *Leje për xhirim dhe fotografim gjatë procedurës penale*

Kryetari i Gjykatës Supreme në bazë të kërkesës në formë të shkruar jep leje për xhirim ose fotografim të ndonjë lënde të caktuar penale.

1. Brenda çfarë afati kohor duhet të dorëzohet kërkesa?

Kërkesa patjetër duhet të dorëzohet në afat prej pesë ditëve para ditës së mbajtjes së seancës.

2. Çfarë ndodh nëse e keni lëshuar afatin 5 ditor?

Kërkesa e paraqitur në kohë të duhur nuk do të refuzohet nëse shkaqet e vonës janë të arsyeshme.

3. Përmbajtja e kërkesës

Kërkesa përmban:

- theksimin e numrit të lëndës për të cilën kërkohet leje;
- emri i mjetit të informimit (shtëpia mediale);
- emrat dhe përbërja e ekipeve të raportimit (xhiruesi, forografi, asistenti, etj.);
- përshkrimi i pajisjeve teknike që do futen në gjykatore dhe mënyra e planifikuar e mbikëqyrjes (video, audio, foto, etj.);
- theksimin e kohës kur do të bëhet xhirimi i lëndës së caktuar ose të pjesëmarrësit në procedurë jashtë gjykimit në godinën e gjykatës.

➤ *Kriteret*

Kur merret vendimi për dhënien e lejes për xhirim dhe fotografim duhet të kihet kujdes për interesin dhe besimin e publikut, natyrën e lëndës, interesin e procedurës, privatësinë dhe sigurinë e pjesëmarrësve në proces. Xhirimi dhe fotografimi zhvillohen nën mbikëqyrjen e gjykatësit, përkatësisht kryetarit të këshillit, duke siguruar mbarëvajtje të papenguar të procesit, duke mbajtur rend në gjykatore dhe duke respektuar dinjitetin e gjykatës.

➤ *Ndërprerja ose kufizimi i xhirit dhe fotografimit*

Rregullorja gjyqësore parasheh se xhirimi dhe fotografimi brenda gjykatores mund të ndërpritet ose kufizohet:

- me kërkesë të palëve dhe me vendim të gjykatës, në çdo kohë;
- nëse me vendim të gjykatësit është përjashtuar publiku për një pjesë të procedurës ose për ndonjë veprim të caktuar të procesit për shkak të ekzistimit të aryeve ligjore;
- nëse dëshmitari – i dëmtuari i lëndës penale e kërkon atë përderisa zgjat dëshmia e tij/saj;
- nëse gjykata konstaton se ndonjë pjesëmarrës në proces mund t'i ekspozohet rrezikut, turpit, shkakimit të dëmit ose mund të ndodhin pengesa në zbatimin e masave ligjore siç është *shtrëngimi* ose nëse kjo është e domosdoshme për shkak të natyrës së provave që duhet të paraqiten (dëgjimi i dëshmitarëve të mbrojtur, të mitur, etj.).

➤ *Kushtet hapësinore dhe teknike për xhirim dhe fotografim*

Leja për mbikëqyrjen mediale të gjykimit nënkupton edhe sigurimin e gjykatores së përshtatshme. Në pajtim me Rregulloren gjyqësore, në gjykatore veçohet një pjesë e caktuar për ekipet mediale dhe mbikëqyrësit, me rrethojë ose i rezervuar enkas për ta, nëse është e mundur edhe me hyrje të veçantë. Që të sigurohet akomodimi në pjesën rezerve të gjykatores, gazetarët dhe mbikëqyrësit e njoftojnë gjykatën për praninë e tyre. Nëpunësi gjyqësor, përkatësisht pjesëtari i policisë gjyqësore kujdeset që personat që kanë leje t'i zënë vendet e tyre të rezervuara, si edhe gazetarët dhe mbikëqyrësit, për praninë e të cilëve nuk është e nevojshme leja e veçantë.

Me kërkesë të gjykatësit, nëpunësit të gjykatës ose pjesëtarit të policisë gjyqësore, gazetari e tregon kartën gazetare të identitetit dhe e tregon emrin e shtëpisë mediale për të cilën do të raportojë. Nuk lejohet dhënia e përparësisë së një shtëpie mediale gjatë dhënies së lejeve ose gjatë akomodimit të tyre në pjesën e rezervuar në gjykatore.

Shtëpia mediale që ka kërkuar leje për të ndjekur seancën, mund të fus në gjykatore një video ose TV kamerë, një audio sistem dhe dy fotoaparate (më së shumti me dy objektivë) dhe secilin aparat të theksuar e përdor nga një person.

➤ *Rrjedha e papenguar e procesit gjyqësor*

Në bazë të Rregullores gjyqësore, xhiruesit dhe fotografistët nuk guxojnë të lëvizin vërdallë gjatë xhiritimit ose të marrin pozita që do të tërhiqte vëmendjen ose të prishin rendin në gjykatore. Mikrofonat dhe pajisjet tjera shoqëruese montohen paraparakisht në vendin që e cakton gjykatësi. Mikrofonët duhet të kenë ndërprerës për çkyqje të përkohshme. Pajisjet e xhiritimit dhe pajisjet tjera (celularët, kompjuterët) nuk guxon të nxjerrin zëra që do të tërhiqnin vëmendjen. Pajisjet nuk mund të futen ose nxirren jashtë gjykatores pa lejen e gjykatësit ose kryetarit të këshillit.

Në bazë të Rregullores gjyqësore, gjykata mund të përcaktojë mënyrën e punës dhe raportimit në një sistem të mbyllur me ndihmën e një televizori intern me qëllim që të mundësohet qasje e lirë dhe marrja e shënimeve video dhe audio (fotografi, toni, zëri). Nëse gjykata duhet të shtyp materiale dhe kjo krijon shpenzime shtesë për gjykatën, atëherë ato shpenzime i mbulon kërkuesi i lejes.

➤ *Fotografimi, xhirimi në gjykatë dhe shfaqja publike*

Fotografimi, xhirimi dhe shfaqja publike mund të realizohet në bazë të lejes së pranuar paraparakisht nga kryetari i gjykatës. Fotografimin dhe video xhirimin në godinën e gjykatës jashtë procesit gjyqësor e aprovon kryetari i gjykatës, i cili është përgjegjës për godinën në të cilën gjendet hapësirat gjyqësore. Fotografimin gjatë seancës gjyqësore dhe shfaqjen publike të fotografive e aprovon kryetari i këshillit ose gjykatësi.

Kur jepet leja për të fotografuar ose xhiruar duhet të konsiderohen edhe interesat e publikut, interesat e procedurës, privatësia dhe siguria e pjesëmarrësve në procedurë.

Fotografimi dhe xhirimi në gjykatore, pas marrjes së lejes, zhvillohet nën udhëheqjen e kryetarit të këshillit dhe gjykatësve ashtu që siguron vijim të papenguar të seancës gjyqësore dhe siguron rend në gjykatore.

5.3. Seanca kryesore gjyqësore

➤ *Hapja e seancës*

Kryetari i këshillit e hap seancën dhe e shpall lëndën e seancës kryesore dhe përbërjen e këshillit të gjykatësve. Pastaj, konstaton nëse janë të pranishëm të gjithë personat e thirrur, e nëse nuk janë të pranishëm, atëherë sheh nëse iu janë dorëzuar thirrjet dhe nëse e kanë arsyetuar mungesën e tyre.

➤ *Fillimi i seancës kryesore*

Pasiqë Kryetari i këshillit konstaton se janë përmbushur të gjithë kushtet ligjore për mbajtjen e seancës gjyqësore, përkatësisht se nuk ekzistojnë pengesa procedurale për mbajtjen e seancës, fillon me fjalimet hyrëse të palëve, që nënkupton se është braktisur më koncepti që seanca kryesore të fillojë me leximin e aktakuzës.

➤ *Fjalët hyrëse*

Seanca kryesore fillon me mbajtjen e fjalimeve hyrëse. Së pari flet paditësi, e pastaj mbrojtësi dhe i akuzuari. I akuzuari ka të drejtë të mos mbajë fjalim hyrës.

Gjatë fjalimeve hyrëse, palët mund të paraqesin faktet vendimtare të cilat kanë ndër mend t'i provojnë, t'i paraqesin provat dhe t'i përcaktojnë çështjet juridike që duhet trajtuar. Gjatë fjalimeve nuk guxon të paraqiten fakte për dënimet e mëparshme të akuzuarit. Në fakt, nëpërmjet fjalimeve hyrëse, të dy palët i njoftojnë të pranishmit në gjykatore me teorinë e lëndës së tyre dhe e shpalosin materialin e provave që do të prezantohet në kuadër të procedurës së provave.

➤ *Deklarimi i fajësisë së të akuzuarit*

Pas fjalëve hyrëse dhe pasi që i akuzuari të pyetet nga gjykatësi nëse ka njohuri pse është akuzuar dhe pasi që ta njoftojë me të drejtat e tij në seancën kryesore, Kryetari i trupit gjykues e fton të akuzuarin të jep deklaratë nëse ndjehet fajtor apo jo rreth veprave penale kundër tij.

1. Nëse i akuzuari e pranon fajin gjatë seancës kryesore

Pas pranimit të fajit, kryetari i trupit gjykues është i obliguar të hulumtojë nëse pranimi i këtillë është i vullnetshëm, nëse i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike të pranimit të fajit, për pasojat lidhur me kërkesat pronësore juridike (dëmshpërblim) dhe shpenzimet rreth procedurës penale.

Pas këtyre veprimeve, gjatë procedurës së provave do të shpalosen vetëm ato prova që kanë të bëjnë me vendimin e sanksionit. Në rastin e tillë gjendja e fakteve nuk mund të shkaktojë arsye për ankesë, përkatësisht i akuzuari nuk mund të parashtrojë kërkesë për shkak të keq konstatimit të gjendjes faktike.

2. Nëse i akuzuari deklarohet se nuk është fajtor

Në qoftë se i akuzuari deklarohet se nuk ndjehet fajtor rreth asnjë pike të aktakuzës, atëherë palët fillojnë me shpalosjen dhe paraqitjen e provave të tyre në kuadër të procedurës së paraqitjes së provave. Në rast të tillë, duke pasur parasysh se mohimi i aktakuzës, në fakt është gjendje e kontestuar faktike e lëndës, palët e shpalosin tërë materialin e tyre të provave – edhe provat lidhur me veprën penale dhe fajin edhe provat që kanë ndikim për përcaktimin e llojit dhe peshës së sanksionit penal.

➤ *Seanca e paraqitjes së provave*

Provat në kuadër të seancës për paraqitjen e provave shpalosen sipas rënditjes së mëposhtme:

- prova për aktakuzën dhe prova lidhur me kërkesën pronësore juridike
- provat e palës së mbrojtjes
- provat e aktakuzës për përgënjeshttrimin e provave të palës së mbrojtjes dhe
- provat e palës së mbrojtjes si kundërpërgjigje të përgënjeshttrimit të palës së akuzës

Vërehet se gjykata gjatë procedurës penale nuk paraqet prova sipas detyrës zyrtare, që e paraqet rolin e tij të ri me modelin e ri akuzator të procedurës, kurse ai e luan rolin e një arbitri të pavarur dhe të paanshëm në procedurën penale në të cilën rolin kryesor e luajnë palët që kanë për detyrë të dëshmojnë lëndët e tyre. Përfundim është i ashtuq. super ekspertiza, përkatësisht kur ekzistojnë dy mendime të kundërta dhe të papajtueshme, gjykata mund të kërkojë super ekspertizë të tretë.

Më saktësisht, për shkak të shmangies së kundërthënive gjatë mendimeve të rezultateve të ekspertëve, gjykata me kërkesë të palëve ose sipas detyrës zyrtare mund të caktojë super ekspertizë, e cila caktohet në mënyrë elektronike duke zbatuar metodën e zgjedhjes së rastësishme nga regjistri i ekspertëve, në praninë e të dy palëve, përkatësisht të paditësit të autorizuar dhe mbrojtësit.

➤ *Mënyra e marrjes në pyetje*

Rrjedhimisht, sipas renditjes së paraqitjes së provave dhe autorizimeve që i kanë sipas dispozitave të LPP, gjykata nuk nxjerr të ashtuq. prova verbale, përkatësisht nuk i merr në pyetje dëshmitarët, ekspertët dhe këshilltarët teknik. Kjo d.m.th. se palët vetë i marrin në pyetje dëshmitarët, ekspertët dhe këshilltarët teknik, të cilët i propozojnë si prova gjatë procedurës penale. Në këtë kontekst, kur bëhet fjalë për këto prova, LPP parasheh se:

Gjatë shpalesjes së provave (në mënyrë verbale) lejohet të bëhet ekzaminimi direkt, kundërekzaminimi dhe ekzaminimi plotësues. Ekzaminimi direkt e bën pala e cila e ka propozuar dëshmitarin, përkatësisht ekspertin ose këshilltarin teknik. Në kuadër të ekzaminimit direkt, sipas rregullit, nuk lejohen pyetje që sugjerojnë përgjigje. Kundërekzaminimin e bën pala e kundërt. Kjo është e drejtë, por jo edhe obligim, pasi që dëshmitari, eksperti ose këshilltari teknik paraqitet si dëshmi nëpërmjet ekzaminimit direkt, ndërsa kundërekzaminimi është vegël e lejueshme për kontestimin dhe diskreditimin e deklaratës së dhënë. Pala që e ka propozuar dëshmitarin, ekspertin ose këshilltarin teknik kryen edhe ekzaminim plotësues, i cili pason pas kundërekzaminimit.

➤ *Roli i gjykatës gjatë ekzaminimit të dëshmitarëve*

Pas përfundimit të ekzaminimit, kryetari dhe anëtarët e këshillit mund t'u parashtrojnë pyetje personave të ekzaminuar (dëshmitarit, ekspertit dhe këshilltarit teknik). Ky autorizim ligjor i gjykatës, në pajtim me rolin e tij të ri në këtë proces, duhet të kuptohet ashtu që pyetjet e parashtruara janë në funksion të sqarimeve plotësuese, qartësimeve plotësuese lidhur me përgjigjet e dhëna, si edhe parashtrojnë pyetje lidhur me ato tema relevante.

➤ *Protestimi ndaj pyetjes së parashtruar ose përgjigjes së dhënë*

Gjykatësi vendos për protestimin e shprehur ndaj ndonjë pyetjeje ose përgjigjeje të dhënë në pajtim me dispozitat ligjore dhe rregullat e paraqitjes së provave. Prokurori publik, paditësi privat dhe mbrojtësi i të akuzuarit vërejtjet ose mospajtimet rreth ekzaminimit duhet t'i shfaqin nëpërmjet protestimeve të përshtatshme.

Në mënyrë ilustruese, kjo nënkupton se e humbasin mundësinë për të prehur gjatë procesit të ekzaminimit duke mos parashtruar asnjë pyetje sa për konfirmim, sqarim, shpjegim plotësues, koment shtesë të dëshmisë së dhënë, e në fund të shprehin mospajtimin e tyre në mënyrë të gjerë e gjatë rreth dëshmisë së dhënë të personit të ekzaminuar, shpeshherë në stilin si vijon „...protestoj në tërësi për dëshminë e këtij dëshmitari sepse kjo dëshmi është e pavërtetë, e anshme, e dhënë me qëllim që t'i ndihmojë...“.

Vetëm i akuzuari e ka të drejtën ekskluzive të jep vërejtje rreth dëshmive të personave të ekzaminuar.

➤ *Ekzaminimi i dëshmitarit armiqësor*

Kryetari i këshillit, me propozim të palës që e ka propozuar dëshmitarin do të lejojë kundërekzaminim, në qoftë se për shkak të dëshmisë që e ka dhënë dëshmitari gjatë seancës kryesore nuk mund më të konsiderohet si dëshmitar i palës që e ka propozuar fillimisht.

➤ *Ekzaminimi i të akuzuarit vetëm me propozim të palës së mbrojtjes*

Ekzaminimi i të akuzuarit si fazë e domosdoshme, e cila i paraprinte procedurës së paraqitjes së provave, e si pasojë e kësaj edhe largimi i domosdoshëm i bashkë të akuzuarve nga gjykatorja, pa dallim, që e paraqet modelin inkuizitor të procedurës penale, i takon më të kaluarës.

Në bazë të Ligjit të ri për procedurë penale, ekzaminimi i të akuzuarit bëhet vetëm me propozim të palës së mbrojtjes. Pastaj, nëse ka të akuzuar të tjerë, ata mbeten në gjykatore me mundësi për të parashtruar pyetje.

➤ *Procedura shtesë e procedurës së paraqitjes së provave*

Pas mbarimit të procedurës së paraqitjes së provave, palët dhe i dëmtuari mund të ofrojnë propozime për shtesë të procedurës së paraqitjes së provave për shkak të rrethanave të reja që kanë lindur gjatë seancës kryesore.

Nëse nuk ka propozime për procedurë shtesë të paraqitjes së provave ose nëse propozimi refuzohet, atëherë kryetari i këshillit do të shpall të përfunduar procedurën e paraqitjes së provave.

➤ *Fjalimi përmbyllës*

Pas përfundimit të procedurës së paraqitjes së provave, gjykatësi do t'i ftojë paditësin, të dëmtuarin, mbrojtësin dhe të akuzuarin që të japin fjalimin e tyre përmbyllës.

➤ *Mbarimi i seancës kryesore*

Pas fjalimeve përmbyllëse, kryetari i këshillit shpall që seanca kryesore është e përfunduar, ndërsa pastaj këshilli i gjykimit tërhiqet për t'u konsultuar dhe për të votuar rreth aktgjykimimit.

➤ *Shqiptimi i aktgjykimit*

Nëse trupi gjykues gjatë konsultimeve nuk konstaton se duhet të hapet sërish seanca kryesore për shkak të rrethanave shtesë të procedurës ose për sqarimin e çështjeve të veçanta, atëherë ai do të merr vendim rreth aktgjykimit. Aktgjykimi shqiptohet publikisht duke filluar me “*në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë*”.

➤ *Shpallja e aktgjykimit*

Pasi që trupi gjykues do të shqiptojë aktgjykimin, kryetari i trupit gjykues menjëherë do të shpall atë. Nëse trupi gjykues nuk është në gjendje të shqiptojë aktgjykimin ditën e njëjtë pas mbarimit të seancës kryesore, atëherë do të shtyjë shpalljen e aktgjykimit më së shumti edhe tre ditë dhe do të caktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit.

Nëse publiku ka qenë i përjashtuar nga seanca kryesore, atëherë shqiptimi i aktgjykimit do të bëhet në seancë publike. Këshilli do të vendos nëse dhe sa gjatë do të përjashtojë publikun gjatë shpalljes së arsyeve të aktgjykimit. Të gjithë të pranishmit do të çohen në këmbë kur të lexohet aktgjykimit.

➤ *Përpilimi me shkrim dhe dorëzimi i aktgjykimit*

Aktgjykimi i shpallur patjetër duhet të përpilohet me shkrim 15 ditë pas shpalljes, ndërsa për lëndët e ndërlikuara, sipas nevojës deri në 60 ditë, afate kohore që s’guxon të tejkalohen.

➤ *Mohimi i të drejtës për ankesë*

I akuzuari mund të heq dorë nga e drejta për parashtrimin e ankesës, vetëm pasi që i është dorëzuar aktgjykimi.

PËRJASHTIM: I akuzuari mund të heq dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë deri te gjykata më e lartë pas shpalljes së aktgjykimit.

Kusht për këtë është që:

- nga e drejta për parashtrimin e ankesës të heqin dorë edhe paditësi dhe i dëmtuari kur kanë të drejtë të dorëzojnë ankesë sipas të gjitha bazave, ndërsa
- me aktgjykimin të mos i shqiptohet të akuzuarit dënim me burgim.

➤ *Heqja dorë nga ankesa e parashtruar*

I akuzuari mund të heq dorë nga ankesa e parashtruar deri në sjelljen e vendimit nga gjykata e shkallës së dytë. I akuzuari mund të heq dorë edhe nga ankesa që e ka dorëzuar mbrojtësi i tij, partneri i tij martesor, përkatësisht jomartesor, farefisi, birësuesi, i birësuari, vëllau, motra dhe kujdestari.

Duhet të qartësohet se mbrojtësi ose personat të cilët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në dobi të të akuzuarit (partneri i tij martesor, përkatësisht apo jomartesor, farefisi, birësuesi, i birësuari, vëllau, motra dhe kujdestari), nuk kanë mundësi që ta tërheqin ankesën tashmë të parashtruar në emër të akuzuarit pa pëlqimin e tij/saj. Vetëm i akuzuari ka të drejtë ligjore që ta tërheq ankesën e parashtruar nga dikush tjetër, në emër të tij, deri në sjelljen e vendimit të gjykatës së shkallës së dytë, edhe atë me deklaratë, me parashtrësë ose gojarisht gjatë seancës kryesore para gjykatës më të lartë. Koncepti i këtillë i cili rrjedh nga dispozitat ligjore është integruar edhe në praktikën gjyqësore, i cili synon të mbrojë të akuzuarin dhe të drejtën e tij të garantuar për mbrojtje dhe në këtë drejtim të parandalojë keqpërdorime të mundshme. E drejta e mohimit dhe heqjes dorë nga ankesa i takon përshtatshmërisht edhe paditësit edhe të dëmtuarit. Mohimi dhe heqja dorë nga ankesa nuk mund të revokohen.

6. PROCEDURAT E PËRSHPËJTUARA

6.1. Procedura e shkurtuar

➤ *Veprat të cilat i nënshtrohen procedurës së shkurtuar*

Të dhënat statistikore tregojnë që më shumë se 80% e të gjithë lëndëve penale që përpunohen nëpër gjykata kanë të bëjnë me vepra penale për të cilat ligji parasheh gjobë ose dënim me burgim në kohëzgjatje deri në pesë vite. Pikërisht për këtë gjë dhe me qëllim të përpunimit sa më të madh të veprave penale veçoria kryesore e të cilave është formalizimi i reduktuar dhe afatet më të shkurtra kohore të procedurave dhe ndërmarrjes së veprimeve procesore, por paraqet edhe mundësi që gjykata t'i udhëzojë palët drejt procedurës për ndërmjetësim (mediacion). Me Ligjin e ri për PP është zgjeruar spektri i veprave penale të cilat do të përfshihen në procedurë të shkurtuar tek gjykatat e shkallës së parë. Kështu, gjatë procedurës së shkurtuar do të gjykohen vepra penale që parashikojnë gjoba ose dënim me burgim deri në pesë vite.

➤ *Ngritja e procedures së shkurtuar*

Procedura e shkurtuar ngritet me propozimin e prokurorit publik ose në bazë të padisë private. Është braktisur koncepti i aktakuzës dhe propozim akuzës nga i dëmtuari në cilësi të paditësit (akuza subsidiare). Kjo pothuajse nënkupton se i dëmtuari, ashtu si në procedurën e rregullt, edhe në procedurën e shkurtuar nuk mund të paraqitet si paditës i autorizuar dhe me këtë të merr statusin e palës gjatë procedurës penale.

➤ *Caktimi i paraburgimit*

Në procedurë të shkurtuar, paraburgim mund të caktohet kundër personit për të cilin ekziston dyshim i bazuar se ka kryer vepër penale, nëse:

- 1) fshehet ose nëse nuk mund të identifikohet identiteti i tij ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë rrezik për arratisjen e tij/saj dhe
- 2) bëhet fjalë për vepër penale kundër rendit publik dhe moralit, ndërsa rrethanat e posaçme e arsyetojnë frikën se i dyshimti mund të kryejë përsëri veprën penale dhe do të kryejë veprën penale për të cilën kanoset.

➤ *Cili mund të propozojë sanksionin paraburgim*

Në procedurën e shkurtuar paraburgim mund të propozojë vetëm prokurori publik. Paditësi privat nuk ka të drejtë të propozojë paraburgim.

➤ *Kush vendos për sanksionin e paraburgimit*

Para dorëzimit të propozim akuzës, paraburgimin e përcakton gjykatësi në procedurën e mëparshme, ndërsa pas dorëzimit të propozim akuzës, gjykatësi- individ kompetent.

➤ *Kohëzgjatja e paraburgimit*

Para dorëzimit të propozim akuzës, paraburgimi nuk guxon të zgjat më shumë se tetë ditë. Këshilli penal vendos për ankesën e parashtruar kundër aktvendimit për paraburgim.

Paraburgimi, që nga dorëzimi i propozim akuzës e deri në mbarimin e seancës kryesore mund të zgjat më së shumti deri në 60 ditë. Kur i akuzuari gjendet në paraburgim, gjykata është e obliguar të veprojë me urgjencë të posaçme.

➤ *Pranimi i akuzës në gjykatë*

Kur gjykata do të pranojë propozim akuzën ose padinë private, atëherë gjykatësi paraprkishtë do të hulumtojë nëse gjykata është kompetente dhe nëse ekzistojnë kushte për refuzimin e propozim akuzës, përkatësisht të padisë private.

Nëse gjykatësi nuk sjell aktvendim për mospasje të kompetencave ose refuzim të propozim akuzës, përkatësisht të padisë private, atëherë do të caktojë seancë kryesore.

➤ *Seanca dëgjimore për pajtim*

Para caktimit të seancës kryesore për veprat penale që janë në kompetenca të gjykatësit individ, të cilat ndiqen me padi private, gjykatësi individ mund të thirr vetëm paditësin privat dhe të akuzuarin, një ditë të caktuar, që të vijnë në gjykatë me qëllim të sqarimit paraprak të çështjes nëse mendon se do të ishte e pështatshme për të përfunduar procedurën sa më shpejt. Të akuzuarit i dërgohet edhe një kopje e padisë private në shtojcë të thirrjes gjyqësore.

Në këtë seancë, gjykatësi individ mund të jep propozim që paditësi privat dhe i akuzuari të pranojnë procedurën e mediacionit (ndërmjetësim), nëse të dy palët pajtohen me këtë gjë. Nëse palët pajtohen të nisin procedurën e mediacionit, atëherë gjykatësi individ sjell vendim për referimin e tyre, ndërsa procedura vazhdon sipas dispozitave të LPP lidhur me procedurën e mediacionit.

➤ *Nëse palët nuk pranojnë të referohen në procedurë të mediacionit ose nëse nuk arrihet pajtimi*

Nëse palët nuk pajtohen të referohen në procedurë të mediacionit ose nëse nuk arrihet pajtimi dhe tërheqja e padisë private gjatë seancës për pajtim, atëherë gjykatësi do të merr deklaratat e palëve dhe do t'i ftoj që të dorëzojnë propozime të tyre në drejtim të sigurimit të provave.

➤ *Caktimi i seancës kryesore*

Nëse gjykatësi individ nuk gjen baza për të hedhur poshtë padinë, sipas rregullës, do të caktojë menjëherë seancë kryesore dhe këtë do t'u kumtoj palëve. Gjykatësi individ mund menjëherë të hap seancën kryesore dhe pas paraqitjes së provave mund të sjell vendim lidhur me padinë private. Për këtë gjë enkas do të paralajmërohen paditësi privat dhe i akuzuari gjatë dorëzimit të thirrjes gjyqësore.

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

➤ *Personat të cilët thirren në seancë kryesore*

Gjykatësi i thirr në seancë kryesore të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, paditësin dhe përfaqësuesit/të autorizuarit e tyre ligjor, dëshmitarët, ekspertët dhe përkthyesin.

➤ *Kushtet për mbajtjen e seancës kryesore*

Seanca kryesore mbahet në prani të prokurorit publik, përkatësisht të paditësit privat dhe të akuzuarit. Për lëndët penale për të cilat është parashikuar gjobë ose dënim me burgim deri në tre vite, në qoftë se i akuzuari nuk vjen në seancën kryesore, megjithëse i është dërguar thirrje mirëpo thirrja nuk është dorëzuar për shkak të shmangies së të akuzuarit që të pranojë atë, atëherë gjykata mund të vendos që seanca kryesore të mbahet pa praninë e tij. Për veprat tjera penale për të cilat mbahet procedurë e shkurtuar, prania e të akuzuarit në seancën kryesore është e domosdoshme.

➤ *Mbarëvajtja e seancës kryesore*

Për dallim nga procedura e rregullt penale në të cilën seanca kryesore fillon me fjalimet hyrëse të palëve, seanca kryesore gjatë procedurës së shkurtuar fillon me shpalljen e përmbytjes së akuzës, e pastaj vijon deklarata e të akuzuarit rreth asaj se si ndjehet lidhur me veprën penale – a ndjehet fajtor apo jo. Nëse i akuzuari deklaron se nuk ndjehet fajtor për veprën penale, atëherë gjykatësi e hap procedurën e paraqitjes së provave dhe vijon shpallja e provave të propozuara nga paditësi i autorizuar, e pastaj edhe nga pala mbrojtëse.

Nëse në seancën kryesore i akuzuari deklaron se është fajtor, ndërsa gjykatësi individ vlerëson se këtë e ka deklaruar vullnetarisht, se i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike për pranimin e fajit dhe për pasojat lidhur me kërkesat pronësore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale, atëherë në kuadër të procedurës së paraqitjes së provave do të shpallosen vetëm ato prova që kanë të bëjnë me vendimin e sanksionit.

Në praktikë, kjo nënkupton që pranimi i fajit gjatë seancës kryesore nuk d.m.th. fillimin e procedurës për arritjen e marrëveshjes lidhur me pranimin e fajit, por ofron mundësi vetëm për shkurtimin e procedurës së paraqitjes së provave.

➤ *Shqiptimi i aktgjykimit*

Pas mbylljes së seancës kryesore, gjykata menjëherë do të shqiptojë aktgjykimin dhe arsyet thelbësore. Aktgjykimi duhet përpiluar në formë të shkruar në afat prej tetë ditëve nga dita e shqiptimit. Kundër aktgjykimit mund të parashtrahet ankesë në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

➤ *Njoftimi për seancën e këshillit të gjykatës së shkallës së parë*

Kur gjykata e shkallës së dytë vendos lidhur me ndonjë ankesë kundër aktgjytimeve të shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë në procedurë të shkurtuar, të dy palët do të njoftohen për seancën e këshillit të gjykatës së shkallës së dytë vetëm nëse kryetari i këshillit ose këshilli konstatojnë se prania e palëve do të ishte e dobishme për sqarimin e çështjes. Nëse bëhet fjalë për vepër penale për të cilën procedura është zhvilluar me kërkesë të prokurorit publik, atëherë kryetari i këshillit do ia dorëzoj dokumentacionin prokurorit publik, i cili mund të dorëzojë propozim në formë të shkruar në afat prej tetë ditëve.

6.2. Sjellja e aktgjykimit në bazë të marrëveshjes së arritur ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit

➤ *Drejtësia me marrëveshje*

Marrëveshja për pranimin e fajit, si një institut tipik anglosakson, e harmonizuar me praktikën e jurisprudencës evropiane e gjeti vendin e duhur në Ligjin e ri për PP, i cili përmban dispozita të cilat për herë të parë, në legjislacionin penal të Maqedonisë, e ofron mundësinë për të lidhur marrëveshje ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit, si edhe llojin dhe peshën e sanksionit penal.

➤ *Dorëzimi i propozim marrëveshjes – deri kur?*

Deri në dorëzimin e akuzës, prokurori publik dhe i akuzuari mund të dorëzojnë propozim marrëveshje me të cilën kërkojnë nga gjykatësi i procedurës së mëparshme të përcaktojnë sanksion penal sipas llojit dhe peshës, në kuadër të ligjit për veprën konkrete penale, por jo ndër kufinj të përbuzjes së dënimit të përcaktuar në Kodin Penal.

Mundësinë e parë për arritjen e marrëveshjes me prokurorin publik për llojin dhe peshën e sanksionit penal, i akuzuari e ka në fazën e hetimeve, përkatësisht para se të dorëzohet akuzë. Iniciativa për një marrëveshje të këtillë mund të del edhe nga prokurori publik (shpeshherë në çastin kur do t'i kumtojë të dyshimit se e ka përfunduar procedurën hetimore kundër tij/saj, kur do ia prezantoj materialin e provave të siguruar gjatë hetimeve ose kur ta thirr të dyshimtin për ta marr në pyetje, e gjithë kjo para përfundimit të hetimeve), edhe nga i dyshimti nëse pas këshillimeve me mbrojtësin e tij ligjor vlerëson se marrëveshja do të ishte në interesin e tij/saj më të mirë. I dyshimti nuk është i obliguar të pranojë fajin për veprën penale për të cilën dëshiron të lidh marrëveshje për shkak të nevojës së ekzistimit të ekuilibrit në fuqinë negociuese të dy palëve në procesin e negociatave.

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetare gjatë tërë procedurës penale

Mundësinë e dytë, njëherit edhe mundësinë e fundit për lidhjen e marrëveshjes me prokurorin publik rreth llojit dhe peshës së sanksionit penal, i dyshimti e ka në fazën e kontrollës së akuzës, por në këtë rast pranimi i fajit për veprën penale paraqet kusht për fillimin e procedurës së marrëveshjes.

Marrëveshja lidhet ndërmjet prokurorit kompetent publik dhe të dyshimit në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor.

➤ *Lënda e marrëveshjes*

Lënda e marrëveshjes është lloji dhe pesha e sanksionit penal, të cilat do të propozohen në propozim marrëveshjen, mirëpo nëse i dyshimti pajtohet, lëndë e marrëveshjes mund të jetë edhe kërkesa pronësore juridike e të dëmtuarit.

Vlen të cekët se prokurori publik dhe i dyshimti nuk mund të merren vesh për kualifikimin juridik të veprës penale.

➤ *Pjesëmarrja e mbrojtësit ligjor të të dyshimit në procesin e marrëveshjes*

I dyshimti patjetër duhet të ketë mbrojtës ligjor që nga momenti i fillimit të procedurës së marrëveshjes. I dyshimti përcaktohet për mbrojtës ligjor sipas dëshirës së vet. Nëse vetë nuk gjen mbrojtës ligjor, atëherë kryetari i gjykatës kompetente i cakton mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

➤ *Mospjesëmarrja e gjykatës në procesin e marrëveshjes për pranimin e fajit*

Gjykatësi i procedurës së mëparshme nuk guxon të merr pjesë në procesin e marrëveshjes për fajin ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshimit dhe mbrojtësit të tij ligjor. Ndalea për mospjesëmarrjen e gjykatës në procesin e marrëveshjes, e cila është parashikuar në mënyrë të qartë në LPP, ka për qëllim të pamundësojë gjykatën që në çfarëdo mënyrë të ndikojë mbi palët dhe mbrojtësin ligjor rreth vendimit se a të fillojnë me procedurën e marrëveshjes, si edhe rreth llojit dhe peshës së sanksionit penal. Në këtë mënyrë, theksohet roli *dominus litis* i prokurorit publik gjatë procedurës hetimore.

Me mospjesëmarrjen në procedurën e marrëveshjes, gjykatësi e ruan paanësinë e tij si arbitër, i cili e vlerëson propozim marrëveshjen e dorëzuar në bazë të provave të siguruara nga prokuroria. Është e dobishme që gjykatësi nuk është i përfshirë në mbarëvajtjen e procedurës së marrëveshjes sepse në këtë mënyrë nuk ka njohuri për procesin e negociatave që ka paraprirë gjatë arritjes së propozim marrëveshjes, nuk ka njohuri për bisedat që janë zhvilluar ndërmjet prokurorit dhe mbrojtësit ligjor. Me këtë vihet theksi mbi rolin e gjykatës në fazën e dytë të procedurës së marrëveshjes e cila përbëhet nga vlerësimi i propozim marrëveshjes.

➤ *Trajtimi i propozim marrëveshjes*

Në afat prej tre ditëve pas pranimit të propozim marrëveshjes, gjykatësi i procedurës së mëparshme cakton seancë dëgjimore për të vlerësuar propozim marrëveshjen. Në këtë seancë thirren parashtruesit e propozim marrëveshjes dhe gjykatësi është i obliguar të zbulojë nëse ajo është parashtruar vullnetarisht, nëse i dyshimti është i vetëdijshëm për pasojat juridike nga pranimi i saj, për pasojat rreth kërkesës pronësore juridike dhe shpenzimeve të procedurës penale. Gjykatësi i procedurës së mëparshme e udhëzon prokurorin publik, të dyshimtin dhe mbrojtësin e tij ligjor se kanë të drejtë të heqin dorë nga kjo propozim marrëveshje deri në marrjen e vendimit, si edhe pranimi i propozim marrëveshjes konsiderohet si mohim i të drejtës për ankesë rreth aktgjykimit që do të shqiptohet në bazë të propozim marrëveshjes.

➤ *Refuzimi i propozim marrëveshjes*

Nëse gjykatësi i procedurës së mëparshme përcakton se provat e siguruar për faktet rreth përcaktimit dhe matjes së sanksionit penal nuk e arsyetojnë shqiptimin e sanksionit të propozuar penal, përkatësisht nëse prokurori publik, i dyshimti dhe mbrojtësi ligjor gjatë seancës dëgjimore kanë dorëzuar kërkesë për caktimin e sanksionit penal ndryshe nga sanksioni penal i propozuar me propozim marrëveshjen, atëherë ai sjell aktvendim me të cilin e refuzon propozim marrëveshjen dhe evidencën ia dorëzon prokurorit publik. Në këtë rast, procesverbali i seancës së mbajtur dhe propozim marrëveshja nuk guxon të përdoren në zhvillimin e mëtejshëm të procedurës.

➤ *Aktgjykimi në bazë të propozim marrëveshjes*

Nëse gjykatësi i procedurës së mëparshme e pranon propozim marrëveshjen, atëherë ai shqipton aktgjykim me sanksion penal i cili nuk guxon të jetë ndryshe nga sanksioni penal i sugjeruar me propozim marrëveshjen. Aktgjykimi i përmban të gjitha elementet e aktgjykimit ndëshkimor, shpallet menjëherë, ndërsa përpilohet në formë të shkruar tre ditë pas shpalljes. Pa shtyrje, aktgjykimi i dorëzohet prokurorit publik, të dyshimtit dhe mbrojtësi ligjor. Pa shtyrje, gjithashtu edhe një kopje i dorëzohet të dëmtuarit, i cili nëse nuk është i kënaqur me llojin dhe peshën kompensimit, të drejtën e vet mund të realizojë nëpërmjet procedurës kontestimore.

➤ *Marrëveshja nga pikëpamja e opinionit publik*

Pa përjashtim, procedura për arritjen e marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshimtit realizohet pa praninë e publikut. Çdo informacion me të cilën zbulohen të dhëna konkrete lidhur

me procedurën e caktuar për arritjen e marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshimit, ndërsa në rast se marrëveshja të mos ketë sukses, kontribuon në trajtimin e mëtutjeshëm – kur lënda do të procesohet në gjykatë – gjatë kontrollit të akuzës ose gjatë seancës kryesore, tek anëtarët e këshillit për vlerësimin e aktakuzës ose më vonë tek anëtarët e këshillit gjyqësor të krijojë parabindje në aspektin e ekzistimit të përgjegjësisë penale të dyshimit, për të cilin më herët është zbuluar se është pajtuar të merret vesh për llojin dhe peshën e sanksionit penal.

Kjo sidomos mund të vijë në shprehje nëse në opinion zbulohen informacione rreth procedurës për marrëveshje, e cila realizohet në fazën e kontrollit të akuzës, kur dihet që kusht për fillimin e procedurës së këtillë është që i dyshimti paraprakisht të ketë pranuar fajin për veprën e caktuar penale.

Shkurtimisht:

- *Faza e parë:* bisedat, negociatat, marrëveshja, definimi i elementeve të domosdoshëm të propozim marrëveshjes dhe nënshkrimi i saj; marrin pjesë vetëm prokurori publik dhe i dyshimti në praninë e mbrojtësit të tij ligjor. **Në këtë proces janë plotësisht të përjashtuar edhe gjykata edhe opinioni publik.**
- *Faza e dytë:* kur bëhet vlerësimi i propozim marrëveshjes, përfshihet gjykatësi i procedurës së mëparshme, por edhe atëherë, në seancën për vlerësim të propozim marrëveshjes, **opinion i publik është i përjashtuar.**

Nëse procedura e marrëveshjes mbaron me sukses, kurse kjo nënkupton se gjykata e ka pranuar propozim marrëveshjen dhe ka sjellur aktgjykim, ajo megjithëse ka karakter të vendimit të plotëfuqishëm gjyqësor, **bëhet e qasshme për opinion publik.**

6.3. Procedura e ndërmjetësimit (mediacioni)

Kjo është edhe një ndër të ashtuq. procedura të përsheptuara, e cila për vepra penale që ndiqen me padi private, mundëson që palët të kenë mundësi jashtë gjykatores dhe me ndërmjetësim të mediatorit të tentojnë t'i tejkalojnë mosmarrëveshjet dhe t'i zgjidhin çështjet kontestuese dhe në këtë mënyrë të shmangin seancën kryesore si seancë e gjatë dhe ndërlikuar, si dhe fazën më të shtrenjtë në procedurën e gjykatës së shkallës së parë.

➤ *Pëlqimi i palëve si kusht për ndërmjetësimin*

Kur vepra ndiqet me padi private, gjykatësi kompetent individ, në kuadër të seancës së mbajtur të pajtimit, mund t'u propozojë palëve që kontestin ta zgjidhin para mediatorit. Nëse palët japin pëlqim në afatin e caktuar nga gjykata, atëherë gjykatësi individ i udhëzon tek mediatori, mirëpo nëse nuk japin pëlqim, atëherë gjykatësi individ cakton seancë kryesore sipas dispozitave të procedurës së shkurtuar dhe kjo procedurë vazhdon më tej.

➤ *Caktimi i mediatorit*

Në afat prej tre ditëve nga dhënia e pëlqimit të palëve, palët në marrëveshje të ndërsjellë caktojnë një ose më shumë mediatorë nga Regjistri i mediatorëve dhe për këtë gjë e njoftojnë gjykatësin individ.

➤ *Realizimi i procedurës së ndërmjetëimit deri në arritjen e marrëveshjes*

Mediatori komunikon me palët së bashku ose veç e veç. Prania e palëve në procedurën e ndërmjetëimit është e domosdoshme. Para fillimit të procedurës së ndërmjetëimit, mediatori është i obliguar t'i njoftojë palët me parimet, rregullat dhe shpenzimet e procedurës.

➤ *Ndërmjetësimi i suksesshëm – përfundimi i procedurës*

Procedura e ndërmjetëimit mund të përfundojë me sukses me firmosjen e marrëveshjes. Në këtë rast, marrëveshja e firmosur, pa vonesë, i dorëzohet gjykatës kompetente. Kur palët do t'i plotësojnë kushtet e dakorduar të marrëveshjes së firmosur dhe për këtë gjë do ta njoftojnë gjykatën duke bashkëngjitur prova të duhura në atë drejtim, atëherë gjykatësi individ merr aktvendim për ndërprerjen e procedurës.

➤ *Ndërmjetësimi i pasuksesshëm – caktimi i seancës kryesore gjyqësore*

Procedura e ndërmjetëimit mund të përfundojë e pasuksesshme për arsye të ndryshme. Për ndërmjetësimin e pasuksesshëm njoftohet gjykatësi individ, i cili cakton seancë kryesore dhe kështu vazhdon procedura e padisë private sipas dispozitave të procedurës së shkurtuar.

6.4. Procedura për lëshimin e urdhër dënimit

➤ *Vallë mundet një person të dënohet e kurrë të mos paraqitet në gjykatë?*

Po, gjykata e shkallës së parë mund të sjell aktgjykim ndëshkimit pa mos caktuar dhe mbajtur seancë kryesore, pothuajse pa mos e thirrur të akuzarin dhe t'i jep mundësi të paraqes mbrojtjen e tij/saj.

➤ *Kur?*

Për vepra penale në kompetencë të gjykatësit individ, kur për ato ekzistojnë prova të mjaftueshme, prokurori publik mund të dorëzojë propozim për lëshimin e urdhër dënimit. Propozim të këtillë mund të parashtrojë edhe paditësi privat.

➤ *Masat ose sanksionet penale të propozuara*

Me propozimin për lëshimin e urdhër dënimit, prokurori publik i propozon gjykatës të shqiptojë një ose më shumë masa ose sanksione penale, si vijon:

- 1) gjobë prej 10 deri 100 gjoba ditore;
- 2) dënim me kusht me dënim të caktuar për burgim deri në tre muaj ose gjobë;
- 3) ndalesë për drejtimin e automjeteve deri në dy vite dhe
- 4) sekuestrimin e pronës dhe shfrytëzimit të pronës të siguruar me veprën penale dhe sekuestrimin e gjësendeve.

➤ *Nëse gjykata nuk e pranon propozimin*

Nëse gjykatësi individ konsideron se të dhënat e përmbajtura në propozimin për lëshimin e urdhër dënimit ose sipas atyre të dhënave mund të pritët edhe shqiptimi i ndonjë mase ose veprë tjetër penale, e jo ato që i ka propozuar prokurori publik, pas pranimit të propozim akuzës, do të caktohet seancë kryesore sipas dispozitave të procedurës së shkurtuar. Kjo në praktikë nënkupton se prokurori publik ka parashtuar propozim akuzë, e jo propozim për lëshimin e urdhër dënimit.

➤ *Nëse gjykata e pranon propozimin*

Nëse gjykatësi individ e pranon propozimin e këtillë, atëherë do të lëshojë urdhër dënim në arsyetimin e të cilit do të theksohen vetëm provat të cilat e justifikojnë lëshimin e urdhër

dënimit dhe të njëjtin do ia dorëzojë edhe të akuzuarit si udhëzim se ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditëve nga pranimi i aktgjykimit. Nëse i akuzuari nuk e shfrytëzon të drejtën e ankesës kundër këtij aktgjykimi, atëherë i njëjti bëhet i plotëfuqishëm dhe mund të realizohet.

Në praktikë, kjo procedurë mundëson që i akuzuari të dënohet përfundimisht e juridikisht për vepra më të lehta penale, dhe kështu të mos paraqitet fare në gjykatore dhe të mos e paraqes mbrojtjen e vet në procedurë kontradiktore dhe t'i përgënjeshtrojë pohimet e akuzës. Prap se prap, gjykata e shkallës së parë nuk ka autorizime që gjatë kësaj procedure të shqiptojë dënim efektiv për burgim.

➤ *E drejta e ankesës*

Nëse i akuzuari personalisht ose nëpërmjet angazhimit të mbrojtësit ligjor e shfrytëzon të drejtën e tij ligjore dhe paraqet ankesë në kohë, atëherë gjykata e shkallës së parë, duke mos hyrë në justifikimin e ankesës, është e obliguar të caktojë seancë kryesore gjyqësore. Në rastin e tillë, procedura vazhdon sipas dispozitave të procedurës së shkurtuar.

Në praktikë, ankesa në këtë procedurë nuk ka karakter të mjetit juridik, justifikimi i të cilit duhet të jetë lëndë vlerësimi nga gjykata, por është inicativë individuale, përkatësisht paraqet sinjal se i akuzuari nuk pajtohet me „procesimin e përsheptuar“.

➤ *Çfarë ndodh me aktgjykimin tashmë të shpallur?*

Me caktimin e seancës kryesore konsiderohet se aktgjykimi për lëshimin e urdhër dënimit aspak nuk është shpallur.

7. ZBATIMI I SANKSIONEVE

➤ *Ligji për zbatimin e sanksioneve*

Çështja për mënyrën dhe procedurën e zbatimit të sanksioneve (dënimeve, masave alternative, masave të sigurisë dhe masave edukative) të shqiptuara për vepra penale, rregullohet me Ligjin për zbatimin e sanksioneve⁷⁹.

⁷⁹ Fletorja zyrtare e RM nr. 2/2006, 57/2010, 170/2013

➤ *Kur i akuzuari e merr statusin e personit të dënuar*

I akuzuari e fiton statusin e personit të dënuar kur me aktgjykim të plotëfuqishëm do të përcaktohet se ka përgjegjësi penale për një vepër të caktuar penale. Gjatë procedurës penale vendimet merren në formë të aktgjykimeve, aktvendimeve dhe urdhëresave. Aktgjykim shpall vetëm gjykata, ndërsa aktvendime dhe urdhëresa shqiptojnë edhe organet tjera që marrin pjesë në procedurën penale. Megjithatë, në pajtim me parimin e ligjshmërisë⁸⁰, sanksion penal kundër autorit të veprës penale mund të shqiptojë me vendim vetëm gjykata kompetente në procedurë të realizuar sipas Ligjit për procedurë penale.

➤ *Zbatimi i sanksioneve penale*

Sanksionet e shqiptuara për vepra penale zbatohen kur vendimi me të cilën është shqiptuar sanksioni do të bëhet i plotëfuqishëm dhe kur nuk do të ekzistojnë pengesa juridike për zbatimin e tij.

➤ *Kur vendimi është i plotëfuqishëm dhe i zbatueshëm*

Aktgjykimi dhe aktvendimi bëhen të plotëfuqishëm kur nuk mund të përgënjeshtrohen më me mjete të rregullta juridike – ankesë ose kur nuk është e lejuar ankesa.

Nga pikëpamja e zbatimit të sanksionit të shqiptuar, vendimi i plotëfuqishëm zbatohet kur është bërë dorëzimi i tij dhe kur nuk ekzistojnë pengesa juridike për zbatimin e tij. Nëse nuk është parashtruar ankesë ose palët kanë hequr dorë nga ankesa, atëherë vendimi është i zbatueshëm me skadimin e afatit për ankesë, përkatësisht nga dita e mohimit ose heqjes dorë nga ankesa e dhënë.

➤ *Zbatimi para se të bëhet i plotëfuqishëm vendimi*

Me zbatimin e disa sanksioneve të caktuara mund të fillohet edhe para plotëfuqishmërisë së vendimit me të cilin është shqiptuar sanksioni, vetëm atëherë kur kjo është përcaktuar me ligj.

➤ *Gjykata kompetente për zbatimin e sanksioneve*

Gjykatë kompetente për zbatimin e sanksioneve është gjykata sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të personit të dënuar. Nëse gjykata e shkallës së parë cila e

⁸⁰ Neni 3 p. 2, Ligji për procedurë penale, Fletorja zyrtare e RM nr. 150/2010, 100/2012

ka marrë vendimin për shqiptimin e sanksionit nuk është kompetente për zbatimin e tij, atëherë do ti dorëzoj gjykatës kompetente për zbatimin e sanksionit (ose ndonjë organi tjetër – në varësi nga lloji i sanksionit) një kopje të verifikuar të vendimit me konfirmim për të zbatuar atë. Në bazë të Ligjit për zbatimin e sanksioneve, gjykata e shkallës së parë është e obliguar menjëherë ta zbatojë atë, ndërsa më së voni tre ditë pasiqë vendimi të bëhet i zbatueshëm.

➤ *Institucionet ndëshkimore dhe edukative*

Dënimi me burg dhe masa edukative për referim në institucion edukativ-korrigjues zbatohet në institucione ndëshkimore-korrigjuese dhe institucione edukativo-korrigjuese.

Institucione ndëshkimore-korrigjuese mund të jenë institucionet për masa ndëshkimore dhe korrigjuese dhe burgjet: Institucioni ndëshkimor-korrigjues Idrizovë me departament të hapur edhe në Veles, Institucioni ndëshkimor-korrigjues Shtip, Institucioni ndëshkimor-korrigjues i llojit të hapur në Strugë, Burgu në Manastir, Burgu në Gjevgjeli, Burgu në Kumanovë me departament të hapur në Kriva Pallankë, Burgu në Ohër, Burgu në Prilep, Burgu në Shkup, Burgu në Strumicë dhe Burgu në Tetovë.

Institucionet edukative-korrigjuese për zbatimin e masës edukative në institucione edukative-korrigjuese janë institucionet edukative-korrigjuese. Institucionet edukative-korrigjuese janë: Institucioni edukativ-korrigjues në Tetovë dhe Institucioni edukativ-korrigjues në Shkup.

Ministri i drejtësisë me akt të përgjithshëm kryen shpërndarjen e të dënuarve, të gjykuarve dhe personave të mitur nëpër institucione ndëshkimore-korrigjuese dhe edukativo-korrigjuese, si edhe të personave të paraburgosur nëpër departamentet e paraburgimit pranë institucioneve ndëshkimore-korrigjuese.

Të miturit e dënuar janë të obliguar që dënimin me burgim të kryejnë në burg të posaçëm për të mitur. Ca kategori të miturve mund të kryejnë masën edukative në departamente të posaçme pranë institucioneve edukative-korrigjuese. Të miturit sipas gjinisë akomodehen në institucione të posaçme, mirëpo mund të akomodohen edhe në një institucion, por të ndarë.

➤ *Gjykatësi kompetent për zbatimin e sanksioneve*

Në të gjitha gjykatat themelore përcaktohet një gjykatës për zbatimin e sanksioneve. Gjykatësi për zbatimin e sanksioneve i mbron të drejtat e personave të dënuar, e mbikëqyr ligjshmërinë e procedurës së zbatimit të sanksioneve dhe siguron njëtrajtshmëri të personave

të dënuar para ligjit. Gjykatësi për zbatimin e sanksioneve është i obliguar të merr masa dhe veprime ligjore të caktuara për zbatimin e sanksionit pas pranimit të vendimit.

Gjykatësi për zbatimin e sanksioneve ndërmerr aktivitete dhe vendos për:

- referimin drejt vuajtjes së dënimit me burgim;
- shtyrjen e vuajtjes së dënimit me burgim;
- ndërprerjen e vuajtjes së dënimit dhe pezullimin e ndërprerjes së vuajtjes së dënimit me burgim;
- kalkulimin e dënimit, nëse gjykata kompetente nuk ka sjell vendim të përshtatshëm;
- vjetërsimin e zbatimit të dënimit ose ndërprerjen e zbatimit të të dënimit për shkak të vdekjes së të dënuarit, e njofton gjykatën kompetente rreth marrjes së vendimit të përshtatshëm;
- bashkëpunimin me qendrat kompetente për punë sociale për ndihmë post-penale dhe zbatimin e masave alternative;
- zëvendësimin e gjobës me dënim burgu;
- pagesën e gjobës me këste dhe
- punë të tjera që parashihen me ligj.

➤ *Masat e nevojshme gjatë zbatimit të dënimit me burgim*

Organi kompetent për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e dënimit me burgim është gjykatësi për zbatimin e sanksioneve sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin të personit të dënuar. Nëse vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i personit të dënuar është i panjohur, organ kompetent për referimin e personit të dënuar në vuajtjen e dënimit është gjykata e shkallës së parë, e cila e ka marrë vendimin fillimisht. Gjykata e shkallës së parë e cila e ka marr vendimin, nëse nuk dihet vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i personit të dënuar ose nëse personi i dënuar nuk është në dispozicion, do të kërkojë nga Ministria e punëve të brendshme ta gjej atë dhe menjëherë ta njoftojë gjykatën për adresën e tij/saj.

Procedura për referimin e personave të dënuar është urgjente.

Gjykata e shkallës së parë e cila e ka marrë vendimin do t'i dorëzojë gjykatës themelore për zbatimin e sanksioneve vendimin për zbatim dhe të gjitha të dhënat e rëndësishme për personin e dënuar të siguruara gjatë procedurës. Gjykatësi për zbatimin e sanksioneve është i obliguar t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e dënimit me burgim menjëherë pas pranimit të vendimit ekzekutiv, kurse më së voni tetë ditë pas pranimit të vendimit.

➤ *Akti referues*

Thirrja për zbatimin e dënimit me burgim të personit të dënuar bëhet duke i dorëzuar në dorë aktin referues, në të cilin është shënuar dita kur duhet të lajmërohet te institucioni përkatës. Me aktin referues, personi i dënuar paralajmërohet se nëse nuk paraqitet te institucioni përkatës në datën e caktuar, atëherë do të përcillet me forcë dhe do t'i bartë shpenzimet e përcjelljes. Dita e lajmërimit tek institucioni përkatës caktohet ashtu që personit t'i mbeten së paku 8, e së shumti 13 ditë nga dita e pranimit të aktit referues.

➤ *Njoftimi i institucionit dhe dorëzimi i të dhënave*

Gjykatësi për zbatimin e sanksioneve, me dorëzimin e aktit referues personit të dënuar njëkohësisht e njofton edhe institucionin rreth ditës në të cilën i dënuari duhet të lajmërohet dhe i dërgon edhe një kopje të aktgjykimit ekzekutiv dhe të plotëfuqishëm, një ekstrakt nga evidenca ndëshkimore, si edhe të dhëna të tjera në dispozicion për personalitetin e personit të dënuar.

Çfarë ndodh nëse personi i dënuar nuk lajmërohet te Institucioni përkatës?

Nëse personi i dënuar nuk lajmërohet tek institucioni përkatës, në pajtim me Aktin e referimit, në ditën e caktuar për të vuajtur dënimin me burgim, atëherë institucioni përkatës menjëherë do të njoftoj gjykatësin përgjegjës për zbatimin e sanksioneve.

➤ *Urdhëri për arrestimin e personit të dënuar dhe Urdhërarresti*

Gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve, në rast se i dënuari nuk lajmërohet për të vuajtur dënimin me burgim, menjëherë do të lëshoj urdhër tek Ministria e punëve të brendshme për arrestimin e personit të dënuar, me të cilën gjithashtu do të kërkojë që nëse personi i dënuar fshehet ose është në arrati të lëshojë edhe urdhërarrest për gjetjen dhe arrestimin e personit të dënuar tek institucioni për vuajtjen e dënimit.

➤ *Prolongimi i fillimit të vuajtjes së dënimit me burgim*

Në bazë të Ligjit⁸¹, personit të dënuar i cili gjendet në liri, me kërkesë të tij mund t'i prolongohet zbatimi i dënimit me burgim, nëse:

1. gjendet në trajtim spitalor për shkak të sëmundjes së rëndë akute ose varësisë;
2. ka ndodhur rast vdekjeje ose sëmundje e rëndë në rrethin më të ngushtë familjar të personit të dënuar;
3. prolongimi është i nevojshëm për shkak të mbarimit ose përfundimit të punëve stinore ose fushore ose punëve të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare ose ndonjë fatkeqësi tjetër, nëse në familjen e personit të dënuar nuk ka fuqi tjetër punëtore për t'i përfunduar të njëjtat;
4. personi i dënuar është i obliguar të kryejë ndonjë punë të caktuar të cilën tashmë e ka filluar, kurse për shkak të moskryerjes së atyre punëve do të shkactohej dëm më i madh;
5. prolongimi i nevojitet personit të dënuar për të përfunduar vitin shkollor ose për t'u nënshtruar ndonjë provimi për të cilin është përgatitur;
6. së bashku me personin e dënuar është dënuar edhe bashkëshorti/ja i tij/saj ose anëtarë të tjerë të amvisërisë së përbashkët ose nëse disa prej tyre janë duke vuajtur dënim, ndërsa me burgosjen e këtyre personave do të rrezikohej kujdesi për të moshuarit, të sëmurët ose anëtarëve të mitur të familjes ose do të rrezikohej ekonomizimi i zakonshëm i amvisërisë;
7. është dënuar grua, fëmija e të cilës është më e vogël se një vit ose grua shtatzënë, ndërsa deri te lindja nuk kanë mbetur më shumë se tre muaj dhe
8. është e nevojshme që personi i dënuar të kujdeset, një kohë të caktuar, për edukimin dhe kujdesin e fëmijëve ose kujdesin e personave në nevojë për të cilët është i obliguar të kujdeset, sipas mendimit të organeve për punë sociale të komunës në territorin e të cilit fëmijët ose ato persona kanë vendbanim ose vendqëndrim.

➤ *Kushti parësor për prolongim dhe implikimet praktike*

Vlen të theksohet se kusht parësor për personin e dënuar është që të mund me kërkesë/lutje të kërkojë prolongimin e fillimit të zbatimit të dënimit me burgim, por ende të gjendet në liri, përkatësisht akoma të mos ketë filluar me vuajtjen e dënimit.

⁸¹ Neni 89, Ligji për zbatimin e sanksioneve, Fletorja zyrtare e RM nr. 2/2006, 57/2010, 170/2013

Nga pikëpamja praktike, këtë kusht i cili është imponuar me dispozitat e Ligjit për zbatim të sanksioneve nuk mund të përmbushin të gjithë kategoritë e personave të dënuar, kurse për ata është e kufizuar me ligj e drejta për të kërkuar të prolongohet zbatimi i dënimit me burgim për një periudhë të caktuar kohore.

Në mënyrë ilustrative, pasiqë aktgjykimi me burgim, me të cilën të dënuarit i vazhdohet masa e paraburgimit deri sa të hyjë në fuqi aktgjykimi, përkatësisht derisa të fillojë me vuajtjen e dënimit me burgim, atëherë do të bëhet e plotëfuqishme ndërsa personi në paraburgim do të fitojë statusin e personit të dënuar, ai person menjëherë pas dorëzimit të aktgjykimit të plotëfuqishëm, nga ana e institucioni të paraburgimit së bashku me aktin e referimit dhe dokumentacionin përcjellës referohet tek institucioni i destinuar për vuajtjen e dënimit. Trajtim të njëjtë, që është imponuar nga kushti i sipërpërmendur, pranojnë edhe personat e dënuar të cilët në pajtim me aktin e lëshuar të referimit vullnetarisht ose pas lëshimit dhe realizimit të urdhërrarrestit do të fillojnë me vuajtjen e dënimit me burgim, ndërsa pasiqë të hyjnë te institucioni përkatës do të parashatrojnë lutje për prolongim.

Thjeshtë, lutja për prolongim e dorëzuar nga personi i dënuar i cili tashmë gjendet brenda Institucionit përkatës në bazë të aktgjykimit ekzekutiv dhe të plotëfuqishëm, nuk do të pranohet nga gjykata.

➤ *Prolongimi i fillimit të zbatimit të dënimit me burgim*

Zbatimi i dënimit me burgim mund të prolongohet:

- përderisa zgjat sëmundja, përkatësisht trajtimi, nëse prolongimi kërkohet për shkak se personi i dënuar gjendet në trajtim spitalor nga sëmundje e rëndë akute ose sëmundje varësie

Për shkak të specifikës së arsyes (hospitalizim për shkak të sëmundjes së rëndë akute ose varësisë) Ligji lejon që parashtrimin e lutjes për prolongimin e fillimit të zbatimit të dënimit të mund të bëjë edhe bashkëshorti/ja, farefisi, birësuesi, i birësuari, motra, vëllau ose kujdestari. Personi i dënuar, të cilit i është prolonguar vuajtja e dënimit sipas arsyeve të sipërpërmendura, është i obliguar të dorëzojë dëshmi valide për gjendjen e tij shëndetësore, çdo 30 ditë.

- më së shumti deri në tri muaj, nëse prolongimi është kërkuar për shkak të rastit të vdekjes ose sëmundjes së rëndë në rrethin më të ngushtë familjar të personit të dënuar; nëse prolongimi nevojitet për shkak të kryerjes dhe përfundimit të punëve urgjente stimore ose fushore ose gjërave të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare ose ndonjë fatkeqësi tjetër, ndërsa në familjen e personit të dënuar nuk ka fuqi të mjaftueshme tjetër pune;

nëse prolongimi kërkohet për arsye se i dënuari është i obliguar të kryejë ndonjë punë të caktuar të cilën tashmë e ka filluar, ndërsa moskryerja e asaj pune do të shkaktonte dëm më të madh; dhe nëse nevojitet përkohësisht të kujdeset për edukimin dhe ruajtjen e fëmijëve ose kujdesin e personave të paaftë, për të cilët është i obliguar të kujdeset, sipas mendimit të organeve të mbrojtjes sociale të komunës në territorin e të cilit kanë vendbanim ose vendqëndrim fëmijët ose ato persona.

- deri në përfundimin e vitit shkollor, nëse personit të dënuar i nevojitet prolongimi për të përfunduar vitin shkollor ose
- gjashtë muaj nëse prolongimi është i nevojshëm për të dhënë ndonjë provim për të cilin është përgatitur;
- më së shumti deri në gjashtë muaj, nëse së bashku me personin e dënuar është dënuar edhe bashkëshorti/ja ose anëtarë të tjerë të amvisërisë së përbashkët ose nëse disa prej tyre janë duke vuajtur dënim, ndërsa me burgosjen e këtyre personave do të rrezikohej kujdesi për të moshuarit, të sëmurët ose anëtarëve të mitur të familjes ose do të rrezikohej ekonomizimi i zakonshëm i amvisërisë;
- deri në mbushjen e një viti të jetës së fëmijës, nëse i dënuari është grua, fëmija e të cilës është më e vogël se një vit ose nëse është shtatzënë, kurse deri në lindje kanë mbetur më pak se tre muaj

➤ *Lutja për prolongim*

Lutja për prolongimin e fillimit të vuajtjes së dënimit me burgim dorëzohet në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të aktit të referimit. Nëse arsyeja për prolongim sipas nenit 89 prg. (1) pikat 1 dhe 2 të Ligjit për zbatimin e sanksioneve – trajtimi mjekësor për shkak të sëmundjes më të rëndë akute ose rastit të vdekjes ose sëmundjes së rëndë në rrethin e ngushtë familjar të personit të dënuar; ka ndodhur në atë afat, atëherë lutja mund të dorëzohet deri në ditën kur personi i dënuar duhet të lajmërohet për vuajtjen e dënimit.

➤ *Dëshmi të besueshme si shtojcë të lutjes për prolongim*

Lutjes i bashkangjiten edhe dëshmi të besueshme për arsyet që e justifikojnë prolongimin.

➤ *Cili vendos për lutjen e prolongimit*

Për lutjen e prolongimit të fillimit të dënimit me burgim vendos gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve, i cili është i obliguar të sjell vendim në afat prej tre ditëve pas pranimit të lutjes. Para sjelljes së vendimit ai mund t'i hetoj rrethanat e theksuara në lutjen.

➤ *Funksioni pezullues i lutjes*

Fillimi i zbatimit të dënimit me burgim prolongohet deri në sjelljen e vendimit për lutjen.

➤ *E drejta për ankesë*

Kundër aktvendimit të sjellur rreth lutjes për prolongimit të fillimit të zbatimit të dënimit me burgim, personi i dënuar dhe prokurori kompetent publik kanë të drejtë ankesë deri te këshilli penal i gjykatës përgjegjëse për zbatimin e sanksioneve në afat prej tre ditëve pas pranimit të aktvendimit të shkallës së parë.

➤ *Funksioni pezullues i ankesës*

Ankesa e prolongon zbatimin e dënimit. Këshilli penal është i obliguar të sjell aktvendim rreth ankesës në afat prej tre ditëve pas pranimit të ankesës.

➤ *Mjete të jashtëzakonshme juridike dhe prolongimi i zbatimit të dënimit me burgim*

Prolongim të fillimit të zbatimit të dënimit me burgim mund të caktojë edhe gjykata kompetente me kërkesë për përsëritjen e procedurës penale të dorëzuar në dobi të personit të dënuar, me kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktgjyqimit të plotëfuqishëm dhe me kërkesë për zëvendësimin e dënimit me burgim me gjobë, sipas kushteve të parashikuara me Ligj.

➤ *Lutja e palejuar për prolongim*

Gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve do të refuzojë si të palejuar lutjen sërish të dorëzuar sipas bazave (arsyeve) të njëjta nga neni 89 i Ligjit për zbatimin e sanksioneve për prolongimin e fillimit të zbatimit të dënimit me burgim. Lutja sërish e dorëzuar nuk e prolongon fillimin e zbatimit të dënimit.

➤ *Ndërprerja e vuajtjes së dënimit të personave të dënuar*

Me kërkesë të personit të dënuar ose me propozim të drejtorit të institucionit përkatës, në bazë të mendimit të shërbimit shëndetësor të burgut dhe në bazë të mendimit paraprak të prokurorit kompetent publik, gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve mund të ndërpres vuajtjen e dënimit më gjatë se 30 ditë për shkak të trajtimit mjekësor, nëse nuk ekzistojnë kushte që trajtimi mjekësor të zhvillohet në institucionin përkatës ose institucioni mund ta referoj të dënuarin në institucion të përshtatshëm shëndetësor. Një kopje e vendimit i dorëzohet edhe prokurorit kompetent publik.

Personi i dënuar, të cilit i është lejuar ndërprerja e vuajtjes së dënimit për shkak të trajtimit mjekësor, është i obliguar çdo muaj t'i dorëzojë vërtetim gjykatësit përgjegjës për zbatimin e sanksioneve lidhur me gjendjen e tij shëndetësore. Nëse përcaktohet se janë ndërprerë arsyet me të cilat fillimisht u ndërpre vuajtja e dënimit, atëherë gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve do të zhvleftësojë aktvendimin për ndërprerjen e dënimit.

Propozim për zhvleftësimin e aktvendimit mund të dorëzojë edhe prokurori kompetent publik. Me këtë propozim, prokurori publik mund të kërkojë që gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve të kryejë kontrollë të pavarur mjekësor të personit të dënuar.

Kundër aktvendimit të sjellur me kërkesën për ndërprerjen e vuajtjes së dënimit, personi i dënuar dhe prokurori kompetent publik kanë të drejtë ankese deri te këshilli penal i gjykatës kompetente për zbatimin e sanksioneve.

➤ *Ndërprerja deri në 30 ditë*

Personave të dënuar me burgim, drejtori i drejtorisë për zbatimin e sanksioneve mund t'ua ndërpres vuajtjen e dënimit në kohëzgjatje deri në 30 ditë, për arsyet e theksuara në nenin 89 të Ligjit për zbatimin e sanksioneve. Kundër aktvendimit të drejtorit të drejtorisë, personi i dënuar ka të drejtë ankese deri te Ministri i drejtësisë në afat prej tre ditëve pas pranimit të aktvendimit.

Koha e kaluar gjatë ndërprerjes së vuajtjes së dënimit nuk llogaritet në dënimin e vuajtur.

Nëse pas skadimit të kohës së ndërprerjes së dënimit personi i dënuar nuk lajmërohet që të vazhdojë vuajtjen e dënimit, atëherë institucioni përkatës do të njoftoj gjykatësin përgjegjës për zbatimin e sanksioneve, i cili do të ndërmerr masa ligjore për arrestimin e personit të dënuar dhe vazhdimin e vuajtjes së dënimit. Ndërprerje të vuajtjes së dënimit mund të përcaktojë edhe gjykata kompetente kur vendos rreth disa mjeteve të jashtëzakonshme juridike të dorëzuara në procedurën penale nga palët.

➤ *Lirimi i personave të dënuar nga vuajtja e dënimit*

Personat e dënuar lirohen nga vuajtja e dënimit pas vuajtjes së plotë të tij, pas faljes së pjesës së mbetur me akt ligjor, pas vendimit për lirim me kusht ose pas vendimit të drejtorit të institucionit për lirim të parakohshëm të vuajtjes së dënimit.

➤ *Lirimi pas vuajtjes së dënimit*

Personi i dënuar lirohet nga vuajtja e dënimit nga institucioni përkatës në ditën dhe orën kur i skadon vuajtja e dënimit. Nëse dita e fundit të vuajtjes së dënimit është e diel ose festë, atëherë personi i dënuar lirohet ditën që paraprin.

➤ *Lirimi pas faljes së dënimit*

Personi i dënuar lirohet nga vuajtja e dënimit nga institucioni përkatës atë ditë kur me aktin e amnestisë ose faljes së sjellur nga organi kompetent lirohet nga vuajtja e mëtutjeshme e dënimit me burgim.

➤ *Lirimi me kusht*

Personi i dënuar lirohet nga vuajtja e dënimit atë ditë kur me aktvendim për lirim me kusht është caktuar lirimi i tij/saj.

➤ *Kushtet e përgjithshme për lirim me kusht*

I dënuari mund të lirohet nga vuajtja e dënimit me kusht që deri në skadimin e kohës që është paraparë për vuajtjen e dënimit të mos kryejë vepër të re penale dhe nëse është korrigjuar, kështu që pritët që mirë të sillet derisa është në liri, e sidomos të mos kryejë vepra penale. Gjatë vlerësimit nëse i dënuari do të lirohet me kusht do të merret parasysh sjellja e tij gjatë vuajtjes së dënimit, kryerjen e detyrave në bazë të aftësive të tij të punës dhe rrethana tjera që tregojnë se është arritur qëllimi i vuajtjes së dënimit.

Liri me kusht mund të fitojë i dënuari që ka vuajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar.

Me përjashtim, me kusht mund të lirohet edhe i dënuari i cili ka vuajtur vetëm të tretën e dënimit me burgim sipas kushteve të sipërpërmendura dhe nëse rrethana të caktuara e të veçanta lidhur me sjelljen e tij tregojnë se është arritur qëllimi i vuajtjes së dënimit.

➤ *Liria me kusht e personave të dënuar me burgim të përjetshëm*

I dënuari me burgim të përjetshëm nuk mund të lirohet me kusht derisa t'i vuaj së paku 15 vite dënim me burgim.

➤ *Lirimi me kusht me mbrojtje të mbikëqyrur*

Personit të liruar me kusht, gjykata mund t'i caktojë mbrojtje të mbikëqyrur, që përbën masa të posaçme për ndihmë, kujdes, mbikëqyrje ose mbrojtje, të cilat i realizon organi për punë sociale.

➤ *Lirimi me kusht i të miturit që vuan dënim me burgim në institucion për të mitur*

I mituri mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit në burg për të mitur nëse ka vuajtur një të tretën e dënimit, por jo para se të kalojë një vit i vuajtjes së dënimit dhe nëse nga suksesi i arritur gjatë edukimit dhe rehabilitimit mund të pritët që do të sillët mirë në liri, do të vazhdojë shkollimin dhe punën dhe se nuk do të kryejë vepra penale në të ardhmen. Gjatë lirimimit me kusht gjykata mund të caktojë masë për mbikëqyrje të forcuar ose mbrojtur.

➤ *Procedura e lirimimit me kusht*

a. Kërkesa dhe propozimi për lirimim me kusht

Kërkesë për lirim me kusht, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, mund të dorëzojë personi i dënuar ose bashkëshorti/ja, farefisi, birësuesi, i birësuari, vëllau, motra dhe kujdestari. Propozim për lirimim me kusht të personit të dënuar mund të dorëzojë edhe drejtori i institucionit.

b. Aktvendimi për lirim me kusht

Për lirimim me kusht të personit të dënuar vendos gjykata e cila e ka sjellur aktgjykimin në shkallën e parë në përbërje të këshillit prej tre gjykatësve, i cili vendos jashtë seancës kryesore (këshillit penal).

Para marrjes së vendimit për lirimim me kusht, gjykata e shkallës së parë do të kërkojë të dhëna nga institucioni, madje mund të merret në pyetje edhe i dënuari dhe të kërkohet mendim nga gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve, si edhe nga zyrtarë të tjerë të institucionit për rrethanat lidhur me personalitetin e personit të dënuar, sjelljes së tij gjatë vuajtjes së dënimit, kryerjen e detyrave brenda institucionit dhe për rrethana të tjera me ndihmën e të cilave do të mund të konkludohet se është arritur qëllimi i ndëshkimit dhe sidomos nëse personi i dënuar nuk do të kryejë vepra penale në të ardhmen.

Në aktvendimin e lëshimit me kusht theksohet dita e lirimit të personit të dënuar dhe është me rëndësi të kihet kujdes për afatin e procedurës ankimore. Aktvendimi, me të cilin gjykata vendos për lirim me kusht, i dorëzohet personit të dënuar, anëtarit të familjes që ka dorëzuar kërkesën për lirim me kusht, institucionit ku e vuan dënimin personi i dënuar, prokurorit kompetent publik dhe njësisë rajonale të Ministrisë së punëve të brendshme në bazë të vendbanimit, përkatësisht qëndrimin të personit të dënuar, në qoftë se vendimi është pozitiv. Në aktvendimin për lirim me kusht gjykata mund t'i caktojë mbikëqyrje të liruarit me kusht, e cila përbëhet prej masave të posaçme të ndihmos, kujdesit ose mbrojtjes, të cilat realizohen nga organi për punë sociale.

Kundër aktvendimit të kërkesës ose propozimit për lirim me kusht kanë të drejtë ankese edhe personi i dënuar edhe prokurori kompetent publik në afat prej tetë ditëve deri te gjykata më e lartë. Propozimin e drejtorit të institucionit e përfaqëson dhe arsyeton përfaqësues i institucionit në të cilin e vuan dënimin personi i dënuar.

c. Dorëzimi i kërkesës/lutjes për lirim me kusht për së dyti

Lutja, përkatësisht propozimi për lirim me kusht, mund të dorëzohet sërish pas skadimit të gjashtë muajve deri në një vit të vuajtjes së dënimit, përkatësisht tre muaj/një vit nga aktvendimi i plotëfuqishëm me të cilën është refuzuar lutja paraprake e personit të dënuar, gjegjësisht propozimit të drejtorit.

ç. Lirimi me vendim të drejtorit të institucionit

Drejtori i institucionit mund të lirojë personin e dënuar edhe para skadimit të dënimit nëse ka vuajtur së paku tre të katërtat e dënimit me burgim dhe nëse nuk ka pranuar aktvendim për lirim me kusht edhe atë për një vit burgim 30 ditë, për pesë vite burgim 90 ditë dhe mbi pesë vite dënim me burgim 120 ditë. Drejtori i institucionit me akt të përgjithshëm i përcakton kriteret për lirimin e personit të dënuar para skadimit të afatit të dënimit.

➤ *Zbatimi i dënimit në burg për të mitur*

Personat e mitur dënimin me burgim për të mitur, deri në moshën 23 vjeçare, e vuajnë nëpër institucione të posaçme për të mitur, të ndarë nga personat e rritur. Personat e mitur të gjinisë mashkullore patjetër duhet të jenë të akomoduar veç nga personat e mitur të gjinisë femërore. Ata mund të bashkohen në kuadër të programeve edukative, sociale dhe argëtuese ose programeve për aftësim profesional.

Me arritjen e moshës 23 vjeçare, personat e dënuar nëpër institucione për të mitur, dënimin e tyre e vuajnë sipas aktit për dislokim të personave të dënuar dhe të mitur nëpër institucionet edukative-korrigjuese. Nëpër institucionet për të mitur mund të organizohen ligjerata për arsim dhe trajnim themelor, si dhe lloje të tjera të programeve për aftësim profesional në varësi të kushteve dhe mundësive të institucionit përkatës. Nëse në institucionin për të mitur nuk ka kushte për organizimin e mësimit të këtitillë, atëherë personat e mitur mund të vijojnë mësim në shkollën pranë selisë së institucionit për të mitur.

➤ *Procedura gjatë zbatimit të gjobës*

Procedurën për arkëtimin e gjobës së personave fizik sipas detyrës zyrtare e ngrit gjykata e cila e ka shqiptuar gjobën në shkallën e parë. Nëse personi i dënuar nuk ka vendbanim të caktuar, përkatësisht vendqëndrim në territorin e gjykatës e cila e ka shqiptuar gjobën në shkallën e parë, atëherë gjykata e shkallës së parë është e obliguar që aktgjykimin e plotëfuqishëm për arkëtimin e gjobës t'ia dorëzoj gjykatës sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit.

Nëse personi i dënuar, në afatin e caktuar kohor nuk e paguan gjobën, atëherë ai i nënshtrohet pagesës me forcë. Shpenzimet e pagesës me forcë të gjobës janë në kurriz të personit të dënuar. Gjykatësi përgjegjës për zbatimin e sanksioneve, para se të realizojë pagesën me forcë, së pari i dërgon një paralajmërim personit të gjobuar të paguajë gjobën në afat që s'mund të jetë më gjatë se 15 ditë pas ditës së pranimit të paralajmërimit. Nëse personi i gjobuar nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, atëherë ndërmerren masa për pagesë me forcë në pajtim me ligjin. Nëse pagesa me forcë është e pasuksesshme, atëherë merren masa për zëvendësimin e gjobës me dënim me burgim.

Nëse personi i gjobuar nuk mund të paguaj gjobën menjëherë, atëherë mund ta paguaj me tri këste, mirëpo afati për kryerjen e pagesës nuk mund të jetë më gjatë se dy vite, me mundësi për vazhdimin e afatit edhe për tre muaj. Nëse personi i gjobuar nuk i paguan në kohë këstet, atëherë gjykata do e revokojë vendimin e pagesës me këste dhe do të merr masa për pagesën e menjëhershme të gjobës ose zëvendësimin e gjobës me burgim.

➤ *Zbatimi i sanksioneve të tjera për veprat e kryera penale*

Me Ligjin për zbatimin e sanksioneve është e rregulluar hollësisht procedura për zbatimin e sanksioneve të tjera, të sipërpërmendura, për vepra penale.

8. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Mediat luajnë rol të rëndësishëm në një shoqëri demokratike në tërësi dhe më konkretisht në raport me sistemin gjyqësor. Perceptimi në shoqëri për cilësinë e drejtësisë është ndër ndikim të madh të mediave, sidomos lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor. Transparenca në punën e gjyqësorit, si edhe prania e publikut në proceset gjyqësore kanë rëndësi të veçantë për realizimin e të drejtës së gjykimit të drejtë. Interesimi i rritur i publikut dhe mediave në raport me proceset gjyqësore në mënyrë të pashmangshme e imponon nevojën për përcjelljen e informacioneve objektive dhe me kohë tek mediat. Rëndësi thelbësore në një shoqëri demokratike është fakti që opinioni publik të ketë besim në gjykatat.⁸² Pjesëmarrja e publikut në procedura gjyqësore është një ndër instrumentet themelore me të cilën mund të ruhet besimi tek gjykatat.⁸³

Gazetarët kanë të drejtë t'i marrin të gjithë informacionet e nevojshme me qëllim të informimit objektiv të opinionit publik rreth çështjeve të llojllojshme lidhur me punën e sistemit të jurisprudencës. Gjatë hulumtimit dhe raportimit të vet, çdo gazetar duhet t'i respektojë dhe t'u përmbahet obligimeve të diskrecionit lidhur me lëndët aktuale, si edhe kufizimeve të përcaktuara në legjislacionin vendas, të cilat janë të harmonizuara me standardet evropiane.

Edhe mediat sikur të gjithë pjesëmarrësit në proceset gjyqësore duhet t'i respektojnë parimet themelore siç është prezumimi i pafajësisë dhe e drejta për gjykim të drejtë, e drejta e jetës private të personave të përfshirë, si edhe parimin e paanësisë.

Mbulimi medial i rasteve të cilat hetohen ose janë në fazë të gjykimit mund të ketë ndikim dhe shtypje të caktuar mbi gjykatësit, gjykatësit-porotë dhe prokurorët publik, të cilët janë të përfshirë në lëndën konkrete. Prandaj, është me rëndësi thelbësore që gazetarët të posedojnë shkathtësi profesionale, standarde të larta etike dhe vetëpërmbytje gjatë dhënies së komenteve të parakohshme rreth lëndëve aktuale gjyqësore.

Nga ana tjetër, gjykatësit dhe prokurorët publik duhet të posedojnë trajnim të duhur gjatë kontaktit me mediat, të kenë të përpiluar udhëzime të përshtatshme ose një kod të praktikave të mira për marrëdhëniet e tyre me mediat⁸⁴ dhe në këtë mënyrë t'u ndihmojnë mediave në përcjelljen e informacioneve të sakta rreth punës së gjykatave dhe vendimeve të tyre.

⁸² Për këtë është shih vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Oluji kundër Kroacisë, (aplikacioni nr. 22330/05)

⁸³ Në kuadër të Këshillit të Evropës, dy dokumente kryesore merren me këtë çështje:

a) Rekomandimi Rec (2003) 13 për dhënien e informacioneve nëpërmjet mediave lidhur me procedurat penale, dhe
b) Mendimi numër 7 për drejtësi dhe shoqëri (2005) i Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian.

⁸⁴ Mendimi nr.7 i Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian për drejtësinë dhe shoqërinë, alinea 39 (2005).

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

Gjykatësit dhe prokurorët kanë rol konkret në sistemin juridik. Disa kode të caktuara vendase kërkojnë që gjykatësit të përmbahen nga komentet publike rreth lëndëve aktuale, përkatësisht të mos japin komente të cilat do të shkaktonin dyshime tek opinioni publik për paanshmërinë e tyre⁸⁵, por edhe me qëllim të mos shkelet e drejta e prezumimit të pafajësisë. Prokurorët publik duhet të jenë të matur kur e komentojnë procedurën ose aktgjykimin. Mospajtimin e tyre për vendimin gjithsesi do ta shprehin nëpërmjet zbatimit të mjetit juridik të rregullt ose të jashtëzakonshëm.

⁸⁵ Mendimi nr.3 i Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian për etikë dhe përgjegjësi të gjykatësve, alinea 40 (2003).

SHTOJCA 1:

Nocionet e Ligjit për procedurë penale

I dyshimtë është ai person kundër të cilit zhvillohet procedurë paraprake.

I akuzuar është ai person kundër të cilit është ngritur aktkuzë, është dorëzuar propozim akuzë, është dorëzuar propozim për zbatim të masës së sigurisë, është ngritur padi private ose është parashtruar propozim për lëshim të urdhërdënimit.

I dënuar është ai person për të cilin me aktgjykim të plotëfuqishëm është vërtetuar se është penalisht përgjegjës për ndonjë vepër të caktuar penale.

Nocioni ***i akuzuar*** përdoret edhe si term i përgjithshëm për të dyshimtin, të akuzuarin dhe të dënuarin.

Viktimë e veprës penale është çdo personi të cilit i është shkaktuar dëm, përfshirë dhe lëndime fizike ose psikike, vuajtje emocionale, humbje materiale ose ndonjë lëndim tjetër ose shkelje të të drejtave dhe interesave të tij/saj si rrjedhojë e kryerjes së një veprë penale.

I dëmtuar është, krahas viktimës, edhe një person tjetër e drejta personale ose pronësore e të cilit është shkelur ose rrezikuar me vepër penale dhe i cili merr pjesë në procedurën penale ose kërkon kompensim për dëmin e shkaktuar.

Paditës privat është personi i cili ka ngritur padi private për ndjekjen e veprave penale të cilat ndiqen me padi private.

Paditës është prokurori publik ose paditësi privat.

Palë janë paditësi dhe i akuzuari.

Policia gjyqësore janë zyrtarët e policisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe pjesëtarët e Policisë financiare, si dhe personat e autorizuar me ligj nga Drejtoria doganore, të cilët i janë dhënë në dispozicion prokurorisë publike për zbulimin e veprave penale dhe zhvillimin e procedurës hetimore.

Nocioni ***polici*** në këtë ligj përdoret si emërtim i përgjithshëm për pjesëtarët e policisë gjyqësore në kuptimin e këtij ligji dhe zyrtarët policorë në kuptimin e Ligjit për polici, si edhe pjesëtarët e Policisë ushtarake.

Gjykatës i procedurës së mëparshme është gjykatësi i cili gjatë procedurës së mëparshme vendos për liritë dhe të drejtat e të akuzuarit në rastet e paraparë me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, të ratifikuar me ligj dhe marrëveshje ndërkombëtare në pajtim

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si dhe për çështje të tjera të përcaktuara në këtë Ligj.

Ekzaminim direkt është marrja në pyetje e dëshmitarit ose ekspertit nga pala e mbrojtjes, e cila e ka propozuar dëshmitarin, përkatësisht ekspertin.

Kundërekzaminimi është marrja në pyetje e dëshmitarit dhe ekspertit nga pala e kundërt.

Baza dyshimi janë njohuritë të cilat në bazë të njohurive dhe përvojës kriminalistike mund të vlerësohen si provë për veprën e kryer penale.

Dyshim i bazuar është nivel më i lartë i dyshimit bazuar në provat e siguruara, të cilat shpiejnë në përfundimin se një person i caktuar ka kryer vepër penale.

Kontrolli i personave, automjeteve, bagazhin e veturave dhe hapësirave paraqet autorizim në bazë të këtij ligji dhe ligjeve të tjera, i cili është i kufizuar në kontrollin e jashtëm të rrobave dhe gjësendeve të tjera, si dhe bagazhin me ndihmën e shqisave pamore, dëgjimit dhe nuhatjes, por jo edhe të diçkaje që nuk është e dukshme, të duket me hapjen, çpaketimin, etj.

Bastisja është kontrollimi i personit, shtëpive dhe hapësirave të tjera në bazë të urdhëresës së gjykatës.

Me **xhirim** nënkuptohet xhirimi audio-vizual ose vetëm xhirim vizual ose audio.

Këshilltarë teknik janë persona ekspertë nga regjistri i ekspertëve gjyqësorë, të cilët palët i angazhojnë gjatë procedurës nëse kanë nevojë për ndihmë eksperte në ndonjë fushë të caktuar.

SHTOJCA 2:

Rregullat e sjelljes brenda Gjykatës Themelore Shkupi I, Shkup⁸⁶

1. Vizitorët paralajmërohen se hyjnë në ndërtesë gjyqësore dhe duhet t'i respektojnë standardet e përshtatshme të sjelljes. Çdokush që nuk do t'i respektojë rregullat e gjykatës ose nuk iu përmbahen standardeve të sjelljes do të largohet nga ndërtesa gjyqësore.
2. Nuk lejohet hyrja e personave të cilët nuk i kanë mbushur 18 vite në ndërtesën gjyqësore, përveç me leje ose urdhër të gjykatës dhe me praninë e personit të rritur ose me aprovim të administratës gjyqësore.
3. Vizitorët të cilët marrin pjesë në seancën kryesore gjyqësore do të vendosen nëpër vendet e caktuara për publikun. Kryetari i këshillit gjyqësor mund të urdhërojë largimin e personave nga vendet e publikut në qoftë se ai/ajo e ndërpret ose prish rendin në gjykatore.
4. Vizitorët patjetër të çohen në këmbë me hyrjen e gjykatësit në gjykatore.
5. Gjatë seancës kryesore vizitorët duhet të jenë të qetë dhe t'u përmbahen udhëzimeve të dhëna nga policia gjyqësore.
6. Gjatë seancës kryesore ndalohen bisedat ndërmjet vizitorëve, zhurma e zëshme, sjellja e dhunshme, fyese ose çfarëdo aktiviteti tjetër që do të prishte mbarëvajtjen e papenguar të punës së gjykatës.
7. Është e domosdoshme që personat që hyjnë në gjykatë të jenë të veshur në mënyrë të përshtatshme. Ndalohet veshja provokative, shqetësuese ose veshja e cila përmban shenja ose fotografi fyese.
8. Gjatë hyrjes në gjykatore ndalohet futja e celularëve, Lap Top, PDA, kamerave ose çfarëdo pajisje tjetër audio dhe video me të cilën mund të xhirohet ose përpunohet. Këto pajisje duhet të lihen në dollapët e caktuar për atë destinim.
9. Ndalohet rreptësisht xhirimi ose fotografimi audio dhe video pa lejen e administratës në ndërtesën gjyqësore. Policia gjyqësore është e autorizuar të sekuestrojë dhe/ose të fshijë xhirime të paautorizuara.
10. Ndalohet pirja, ushqimi, duhani ose përdorimi i substancave narkotike në ndërtesën gjyqësore.
11. Vizitorët nuk guxojnë të lënë valixhe ose gjësende personale pa mbikëqyrje. Vizitorët që fusin valixhe të tepërta dhe të pazakonshme mund të mos lejohen të hyjnë. Gjykata nuk

⁸⁶ Ky dokument nuk është zyrtar. Qëllimi është vetëm informativ.

merr përgjegjësi për gjësende të humbura, të dëmtuara ose vjedhura të vizitorëve derisa janë në hapësirat e gjykatës.

12. Policia gjyqësore mund të bëj thirrje për boshatisjen e ndërtesës së gjykatës në çdo kohë. Ju lutemi përfillni dhe përmbahuni udhëzimeve të tyre.

SHTOJCA 3:

KODI ETIK I SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË

PARIME TË SJELLJES:

Liria e medias është e drejtë e pakontestueshme

Detyra themelore e gazetarëve është ta respektojnë të vërtetën dhe të drejtën e opinionit për të

qenë i informuar në pajtim me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Gazetarët kanë rolin të transmetojnë informacione, ide dhe mendime dhe të drejtën për të komentuar. Duke respektuar vlerat etike dhe standardet profesionale gjatë transmetimit të informacioneve, gazetarët do të jenë të ndershëm, objektiv dhe të saktë.

E drejtë dhe obligim i gazetarëve është që të përpiqen të pengojnë cenzurën dhe shtrembërimin e lajmeve.

Duke ndjekur detyrën e tij në ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë civile, gazetarët do t'i mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do ta respektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë për forcimin e shtetit juridik dhe në kontrollin e pushtetit dhe të subjekteve tjera nga jeta publike.

NË BAZË TË KËTYRE PARIMEVE DHE VLERAVE ETIKE:

1. Gazetari ka të drejtë të qasjes së lirë deri te të gjitha burimet e informimit që janë me interes publik.

Gazetari duhet të publikojë informacione të sakta, të verifikuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale dhe nuk do të falsifikojë dokumente.

Nëse informata nuk mund të vërtetohet ose bëhet fjalë për supozim, përkatësisht spekulim, kjo duhet të thuhet dhe të publikohet.

Saktësia e informatës duhet të provohet sa më shumë të jetë e mundur.

2. Nëse gazetari është penguar të arrijë deri te informacioni i kërkuar, ka të drejtë që për këtë ta informojë opinionin publik.

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

3. Gazetari do të tentojë të sigurojë publikimin e korigjimit, demantit dhe përgjigjes në rast kur do të jetë konstatuar pasaktësia e informacionit.
4. Gazetari do ta bëjë të ditur burimin e informacionit, por nëse burimi kërkon të mbetet anonim, gazetari do ta mbrojë.
5. Gazetari do t'i respektojë ligjet e shtetit, por nuk do të publikojë ose fsheh asgjë që është në kundërshtim me interesin publik.
6. Gazetari nuk guxon të përdorë median për publikimin apo për fshehjen e informacioneve për përfitime personale.

Mitoja, korrupsioni dhe reketi janë të huaja për profesionin e gazetari.

Nuk guxon të lejohet reklamimi dhe motivet tjera komerciale të ndikojnë ndaj lirisë së informimit. Duhet të ekzistojë dallim i qartë mes reklamimit dhe tekstit gazetaresk me ilustrim.

7. Gazetari do ta respektojë privatësinë e individit, përveç kur kjo është në kundërshtim me interesin publik. Gazetari është i detyruar ta respektojë dhimbjen dhe vuajtjen personale.
8. Mënyra e informimit në raste të fatëkeqësive, katastrofave, luftërave, tragjedi familjare, sëmundjeve, proceseve gjyqësore duhet të jenë të çliuara nga senzacionalizmi.

Në procese gjyqësore duhet të respektohet parimi i presumcionit të pafajësisë, të raportohet për të gjithë të involvuarit në kontest dhe të mos sugjerohet vendimi i gjykatës.

9. Gazetari nuk guxon të intervistojë ose fotografojë fëmijë nën 16 vjeç pa pëlqimin e prindërve ose kujdestarit, përveç nëse ajo nuk është në pajtim me të drejtat e fëmijës.

E njëjta vlenë edhe për personat me nevoja të veçanta, që nuk janë në gjendje të gjykojnë me vetëdije të plotë.

10. Gazetari nuk do të krijojë me vetëdije e as që do të trajtojë informacione që i rrezikojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urretjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim në çfarëdo qoftë baze (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientimit seksual, politike.)
11. Gazetari do t'u përmbahet standardeve shoqërore dhe korrektësisë dhe do të respektojë dallimet etnike, kulturore dhe fetare në Maqedoni.

12. Plagjiatura është e papranueshme.

Deklaratat nuk guxojnë të citohen pa mos theksuar burimin apo autorin.

13. Gazetari duhet të bëjë dallim mes fakteve dhe mendimeve, mes lajmit dhe komentit.

14. Raportimi për proceset policore, veçanërisht i zgjedhjeve, duhet të jenë i paanshëm dhe i balancuar.

Gazetari duhet të sigurojë distancë profesionale nga subjektet politike.

15. Gazetari duhet ta kultivojë gjuhën e kulturës dhe etikës.

Komunikimi i pashembullt me opinionin është i papranueshëm për profesionin e gazetarit.

16. Gazetari do të ruaj reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do të nxisë solidaritetin e ndërsjellë dhe pluralizmin e mendimeve dhe nuk do ta përdor median e tij për të qëruar hesapet me individë, duke inkuadruar edhe kolegët e tij.

17. Gazetari ka të drejtë ta refuzojë detyrën e punës nëse është në kundërshtim me parimet e këtij Kodi.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE:

Gazetarët që punojnë në pajtim me këtë Kod e kanë mbështetjen e shtëpisë së tyre mediale dhe të organizatës së tyre profesionale.

Në pajtim me ligjet e Republikës së Maqedonisë, gazetarët do të pranojnë gjykimin rreth profesionit të tyre vetëm nga kolegët e tyre dhe do të jenë jashtë ndikimit politik dhe ndikimeve të tjera.

Për respektimin e parimeve të këtij Kodi kujdeset Këshilli i Nderit i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë.

SHTOJCA 4:

Nene të Rregullore gjyqësore⁸⁷ që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me opinionin publik.

Neni 353

Kryetari, gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësor janë të obliguar të sigurojnë kushte të nevojshme për opinionin në punën e gjykatës dhe qasje të duhur për mediat në drejtim të procedurave dhe informacioneve aktuale që zhvillohen në gjykatë, duke pasur parasysh interesat e procedurës, privatësinë dhe sigurinë e pjesëmarrësve në procedurë.

Koha, vendi dhe lënda e gjykimit shpallen çdo ditë në vend të dukshëm pranë hapësirës ku do të mbahet seanca gjyqësore.

Për seancën në të cilën do të ketë interesim më të madh të opinionit, administrata gjyqësore do të sigurojë hapësira në të cilën do të mund të akomodohen më shumë pjesëmarrës. Këshilli gjyqësor është i obliguar që me urdhër të kryetarit të gjykatës të mbaj seancë në hapësirën e rezervuar për atë.

Neni 354

Raportimet për mediat lidhur me punën e gjykatës i jep kryetari ose gjykatësi i autorizuar nga kryetari. Raportimet lidhur me lëndët konkrete, në pajtim me kryetarin, i jep gjykatësi përgjegjës për lëndën.

Gjatë raportimit të dhënat duhet të jenë të sakta. Nuk kumtohen ato të dhëna që paraqesin informacion të besueshëm në bazë të nivelit të përshtatshëm të besueshmërisë sipas ligjit.

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, Gjykatën administrative, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat themelore që kanë numër më të madh të gjykatësve themelohet shërbim informacioni ose caktohet një gjykatës me qëllim të informimit objektiv dhe të hapur të opinionit publik për punën e gjykatës.

Gjatë kontaktit me opinionin dhe mediat do të përdoren të gjitha mjetet e mundshme të komunikimit në pajtim me mundësitë materiale të gjykatës.

⁸⁷ Fletërja zyrtare e RM nr.66/2013

Neni 355

Gjykatësit dhe nëpunësit e gjykatave, të cilët në emër personal i drejtohen mediave për çështje juridike, shoqërore dhe çështje të tjera rreth lëndëve të caktuara nga praktika gjyqësore, janë të obliguar që gjatë atyre komenteve të theksojnë në mënyrë eksplicite se shkresa apo komenti i bërë është në emër të tyre personal, përkatësisht e theksojnë mendimin e tyre.

Neni 356

Gazetarët – raportues mund të marrin pjesë në seancat publike gjatë procedurave kontestimore dhe në seancat kryesore gjyqësore gjatë procedurave penale pas mos marrë leje paraprake nga gjykata. Gjykata ka për detyrë të sigurojë kushte për praninë dhe punën e tyre.

Fotografimi, raportimi dhe xhirimi vizuel (video) dhe audio gjatë procedurës gjyqësore mund të bëhet me leje të kryetarit të gjykatës, të mendimin paraprak të pranuar nga gjykatësi dhe paditësi i autorizuar në procedurën penale, si dhe me pëlqim me shkrim nga palët e përfshira në procedurën kontestimore.

Me përjashtim të rasteve nëse pala e përfshirë në procedurë është funksionar ose zyrtar shtetëror, përfaqësues i pushtetit lokal ose person që kryen veprimtari tjetër publike, atëherë nuk nevojitet leje me shkrim për xhirim ose fotografim.

Xhirimi dhe fotografimi në ndërtesën gjyqësore, jashtë seancës dëgjimore, mund të bëhet me leje nga kryetari i gjykatës, i cili është përgjegjës për menaxhimin e ndërtesës.

Neni 357

Leje për xhirim ose fotografim jep kryetari i gjykatës në bazë të kërkesës së dorëzuar me shkrim. Kërkesa duhet të dorëzohet në afat prej pesë ditëve para fillimit të seancës dëgjimore sipas formularit që e jep administrata gjyqësore. Kërkesat e dorëzuara me vonëse nuk do të refuzohen nëse dëshmohen arsyet e vonësës. Kërkesa përmban:

- emrin e shtëpisë mediale;
- emrat dhe përbërjen e ekipeve të raportimit (xhiruesi, fotografi, asistenti, etj.);
- përshkrimin e pajisjeve teknike që futen në gjykatore dhe mënyrën e planifikur të mbikëqyrjes (video, audio, foto, etj.);
- caktimin e kohës se xhirimit për seancën e duhur ose të pjesëmarrësit në procedurë jashtë ndërtesës gjyqësore.

Neni 358

Gjatë marrjes së vendimit për dhënien e lejes për fotografim dhe xhirim do të merren parasysh interesi dhe besimi i opinionit, natyra e lëndës, interesi i procedurës, privatësia dhe siguria e pjesëmarrësve në procedurë.

Xhirimi dhe fotografimi do të zhvillohet nën mbikëqyrjen e gjykatësit, përkatësisht kryetarit të këshillit, i cili do të sigurojë mbarëvajtje të papenguar të procedurës, rend publik dhe respektim të dinjitetit të gjykatës.

Xhirimi dhe fotografimi mund të ndërpriten ose kufizohen:

- me kërkesë të palëve dhe me vendim të gjykatës, në çdo kohë;
- nëse me vendim të gjykatës është përjashtuar opinionimi për një pjesë të procedurës ose për një veprimtari të caktuar të procesit, për shkak të ekzistimit të arsyeve ligjore;
- nëse dëshmitari – i dëmtuari i veprës penale e kërkon atë përderisa zgjat dëshmia e tij/saj;
- nëse gjykata konstaton se ndonjë pjesëmarrës në procedurë mund t'i ekspozohet rrezikut, turpit, dëmit ose do të mund të ndodhnin pengesa në zbatimin e masave juridike të shtrëngimit ose nëse kjo është e domosdoshme për shkak të natyrës ë provave që duhet të shpalosen (dëgjimin e dëshmitarëve të mbrojtur, të miturve, etj.).

Neni 359

Leja për mbulim medial të seancës gjyqësore nënkupton edhe sigurimin e gjykatores së përshtatshme.

Në gjykatore do të sigurohet një pjesë e posaçme për ekipet mediale dhe mbikëqyrësit, me rrethojë ose enkas i shënuar, me hyrje të posaçme, nëse e lejojnë mundësitë këtë. Që të sigurohet akomodim tek pjesa e rezervuar në gjykatore, gazetarët dhe mbikëqyrësit do të njoftojnë gjykatën për pjesëmarrjen e tyre.

Nëpunësi gjyqësor do të kujdeset për personat, të cilët kanë leje nga kryetari, të ulen nëpër vendet e tyre të rezervuara, si edhe për gazetarët dhe mbikëqyrësit, për praninë e të cilëve nuk është e nevojshme leja e posaçme.

Me kërkesë të gjykatësit ose nëpunësit gjyqësor, gazetari do ta tregojë kartën e identifikimit (të medias) dhe do të tregojë emrin e shtëpisë mediale për të cilën raporton.

Ndalohet dhënia e përparësisë jokorrekte për një shtëpi mediale gjatë dhënies së lejes ose gjatë akomodimit në pjesen e rezervuar për ata në gjykatore.

Çdo shtëpi mediale, e cila ka dorëzuar kërkesë për leje me qëllim të mbulimit medial të seancës gjyqësore, mund të fus në gjykatore një video ose TV kamerë, një audio sistem dhe dy fotoaparate (më së shumti dy objektiva), kurse secilën aparat të përmendur duhet të përdor nga një person.

Neni 360

Xhiruesit dhe fotografët nuk guxojnë të lëvizin vërdallë ose të marrin pozita të cilat do të tërhiqnin vëmendjen ose prishnin rendin në gjykatore.

Mikrofonët dhe pajisjet tjera adekuate do të montohen paraprakisht në vendin që do të caktojë gjykatësi. Të gjithë mikrofonët duhet të kenë sustë për çkyçje të përkohshme.

Pajisjet e xhirimit dhe pajisjet e tjera (celularët, kompjuterët) nuk guxojnë të nxjerrin tinguj që do të tërhiqnin vëmendje. Pajisjet nuk guxon të futen ose nxirren jashtë gjykatores derisa kryeson trupi gjykues.

Neni 361

Gjykata mund të caktojë mënyrën e punës dhe raportimit në sistem të mbyllur me anë të një televizori të brendshëm që të mundësohet qasje dhe përcjellje e lirë të shënimeve audio dhe video (foto, tingulli, zëri).

Nëse dhënia e kopjeve nënkupton shpenzim shtesë për gjykatën, atëherë atë do të kompensojë kërkuesi i kopjeve.

Neni 362

Fotografimi dhe xhirimi në gjykatë, si dhe publikimi i tyre mund të bëhet në bazë të lejes së shkruar paraprakisht të pranuar nga kryetari i gjykatës.

Fotografimin dhe video xhirimin në ndërtesën e gjykatës, jashtë seancës gjyqësore, e aprovon kryetari i cili menaxhon me ndërtesë në të cilën gjenden hapësirat gjyqësore.

Neni 363

Xhirimi video dhe audio (magnetofon) i seancës kryesore në procedurën penale dhe shpallja publike (riprodhimi) e xhirimit jashtë rasteve të parashikuara me Ligjin për procedurë penale bëhet me leje nga kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, në bazë të mendimit paraprak të kryetarit të këshillit, gjykatësve dhe pëlqimin e palëve të përfshirë në proces.

Xhirimet video dhe audio të seancës kryesore në procedurën kontestimore dhe riprodhimin publik të xhirimeve e aprovon kryetari i gjykatës në bazë të mendimit paraprak të këshillit, kryetarit të këshillit, gjykatësve dhe pëlqimin e palëve të përfshirë në proces.

Fotografimin gjatë seancës dhe riprodhimin publik të fotografive e aprovon kryetari i këshillit, gjykatësi në bazë të pëlqimit paraprak të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces.

Gjatë dhënies së aprovimit për fotografim dhe xhirim do të kihet parasysh interesi i opinionit, interesat e procedurës, privatësia dhe siguria e pjesëmarrësve në proces.

Fotografimi dhe xhirimi në gjykatore, pas marrjes së pëlqimit, zhvillohet nën udhëheqjen e kryetarit të këshillit dhe gjykatësve, të cilët sigurojnë mbarëvajtje të papenguar të seancës dhe rendin publik në gjykatore.

SHTOJCA 5:

Udhëzuesi i Ministrisë së Drejtësisë për mënyrën e shpalljes dhe kërkimit të vendimeve gjyqësore në faqen e internetit të gjykatës

MINISTRIA E DREJTËSISË

Në bazë të nenit 10, pika (6) e Ligjit për administrimin e lëvizjes së lëndëve gjyqësore („Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 171/10), Ministri i drejtësisë, solli

UDHËZUES PËR MËNYRËN E SHPALLJES DHE KËRKIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FAQEN E INTERNETIT TË GJYKATËS

Neni 1

Me këtë udhëzues rregullohet mënyra e shpalljes dhe kërkimit të vendimeve gjyqësore në faqen e internetit të gjykatës.

Neni 2

Gjatë shpalljes së vendimeve të plotëfuqishme gjyqësore në faqen e internetit të gjykatës me emër dhe mbiemër të palëve, përkatësisht titullin e personit juridik, anonimizohen të dhënat në vijim:

- adresa e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit ose selisë së palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
- data dhe vendi i lindjes së palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
- numri i kartës së identitetit, pasaportës, patent shoferit dhe numrat e dokumenteve të tjera personale të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
- numri i policës së sigurimit, numri i targave në automjet;
- adresa e postës elektronik të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
- numri unik i identifikimit të qytetarit ose numri unik i identifikimit të subjektit dhe
- emri dhe mbiemri dhe të dhënat tjera personale të dëshmitarit, ekspertit, përkthyesit, punonjësit social, psikologut, pedagogut, defektologut, mjekut, etj.

Gjatë shpalljes së vendimeve gjyqësore të pikës 1 të këtij neni shpallet emri dhe mbiemri

i gjyaktësve, prokurorëve publik, avokatit shtetëror, përfaqësuesve ligjor, mbrojtësve ligjor dhe të autorizuarve të palëve.

Neni 3

Vendimet gjyqësore jofuqiplota shpallen në faqen e internetit të gjykatës duke i anonimizuar plotësisht të dhënat personale të pjesëmarrësve në procedurë, përveç emrit dhe mbiemrit të gjykatësve, prokurorëve publik, avokatëve shtetërore dhe përfaqësuesve ligjor të palëve.

Neni 4

Anonimizimi i të dhënave personale sipas nenit 2 dhe 3 të këtij udhëzuesi bëhet me zëvendësimin ose me lërjen anash të të dhënave në vendimet gjyqësore si vijon:

1. Anonimizimi i emrit dhe mbiemrit

a). Emri dhe mbiemri anonimizohen duke i zëvendësuar me initiale, me shkronja të mëdha të para pas së cilave vihet pikë;

Shembull: Bardhyl Jetishi zëvendësohet me: B.J.

b). Nëse në një vendim gjyqësor ka më shumë persona me initiale të njëjta atëherë anonimizimi bëhet si vijon:

- tek personi i parë emri zëvendësohet me inicial me pikë, kurse mbiemri zëvendësohet me inicial me pikë dhe shtohet numri rendor 1;
- tek personi i dytë, tretë ose persona të tjerë emri zëvendësohet me inicial me pikë, kurse mbiemri zëvendësohet me inicial me pikë dhe shtohet numri rendor vijues.

Për shembull: Bardhyl Bardhyli, Blerim Blerimi, Berzat Berzati zëvendësohen me B.B. 1, B.B. 2, dhe B.B. 3

2. Anonimizimi i emrit të personave juridik

- Emri i personit juridik (shoqërisë tregtare) anonimizohet ashtu që emri i shoqërisë tregtare zëvendësohet me shkronjë të parë të madhe pas së cilës vihet pikë dhe shtohen shkronja të mëdha të shtypit me pikë, të cilat e shënojnë formën e shoqërisë tregtare. Nëse në tekstin e vendimit gjyqësor është theksuar ndërmarrje publike ose ndonjë lloj tjetër personi juridik, atëherë nuk anonimizohen të dhënat e formës juridike të atij personi juridik.

Shembull: „Shkup” SHPK zëvendësohet me SH. SHPK,

Ndërmarrja publik „Ujësllës dhe Kanalizime” zëvendësohet me Ndërmarrje publike U.K.

3. Anonimizimi i emrave të organeve të administratës shtetërore, organizatave administrative, institucioneve dhe instituteve, si edhe njësive të vetëqeverisjes lokale

- Emri i organeve të administratës shtetërore, organizatave administrative, institucioneve dhe instituteve, si edhe njësive të vetëqeverisjes lokale anonimizohet ashtu që fjalët me të cilat përbëhet titulli zëvendësohen vetëm me një fjalë e cila e paraqet formën juridike të subjektit. Nëse emri/titulli përbën fjalë me thonjëza, ato fjalë zëvendësohen me inicialet e shkronjave të para të fjalëve, të cilave iu shtohet pikë, kurse thonjëzat hiqen.

Shembull: Ministria e drejtësisë zëvendësohet me Ministria,

Enti shtetoror i statistikave zëvendësohet me Enti,

Shkolla fillore „Naim Frashëri” zëvendësohet me N.F.

4. Anonimizimi i adresës dhe vendit të lindjes

- Emrat e shteteve, qyteteve, dhe vendlindjeve anonimizohen ashtu që emri i qytetit zëvendësohet me shkronjat pas së cilave vihet pikë. Pjesa tjetër e adresës siç është rruga dhe numri hiqen. Në rast se në një vendim gjyqësor ka shkronja të para të njëjta të shteteve, qyteteve ose vendbanimeve, çdo shkronjave të para të reja iu shtohet numër rendor duke filluar me 1.

Shembull: rr. „Qemal Stafa“ nr. 9, Shkup, Republika e Maqedonisë zëvendësohet me Q.S.R.M.

Rr. „522” nr.1, Demir Hisar, Republika e Maqedonisë zëvendësohet me D.H.R.M.

5. Anonimizimi i adresës eletronike dhe faqeve të internetit

- a). Adresa e postës elektronike dhe faqeve të internetit anonimizohen ashtu që zëvendësohen me tre pika.

Shembull: e-mail: nehim_tairi@live.com zëvendësohet me e-mail: www.drejtësia.gov.mk zëvendësohet me www...

6. Anonimizimi i numrit unik të identifikimit të qytetarit, numrit të kartës së identitetit, pasaportës, patent shoferit dhe dokumenteve të tjera personale, si edhe policës së sigurimit, numrit të targave të automjeteve dhe datëlindjes

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetare gjatë tërë procedurës penale

- Numri unik i qytetarit, numri i kartës së identitetit, pasaportës, patent shoferit, dhe dokumenteve të tjera personale, si edhe policës së sigurimit, numrit të targave të automjeteve dhe datëlindjes anonimizohen ashtu që në vend të tyre vihe tre pikë.

Shembull: Numri i kartës së identiteti 98765 zëvendësohet me numri i kartës së identitetit ...

Numri targave të automjetit SK-2584 OC zëvendësohet me numri i targave të automjetit...

Datëlindja 1.1.2035 zëvendësohet me data e lindjes...

Neni 5

Vendimet e plotëfuqishme të shpallura në faqen e internetit të gjykatave kërkohen sipas:

- llojit të lëndës,
- numrit të lëndës,
- bazës së lëndës,
- emrit dhe mbiemrit të paditësit, akuzuarit ose të dënuarit,
- muajit dhe vitit të sjelljes së aktgjykimit dhe
- fjalës së caktuar të definuar në nomenklaturë.

Neni 6

Vendimet gjyqësore jofuqiplota të shpallura në faqen e internetit të gjykatave kërkohen sipas:

- llojit të lëndës,
- numrit të lëndës,
- bazës së lëndës,
- muajit dhe vitit të sjelljes së aktgjykimit dhe
- fjalës së caktuar të definuar në nomenklaturë.

Neni 7

Ky udhëzues hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

Nr. 01-887/5

04. 04. 2011

Shkup

Ministri i Drejtësisë,
Mihajlo Manevski, f.p

SHTOJCA 6:

KËSHILLI I EVROPËS
KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimi Rec(2003)13

i Komitetit të Ministrave drejtuar vendeve sënëtare për dhënien e informacioneve nëpërmjet mediave lidhur me procedurat penale

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më datë 10 qershor 2003 në takimin e 848 të përfaqësuesve të ministrive)

Komiteti i Ministrave, sipas dispozitave të Nenit 15b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke konsideruar qëllimin e Këshillit të Evropës për arritjen e unitetit më të madh ndërmjet vendeve anëtare të Këshillit me qëllim të ruajtjes dhe realizimit të ideve dhe parimeve të cilat janë trashëgimi e përbashkët të vendeve anëtare;

Duke iu referuar përkushtimeve të vendeve anëtare për realizimin e së drejtës themelore të lirisë së informimit, që është e garantuar me Nenin 10 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut (në tekstin e mëposhtëm: Konventa), e cila paraqet një ndër themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një ndër kushtet themelore për arritjen e përparimit në një shoqëri të tillë, si edhe zhvillimin e çdo individi;

Duke iu referuar asaj se mediat kanë të drejtë të informojnë opinionin për shkak të së drejtës që opinioni e ka për të pranuar informacione, përfshirë dhe informacione për punët që janë të interesit publik, sipas Nenit 10 të Konventës, si obligimi profesional i mediave është të realizojnë atë të drejtë;

Duke iu referuar asaj që të drejtat e prezumimit të pafajësisë, të gjykimit të drejtë dhe respektimit të privatësisë dhe jetës familjare, sipas Neneve 6 dhe 8 të Konventës, paraqesin kushte themelore që duhet respektuar në çdo shoqëri demokratike;

Duke e theksuar rëndësinë e raportimit të mediave për informimin e opinionit rreth procedurave penale gjatë të cilës do të jetë i dukshëm funksioni mbrojtës i të drejtës penale, si edhe sigurimin e seancave publike për funksionimin e sistemit të së drejtës penale;

Duke konsideruar konfliktet e mundshme të interesave të mbrojtur me Nenet 6, 8 dhe 10 të Konventës, si dhe domosdoshmërinë për ekulibrimin e këtyre të drejtave duke

pasur parasysh faktet e shpalosura në çdo lëndë të posaçme dhe me pikëpamje të përshtatshme të rolit mbikëqyrës të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me qëllim respektimin e përkushtimeve të parashikuara në Konventë;

Më tutje, duke iu referuar të drejtës së mediave dhe gazetarëve për të formuar shoqata profesionale, gjë që është e garantuar me të drejtën e lirisë së shoqërimit sipas Nenit 11 të Konventës, që paraqet bazë për vetërregullim në fushën e mediave;

Të vetëdijshëm për iniciativat e shumta të mediave dhe gazetarëve në Evropë për avancimin e kryerjes së përgjegjshme të punës së gazetarisë, si nëpërmjet vetërregullimit, ashtu edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetin përmes kornizave të rregulluara të përbashkëta;

Me dëshirë për avancimin e debatit bazuar në informacione lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave në kontekstin e raportimit medial për procedurat penale, si dhe me dëshirë për kultivimin e praktikave të mira në tërë Evropën, e cila do të sigurojë qasje të mediave në procedurat penale;

Duke iu referuar Rezolutës (74) 26 për të drejtën e përgjigjes – pozitën e individit në raport me shtypin, si dhe Rekomandimit të Këshillit nr. R (85) 11 për pozitën e viktimës në kuadër të së drejtës penale dhe procedurës, si dhe Rekomandimit nr. R (97) 13 lidhur me frikësimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e palës së mbrojtjes, si dhe Rekomandimi R (97) 21 për mediat dhe avancimin e kulturës së tolerancës;

Duke e theksuar rëndësinë për mbrojtjen e burimeve të informacioneve të gazetarëve lidhur me procedurat penale, në pajtim me Rekomandimin e Këshillit nr. R (2000) 7 për të drejtën e gazetarëve të mos i zbulojnë burimet e tyre të informacioneve;

Duke konsideruar Rezolutën nr. 2 për liritë e gazetarisë dhe të drejtat e njeriut, e miratuar në Konferencën e katërt të ministrave të Evropës për mjetet e komunikimit (Pragë, dhjetor 1994), si dhe Deklarata për të ardhmen e politikës së mediave, e miratuar në Konferencën e gjashtë të ministrave të Evropës për politikën e mjeteve të informimit (Krakov, qershor 2000);

Duke iu referuar asaj që ky rekomandim nuk shërben për kufizimin e standardeve të cilat tashmë ekzistojnë tek vendet anëtare, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e lirisë së shprehjes,

Duke e njohur llojllojshmërinë e sistemeve të tyre juridike në fushën e procedurës penale, qeverive të vendeve anëtare iu rekomandon ta bëjnë këtë në vijim:

1. në varësi të rastit, t'i ndërmarrin ose forcojnë të gjitha masat për të cilat mendojnë se janë të rëndësishme në drejtim të realizimit të parimeve që janë në shtojcë të këtij rekomandimi, në kuadër të dispozitave të tyre kushtetuese,
2. gjerësisht të përhapin këtë rekomandim, së bashku me parimet e tij, ndërsa aty ku duhet edhe me përkthim dhe

3. parimet sidomos t'u vihen në dijeni organeve gjyqësore dhe shërbimeve policore, por gjithashtu këto parime t'ua bëjnë të qasshme edhe shoqatave të profesionistëve mediale dhe të avokatëve.

SHTOJCA e Rekomandimit Rec(2003)13

Parime lidhur me dhënien e informacioneve rreth procedurave penale nëpërmjet mediave

Parimi 1 – Informimi i opinionit nëpërmjet mediave

Opinionin publik duhet të ketë mundësi të pranojë informacione rreth aktiviteteve të organeve gjyqësore dhe shërbimeve policore nëpërmjet mediave. Prandaj, gazetarët duhet të kenë mundësi të raportojnë dhe komentojnë lirshëm për funksionimin e sistemit të drejtës penale, përveç në raste kur kjo kufizohet sipas parimeve në vijim.

Parimi 2 – Presumimi i pafajësisë

Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë është pjesë e patjetërsueshme e drejtës së gjyqimit të drejtë. Në bazë të kësaj, mendimet dhe informacionet lidhur me procedurat penale aktuale duhet të publikohen ose përhapen nëpërmjet mediave, nëse ky veprim nuk ndikon mbi prezumimin e pafajësisë së të dyshimit ose të akuzuarit.

Parimi 3 – Saktësia e informacioneve

Organet gjyqësore dhe shërbimet policore duhet t'u sigurojnë mediave vetëm informacione të verifikuara ose informacione të bazuara mbi supozime të arsyeshme. Në raste të supozimeve të arsyeshme, mediat duhet qartë të theksojnë këtë.

Parimi 4 – Qasja në informacione

Kur gazetarët kanë siguruar informacione në mënyrë ligjore rreth kontekstit të procedurës aktuale penale nga organet gjyqësore ose shërbimet policore, atëherë ato organe dhe shërbime policore patjetër duhet t'i bëjnë që qasshme ato informacione, pa diskriminim, për të gjithë gazetarët të cilët do të parashtrojnë ose do të parashtrojnë kërkesë të tillë.

Parimi 5 – Mënyra e dhënies së informacioneve

Kur organet gjyqësore dhe shërbimet policore vetë kanë vendosur t'u japin informacione mediave rreth procedurave aktuale penale, atëherë ato informacione duhet të jepen pa diskriminim dhe kur kjo është e mundur, të jepen përmes lajmërimeve për media, konferencave për shtyp edhe atë nga nëpunës të autorizuar ose ngjashëm.

Neni 6 – Informimi i rregullt gjatë procedurës penale

Në kontekst të procedurave penale të interesit publik ose procedurave të tjera penale të cilat kanë tërhequr vëmendjen e opinionit, organet gjyqësore dhe shërbimet policore duhet t'i informojnë mediat për aktet e tyre më të rëndësishme, deri në atë masë sa që informimi i tillë nuk do të ndikojë mbi fshehtësinë e hetimeve dhe aksioneve policore ose deri në atë masë sa që nuk do të prolongojë ose parandalojë rezultatin e procedurave të tilla. Në raste të procedurave penale të cilat zgjasin një periudhë më të gjatë kohore, informimi i këtillë duhet të bëhet rregullisht.

Parimi 7 – Ndalesa për keqpërdorimin e informacioneve

Organet gjyqësore dhe shërbimet policore nuk duhet t'i keqpërdorin informacionet rreth procedurave aktuale penale për qëllime komerciale ose qëllime të tjera që nuk kanë të bëjnë me nevojat relevante të zbatimit të ligjit.

Parimi 8 – Mbrojtja e privatësisë në kontekst të procedurës aktuale penale

Gjatë dhënies së informacioneve rreth të dyshimëve, të akuzuarve, të dënuarve apo palëve të tjera të përfshirë në procedurat penale, duhet të respektohet e drejta për mbrojtjen e privatësisë, në pajtim me Nenin 8 të Konventës. Mbrojtja e posaçme duhet t'u sigurohet atyre palëve në procedurë të cilët janë të mitur ose grupeve të tjera të rrezikuara, si edhe viktimave, dëshmitarëve dhe familjeve të dyshimëve, akuzuarve dhe dënuarve. Në të gjitha rastet, vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet efektit të dëmshëm që mund të shkaktohet për shkak të zbulimit të informacioneve me të cilat identifikohen personat e përmendur në këtë parim.

Parimi 9 – E drejta e korrigjimit ose e drejta e përgjigjes

Pa paragjykime për qasshmërinë dhe për mjetet tjera juridike, çdokush që i është nënshtruar raportimit jokorrekt ose shpifës të mediave në kontekstin e procedurës penale, duhet të ketë të drejtë për korrigjim (demant) ose përgjigje kundër medias përkatëse. E drejta për korrigjim gjithashtu duhet të jetë e realizueshme edhe në Lajmërimet për media të cilat përmbajnë informacione të pasakta, e të cilat kanë qenë të publikuara nga organet gjyqësore ose shërbimet policore.

Parimi 10 – Mbrojtja nga ndikimi i paragjykimeve

Në kontekst të procedurave penale, sidomos atyre që përfshijnë edhe porotë, organet gjyqësore dhe shërbimet policore duhet heqin dorë nga sigurimi i informacioneve publike me të cilat paraqitet rrezik nga krijimi i paragjykimeve të konsiderueshme në drejtësinë e procedurave.

Parimi 11 – Publiciteti i dëmshëm para fillimit të procedurës gjyqësore

Në raste kur i akuzuari mund të tregojë se ekziston mundësia që dhënia e informacioneve do të rezultojë ose tashmë ka rezultuar drejt shkeljes së të drejtës së tij/saj për një gjykim të drejtë, atëherë i akuzuari duhet të ketë të drejtë për arritjen e mjetit efikas juridik.

Parimi 12– Leja për hyrjen e gazetarëve

Gazetarëve duhet t'u lejohet të hyjnë në procese gjyqësore dhe shpallje publike të aktgjykimeve, pa diskriminim dhe pa kusht që paraprakisht të jenë të siguruara akreditimet. Gazetarët nuk duhet të largohen nga proceset gjyqësore, përveç atëhere kur largohet publiku nga proceset gjyqësore, sipas Nenit 6 të Konventës.

Parimi 13 – Qasja e gazetarëve në gjykatore

Organet kompetente, nëse nuk ekziston pamundësi e qartë për atë, duhet të sigurojnë vende të caktuara në gjykatore, të destinuara për gazetarë, të cilat do të jenë të mjaftueshme t'i përgjigjen kërkesës së tillë, pa mos e përjashtuar opinionin publik nga gjykatorja.

Parimi 14 – Raportimi drejtpërdrejtë dhe xhirimi në gjykatore

Raportimi i drejtpërdrejtë ose xhirimi në gjykatore nga ana e mediave nuk duhet të jetë e mundur, vetëm nëse kjo është e lejuar qartë me ligj ose nga ana e organeve kompetente gjyqësore. Raportimi i këtyre duhet të lejohet vetëm në raste kur nuk ekziston rrezik nga ndikimi i papërshtatshëm mbi viktimat, dëshmitarët, palët e përfshira në procedurë penale, porota ose gjykatësit.

Parimi 15 – Mbështetja për raportimin e mediave

Nga organet kompetente, në afat të caktuar kohor, gazetarëve duhet t'u sigurohen, me kërkesë të tyre, njoftime për proceset e caktuara ose për shqiptimin e aktakuzave dhe informacione të tjera relevante për raportimin juridik të mediave, përveç nëse kjo është e pamundur. Gazetarëve duhet t'u lejohet, pa diskriminim, të bëjnë ose të pranojnë kopje të aktgjykimeve të shqiptuara publikisht. Gazetarët duhet të kenë mundësi publikisht t'i përhapin ose shpallin aktgjykimet e tilla.

Parimi 16 – Mbrojtja e dëshmitarëve

Identiteti i dëshmitarëve nuk duhet të zbulohet, përveç nëse ndonjë dëshmitar ka dhënë pëlqim paraprak për atë ose nëse identiteti i dëshmitarit paraqet interes publik ose nëse dëshmia e tij tashmë është shpallur publikisht. Identiteti i dëshmitarëve assesi nuk duhet të zbulohet nëse me atë veprim kërcënohet jeta ose siguria e tyre. Vëmendje të posaçme duhet vënë mbi programet për mbrojtjen e dëshmitarëve, sidomos në procedura penale kundër krimit të organizuar ose krimit në familje.

Parimi 17 – Raportimi i mediave për zbatimin e dënimit gjyqësor

Gazetarëve duhet t'u lejojehet të kontaktojnë me personat që vuajnë dënimin me burgim, ashtu që ai kontakt të mos e dëmtojë zbatimin e drejtë të drejtësisë, të drejtat e të burgosurve dhe nëpunësve të burgut ose sigurinë e burgut.

Parimi 18 – Raportimi i mediave pas përfundimit të dënimit gjyqësor

Me qëllim të mos dëmtohet reintegrimi në shoqëri i personave që kanë vuajtur dënim me burgim, e drejta për mbrojtjen e privatësisë sipas Nenit 8 të Konventës duhet të përfshijë edhe të drejtën për mbrojtje të identitetit të atyre personave, lidhur me veprat e tyre të mëparshme, pas përfundimit të dënimit, përveç nëse ata vetë nuk janë pajtuar që identiteti i tyre të zbulohet ose veprat e tyre të mëparshme sërish bëhen ose janë bërë interes publik.

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale

PUBLIKU NË PROCEDURËN PENALE

Udhëzues për gazetarë gjatë tërë procedurës penale